Banka gjithashtu ka përgatitur pasqyrat financiare të konsoliduara në përputhje me SNRF për Bankën dhe degët e saj ('grupi). Në pasqyrat financiare të konsoliduara, sipërmarrjet filiale – të cilat janë ato kompani në të cilat, në mënyrë të drejtpërdrejtë apo jot ë drejtpërdrejtë, ka influencë mbi gjysmën e të drejtave të votës ose ndryshe ka fuqinë të ushtrijë kontroll mbi aktivitetet – janë konsoliduar plotësisht. Pasqyrat financiare të konsoliduara mund të gjenden në <http://www.raiffeisen.al/>. Përdoruesit e këtyre pasqyrave individuale duhet ti lexojnë ato së bashku me pasqyrat e konsoliduara të grupit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 në mënyrë që të marrin informacion të plotë mbi pozicionin financiar, rezultatin e operacioneve dhe ndryshimet në pozicionin financiar të grupit në tërësi.

Monedha e paraqitjes. Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Lek, përveç rasteve kur cilësohet ndryshe. Ndryshe siç tregohet, informacioni financiar i paraqitur në Lek është rrumbullakosur në mijëshen më të afërt.

3. Përmbledhje e politikave kontabël

Politikat kontabël në vijim janë zbatuar në mënyrë të qëndrueshme në të gjitha periudhat e paraqitura në këto pasqyra financiare, përveç rasteve kur cilësohet ndryshe.

(a) Degët dhe konsolidimi

Degët janë entitete të kontrolluara nga Banka. Kontrolli ekziston kur Banka ka fuqi në mënyrë të drejtpërdrejtë apo jo të drejtpërdrejtë të drejtojë politikat financiare dhe operative të një entiteti në mënyrë që të përfitojë nga aktivitetet e tij. Në përcaktimin e kontrollit, të drejtat potenciale të votave që aktualisht janë të ushtrueshme ose të konvertueshme janë marrë parasysh.

Një kompani mëmë nuk është e nevojshme të paraqesë pasqyra financiare të konsoliduara nëse kompania mëmë e vet është bijë e zotëruar plotësisht nga prindi dhe prindi përfundimtar ose i ndërmjetëm i mëmës përgatit pasqyra financiare të konsoliduara në dispozicion për përdorim publik që përputhen me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar. Banka përgatit pasqyra individuale dhe të konsoliduara financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar. Interesat në bija janë të regjistruara me kosto në pasqyrat financiare individuale. Pasqyrat e konsoliduara financiare të përgatitura në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar do të publikohen në të njëjtën datë me pasqyrat financiare individuale.

RAIFFEISEN BANK SH.A.

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare individuale për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015

(shumat në LEK'000)

3. Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

(b) Transaksionet e këmbimeve në monedhë të huaj

Transaksionet e këmbimeve në monedhë të huaj regjistrohen me kursin zyrtar të këmbimit të shpallur në ditën e transaksionit. Aktivitet dhe pasivitet monetare të emetuara në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin zyrtar të këmbimit të shpallur në datën e bilancit.

Fitimi ose humbja nga ndryshimi i kurseve të këmbimit është diferenca midis kostos së amortizuar në monedhën funksionale në fillim të periudhës, të rregulluara me interesin efektiv dhe pagesat gjatë periudhës, dhe kostos së amortizuar në monedhë të huaj të kthyer në monedhën funksionale me kursin e fundit të periudhës. Aktivitet dhe detyrimet jo monetare në monedhë të huaj, të cilat maten me vlerë të drejtë, kthehen në monedhën funksionale me kursin e datës së caktimit të vlerës së drejtë. Diferencat që lindin nga kurset e këmbimit regjistrohen në pasqyrën e veçantë përmbledhëse të të ardhurave.

Kurset zyrtare të Bankës për monedhat kryesore (LEK ndaj njësisë së monedhës së huaj) më 31 dhjetor 2015 dhe 2014 ishin si më poshtë:

	31 dhjetor 2015		31 dhjetor 2014	
	<i>Fund viti</i>	<i>Mesatar</i>	<i>Fund viti</i>	<i>Mesatar</i>
Dollari Amerikan (USD)	125.79	125.60	115.23	105.75
Monedha e Bashkimit Europian (EUR)	137.28	139.67	140.14	139.93

(c) Interesi

Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesat njihen si fitime ose humbje në pasqyrën e veçantë përmbledhëse të të ardhurave në bazë të metodës së interesit efektiv. Norma e interesit efektiv është norma që aktualizon pagesat dhe arkëtimet e ardhshme monetare gjatë jetës së aktivitetit, ose detyrimit financiar (ose kur është e përshtatshme një periudhë më e shkurtër) për t'i barazuar me vlerën kontabël të aktivitetit ose detyrimit financiar. Kur përlogarit interesin efektiv, Banka merr parasysh rrjedhjet e ardhshme të parave sipas kontratës, por jo humbje të ardhshme krediti.

Llogaritja e normës së interesit efektiv përfshin të gjitha komisionet e paguara ose të marra, të cilat janë një pjesë integrale e normës efektive të interesit. Kostot e transaksioneve janë kosto shtesë të lidhura drejtpërdrejt me blerjen, ose emetimin e një aktivi apo detyrimi financiar.

Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesi të paraqitura si fitime ose humbje në pasqyrën e veçantë përmbledhëse të të ardhurave përfshijnë:

- interesat nga aktivitet ose detyrimet financiare me kosto të amortizuar mbi bazën e normës së interesit efektiv
- interesat nga letrat me vlerë të vlefshme për shitje të llogaritura mbi bazën e interesit efektiv

Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesat për aktivitet dhe detyrimet e tregtueshme paraqiten së bashku me të gjitha ndryshimet e tjera në vlerën e drejtë të aktiveve dhe detyrimeve të tregtueshme në fitimin neto nga tregtimi.

(d) Tarifa dhe komisione

Të ardhurat dhe shpenzimet nga tarifat dhe komisionet, të cilat janë pjesë integrale e normës së interesit efektiv në një aktiv ose detyrim financiar, përfshihen në matjen e normës së interesit efektiv.

Të ardhura të tjera nga komisione dhe tarifa, duke përmendur këtu tarifat e shërbimeve për llogaritë, komisionet e shitjeve, tarifa të depozitave, njihen në momentin që ofrohen shërbimet e lidhura me to.

Shpenzime të tjera për komisione dhe tarifa lidhen kryesisht me tarifa transaksionesh ose shërbimesh, të cilat shpenzohen në momentin që shërbimet përftohen.

RAIFFEISEN BANK SH.A.

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare individuale për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015

(shumat në LEK '000)

3. Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

(e) Të ardhurat neto nga tregtimi

Të ardhurat neto nga tregtimi përfshijnë fitimet minus humbje të lidhura me aktivet dhe detyrimet e tregtueshme dhe gjithashtu të gjitha ndryshimet në vlerë të drejtë, të realizuara ose jo, interesin, dividendët dhe ndryshimet në këmbimin valutor.

(f) Pagesat e qirasë dhe shpenzime të tjera operative

Pagesat e bëra nën qiranë operative janë njohur në pasqyrën e veçantë përmbledhëse të të ardhurave në bazë të metodës lineare mbi jetëgjatësinë e qirasë. Zbritje nga qiraja njihen si pjesë përbërëse e totalit të shpenzimit të qirasë gjatë jetës së qirasë.

(g) Përfitimet e punonjësve

- *Plan pensioni me kontribute të përcaktuara*

Detyrimet për planet e pensioneve me kontribut të përcaktuar njihen si shpenzim në pasqyrën e veçantë përmbledhëse të të ardhurave kur ato ndodhin. Banka paguan kontribute për sigurimet shoqërore të detyrueshme për përfitimet e punonjësve që dalin në pension. Autoritetet Shqiptare janë përgjegjëse për përcaktimin e limitit minimal ligjor të vendosur për pensionet në Shqipëri sipas një plani kontributësh të përcaktuar për pensione.

- *Leja vjetore e paguar*

Banka njeh si detyrim vlerën e paskontuar të kostos së vlerësuar në lidhje me lejen vjetore që pritet të paguhet në këmbim të shërbimeve të punëmarrësit për periudhën.

- *Përfitimet afatshkurtra*

Detyrimet për përfitime afatshkurtra nuk skontohen dhe regjistrohen në periudhën kur ofrohet shërbimi.

Një provigjion mund të regjistrohet për shumën që pritet të paguhet në lidhje me bonuset afatshkurtra në para ose planet e pjesëmarrjes në fitime, nëse Banka ka një detyrim ligjor aktual ose konstruktiv për të paguar këtë shumë si rezultat i shërbimeve të shkuara të ofruara nga punonjësi dhe detyrimi mund të matet në mënyrë të besueshme.

- *Përfitimet nga ndërprerja e marrëdhënieve të punës*

Përfitimet nga ndërprerja e marrëdhënieve të punës regjistrohen si shpenzim atëherë kur Banka, në mënyrë të dukshme, ka vendosur të zbatojë një plan formal të detajuar për të ndërprerë punësimin para datës së daljes në pension. Përfitime të ofruara për largimin vullnetar do të regjistrohen vetëm atëherë kur oferta është bërë, është e mundshme që oferta do të pranohet dhe numri i personave që do të pranojnë ofertën mund të matet në mënyrë të besueshme.

(h) Tatim fitimi

Tatimi mbi fitimin përfshin tatimin e periudhës aktuale dhe tatimin e shtyrë. Tatimi mbi fitimin njihet në pasqyrën e veçantë përmbledhëse të të ardhurave përveç pjesës që lidhet me zëra të njohur direkt në kapital. Në këto raste tatimi njihet si zë i kapitalit. Tatimi aktual është tatimi që pritet të paguhet mbi fitimin e tatueshëm të vitit, duke përdorur normën tatimore në fuqi ose që konsiderohet si e tillë në datën e mbylljes së pasqyrave financiare dhe çdo sistemim të tatimit të pagueshëm për vitet e mëparshme.

Tatimi i shtyrë është llogaritur duke përdorur metodën e bilancit, duke marrë në konsideratë diferencat e përkohshme ndërmjet vlerës kontabël neto të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime raportimi financiar dhe bazës tatimore. Vlera e tatimit të shtyrë është llogaritur duke përdorur normën tatimore të pritshme kur diferencat e përkohshme do të rimerren, sipas ligjeve në fuqi në datën e raportimit.

Një aktiv tatimor i shtyrë njihet për aq sa është e mundur që fitimi i tatueshëm i ardhshëm do të jetë i disponueshëm, kundrejt të cilit diferencat tatimore të zbritshme të mund të përdoren. Një pasiv tatimor i shtyrë njihet për të gjitha diferencat e përkohshme të tatueshme. Aktiv i tatimor i shtyrë dhe pasiv i tatimor i shtyrë rishikohen çdo datë raportimi dhe zvogëlohen për aq sa nuk është e mundur të realizohet respektivisht përfitimi apo detyrimi fiskal i lidhur me të.

Taksa të tjera shtesë lidhur me dividendin njihen kur njihet edhe detyrimi për pagimin e dividendit.

RAIFFEISEN BANK SH.A.

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare individuale për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
(shumat në LEK'000)

3. Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

(i) Aktivet dhe detyrimet financiare

i Njohja

Letrat me vlerë të tregtueshme, derivatet dhe instrumente të tjera financiare me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes janë regjistruar fillimisht me vlerën e drejtë. Të gjitha instrumentet e tjera financiare regjistrohen fillimisht me vlerën e transaksioneve plus kostot e transaksionit. Vlera e drejtë në njohjen fillestare dëshmohe me së miri nga çmimi i transaksionit. Një fitim ose humbje në njohjen fillestare regjistrohet vetëm në qoftë se ka një dallim në mes vlerës së drejtë dhe çmimit të transaksionit që mund të dëshmohe nga transaksione të tregut aktual të të njëjtit instrument ose nga një teknikë vlerësimi e inputeve të cilat përfshijnë vetëm të dhëna nga tregje të mbikëqyrura. Të gjitha blerjet dhe shitjet e aktiveve financiare që kërkojnë dorëzimin brenda kuadrit kohor të vendosur nga rregullojta ose marrëveshja e tregut ("mënyra e rregullt" për blerjet dhe shitjet) janë të regjistruara në datën e tregtimit, e cila është data në të cilën banka angazhohet për të ofruar një aktiv financiar. Të gjitha blerjet e tjera njihen kur njësia ekonomike bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit.

ii Çregjistrimi

Banka çregjistron mjetet financiare kur (a) aktivet janë çliruar ose të drejtat ndaj rrjedhave të parasë nga aktivet e maturuara kanë mbaruar ose (b) banka ka transferuar të drejtat për flukset e mjeteve monetare nga aktivet financiare ose kanë hyrë në një marrëveshje kualifikuese ndërsa (i) gjithashtu ka transferuar kryesisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë së aseteve ose (ii) as ka transferuar as ka mbajtur thelbësisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë, por nuk ka mbajtur kontrollin. Kontrolli ruhet në qoftë se pala tjetër nuk ka aftësinë praktike për ta shitur aktivin në tërësinë e tij ndaj një pale të tretë të palidhur pa nevojë të vendosë kufizime mbi shitjen.

iii Matja e kostos së amortizuar

Kostoja e amortizuar e një aktivi ose detyrimi financiar është vlera me të cilën aktivi ose detyrimi njihet në momentin fillestar duke i zbritur pagesat e principalit, plus/minus amortizimin e akumuluar duke përdorur metodën e interesit efektiv për çdo diferencë ndërmjet vlerës fillestare të njohur dhe vlerës në maturitet, minus çdo zbritje për efekt zhvlerësimi.

iv Matja e vlerës së drejtë

Përcaktimi i vlerës së drejtë të aktiveve dhe detyrimeve financiare mbështetet mbi çmimet e kuotuar të tregut, ose çmimet e agjentëve të shitjes për instrumenta financiarë të tregtueshme në tregje aktive. Për të gjitha instrumentat e tjerë financiarë vlera e drejtë përcaktohet mbi bazën e teknikave të vlerësimit. Metodot e vlerësimit përfshijnë teknikën e vlerës aktuale neto, metodën e rrjedhjeve monetare të skontuara, dhe krahasimin me instrumenta të tjerë të ngjashëm për të cilët ekzistojnë çmime tregu dhe metoda vlerësimi.

Banka përdor gjerësisht metodat e vlerësimit për të përcaktuar vlerën e drejtë të instrumentave financiarë të zakonshëm e të thjeshtë si opsionet dhe sëap-et e normave të interesit dhe të monedhës. Për të tilla instrumenta, të dhënat për t'u përdorur në modelet e vlerësimit janë lehtësisht të vëzhgueshme në treg.

Përcaktimi i vlerës së drejtë detajohet në Shënimin 4 "Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve" të pasqyrave financiare të veçanta dhe Shënimin 35 "Vlera e drejtë e aktiveve dhe detyrimeve financiare".

v Kompensimi

Aktivitet dhe detyrimet financiare netohen (kompensohen) me njëra-tjetrën dhe shuma neto paraqitet në pasqyrën e veçantë e pozicionit financiar, atëherë dhe vetëm atëherë kur Banka ka të drejtën ligjore për të netuar këto shuma dhe ka si qëllim ose t'i shlyejë neto, ose të realizojë aktivin dhe të shlyejë detyrimin njëkohësisht.

Të ardhurat dhe shpenzimet paraqiten në bazë neto vetëm atëherë kur lejohet nga standardet kontabël, ose për fitimet dhe humbjet e krijuara nga një grup transaksionesh të ngjashme si ato në aktivitetin tregues të Bankës.

RAIFFEISEN BANK SH.A.

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare individuale për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
(shumat në LEK'000)

3. Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

(i) Aktivet dhe detyrimet financiare (vazhdim)

vi Identifikimi dhe matja e zhvlerësimit

Në çdo datë raportimi Banka vlerëson nëse ka evidencë objektive që aktivet financiare, të cilat nuk mbahen me vlerën e drejtë përmes fitim ose humbjes janë zhvlerësuar. Aktivet financiare zhvlerësohen kur evidenca objektive paraqet që një ngjarje, që sjell humbje, ka ndodhur pas njohjes fillestare të aktivitetit dhe që ngjarja që sjell humbje ka një ndikim në rrjedhjet e ardhshme të parasë së aktivitetit, të cilat mund të maten me besueshmëri.

Banka merr në konsideratë evidencat për zhvlerësim të aktiveve të saj, si në mënyrë specifike ashtu edhe në baza kolektive. Të gjitha aktivet financiare të konsiderueshme trajtohen për zhvlerësim specifik. Të gjitha aktivet financiare të konsiderueshme, të cilat specifikisht nuk kanë evidenca për zhvlerësim, trajtohen në grup për ndonjë zhvlerësim të ndodhur, por të paidentifikuar ende. Aktivet, të cilat nuk janë individualisht të konsiderueshme, trajtohen së bashku për zhvlerësim duke u grupuar në aktive financiare (të mbajtura me kosto të amortizuara) me karakteristika të njëjta rreziku.

Evidenca objektive që aktivet financiare janë të zhvlerësuar mund të përfshijë mospagesa, ose shkelja nga huamarrësit, ristrukturimi i një huaje, të dhëna që një huamarrës ose huadhënës po falimenton, zhdukjen e një tregu aktiv për një letër me vlerë, ose të dhëna të tjera të dukshme lidhur me një grup aktivesh si për shembull ndryshime të pafavorshme të aftësive paguese të një huamarrësi, ose kushte ekonomike që lidhen me mospagime.

Për trajtimin e zhvlerësimit kolektiv Banka përdor modelimin statistikor të trend-eve historike të probabilitetit të mospagimit, përcaktimin e kohës së rimarrjes dhe vlerën e humbjes së ndodhur, përshtatur me gjykimin manaxherial nëse kushtet aktuale ekonomike dhe të kreditit janë të tilla që humbjet aktuale të jenë më të mëdha ose më të vogla se ato të përcaktuara nga modelimet historike. Normat e mospagimeve, normat e humbjes dhe përcaktimi i kohës së rimarrjeve krahasohen përkundrejt rezultateve aktuale për të siguruar që ato të mbeten të përshtatshme.

Humbjet nga zhvlerësimi të aktiveve të mbajtura me kosto të amortizuara llogariten si diferencë e vlerës kontabël të aktiveve financiare dhe vlerës aktuale të flukseve monetare të skontuara me vlerën origjinale të interesit efektiv të këtyre aktiveve. Humbjet njihen në pasqyrën e veçantë përmbledhëse të të ardhurave dhe pasqyrohen në një llogari provigjoni përkundrejt huave dhe parapagimeve. Interesat mbi aktivet e zhvlerësuar vazhdojnë të njihen nëpërmjet skontimeve të pandryshueshme. Kur një ngjarje pas datës së raportimit shkakton uljen e humbjes nga zhvlerësimi, rimarrja e zhvlerësimit pasqyrohet në pasqyrën e veçantë përmbledhëse të të ardhurave.

(j) Paraja dhe ekuivalentët e saj

Paraja dhe ekuivalentët e saj përfshijnë kartëmonedha, monedha, gjendje të pakushtëzuara të Bankës Qëndrore, llogari rrjedhëse dhe aktive shumë likuide me afat maturimi më pak se tre muaj, të cilat nuk ndikohen shumë nga ndryshimet në vlerën e drejtë dhe përdoren nga Banka për administrimin e angazhimeve afatshkurtra.

Këto aktive mbahen me koston e amortizuara në pasqyrën e veçantë të pozicionit financiar.

(k) Aktivet dhe detyrimet e tregtueshme

Aktivitet dhe detyrimet e tregtueshme janë ato aktive dhe detyrime që Banka i blen ose i mban kryesisht për qëllimin e shitjes ose riblerjes në periudhën afatshkurtes, ose i mban si pjesë e portofolit, i cili përdoret për ruajtjen e pozicionit, ose për përfitime afatshkurtra.

Aktivitet dhe detyrimet e tregtueshme, fillimisht njihen me kosto dhe më vonë maten me vlerën e drejtë në pasqyrën e veçantë të pozicionit financiar, duke i kaluar kostot direkte të transaksionit si fitim ose humbje në pasqyrën e veçantë përmbledhëse të të ardhurave. Çdo fitim ose humbje si pasojë e ndryshimit në vlerën e drejtë njihet si pjesë e "Të ardhurave neto nga tregtimi" në pasqyrën e veçantë përmbledhëse të të ardhurave. Aktivitet dhe detyrimet e tregtueshme nuk riklasifikohen pas regjistrimit fillestar.

3. Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

(l) Instrumenta financiarë derivativë

Instrumentet financiare derivative, duke përfshirë kontratat e këmbimit valutor, kontratat *future* të normave të interesit, marrëveshjet *swap* të normave të ardhshme të kursit të këmbimit dhe të normës së interesit dhe opsionet e monedhës dhe të normave të interesit mbahen me vlerën e drejtë. Të gjitha instrumentet derivative janë rregjistruar si aktive kur vlera e drejtë është pozitive, dhe si detyrime kur vlera e drejtë është negative. Ndryshimet në vlerën e drejtë të instrumenteve derivative janë të përfshira në fitim ose humbje për vitin (fitimet minus humbjet në derivate). Banka nuk aplikon kontabilitetin mbrojtës. Instrumente të caktuara derivative të emërtuara instrumente të tjera financiare trajtohen si instrumente derivative të veçanta kur rreziqet dhe karakteristikat e tyre nuk janë të lidhura ngushtë me ato të kontratës bazë.

(m) Huatë dhe paradhëniet

Huatë dhe paradhëniet janë aktive financiare jo-derivativë, me pagesa fikse ose të përcaktueshme, të cilat nuk janë kuotuar në tregje aktive dhe Banka nuk ka për qëllim t'i shesë në periudhë afatshkurtër. Kur Banka blen një aktiv financiar dhe njëherësh hyn në një marrëveshje për ta rishitur këtë aktiv (ose një aktiv thelbësisht të ngjashëm) me një çmim të fiksuar në një datë të ardhshme (marrëveshje të anasjellta të riblerjes), marrëveshja kontabilizohet si një hua apo paradhënie dhe aktivet në bazë të marrëveshjes nuk paraqiten në pasqyrat financiare të veçanta të Bankës.

Huatë dhe paradhëniet fillimisht maten me vlerë të drejtë plus kosto direkte transaksioni dhe në vazhdim maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

(n) Letrat me vlerë

Investimi në letra me vlerë matet fillimisht me vlerën e drejtë duke i shtuar kostot direkte të transaksionit dhe në vijim kontabilizohen mbi bazën e klasifikimit, si të mbajtura deri në maturim, me vlerë të drejtë përmes pasqyrës së veçantë përmbledhëse të të ardhurave, ose të disponueshme për shitje

i Letra me vlerë të mbajtura deri në maturim

Letrat me vlerë që mbahen deri në maturim janë investimet që kanë pagesa fikse ose të përcaktuara, të cilat nuk janë klasifikuar si të disponueshme për shitje apo me vlerë të drejtë përmes pasqyrës së veçantë përmbledhëse të të ardhurave, për të cilat Banka ka qëllimin dhe mundësinë për t'i mbajtur deri në maturim. Letrat me vlerë të mbajtura deri në maturim mbahen më pas me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Çdo shitje ose riklasifikim i shumave të konsiderueshme të investimeve të mbajtura deri në maturim, jo shumë afër maturimit, do të çonte në riklasifikimin e të gjithë portofolit të mbajtur deri në maturim si investim i disponueshëm për shitje dhe do ndalonte Bankën për klasifikimin e tyre si investim i mbajtur deri në maturim për periudhën aktuale dhe për dy vitet pasuese.

ii Vlera e drejtë përmes pasqyrës së veçantë përmbledhëse të të ardhurave

Banka mban disa letra me vlerë të investimit me vlerën e drejtë, me ndryshimet e vlerës së drejtë të njohura menjëherë në fitim ose humbje si përshkruhet në politikën kontabël 3 (iv)

iii Letra me vlerë të disponueshme për shitje

Investimet e disponueshme për shitje janë investime jo-derivativë, të cilat nuk klasifikohen në ndonjë kategori tjetër të aktiveve financiare. Investimet në kapital, të cilat nuk janë të kuotuar dhe vlera e drejtë nuk mund të matet në mënyrë të besueshme, maten me kosto. Mjetet e tjera të disponueshme për shitje mbahen me vlerën e tyre të drejtë. Të ardhurat nga interesi regjistrohen në pasqyrën e veçantë përmbledhëse të të ardhurave sipas metodës së interesit efektiv. Fitimet ose humbjet nga kursi i këmbimit që lidhen me investimet e disponueshme për shitje njihen në pasqyrën e veçantë përmbledhëse të të ardhurave.

Ndryshimet në vlerën e drejtë njihen në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse deri në momentin që letra me vlerë shitet ose zhvlerësohet, dhe balanca në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse njihet në fitim ose humbje.

RAIFFEISEN BANK SH.A.

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare individuale për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015

(shumat në LEK '000)

3. Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

(n) Letrat me vlerë (vazhdim)

iv Letra me vlerë të tjera të matura me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes

Letra me vlerë të tjera me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes janë mjetet financiare të përcaktuara në mënyrë të pakthyeshme, në njohjen fillestare, në këtë kategori. Menaxhimi cakton letrat me vlerë në këtë kategori vetëm nëse (a) Klasifikimi i tillë eliminon ose redukton një mospërputhje kontabël që përndryshe do të lindte nga matja e aktiveve ose detyrimeve apo njohjes së fitimeve dhe humbjeve të tyre mbi baza të ndryshme në mënyrë të konsiderueshme; ose (b) një grup aktivesh financiare, detyrimesh financiare ose të dyja bashkë manaxhohen dhe performanca e tyre vlerësohet mbi bazën e vlerës së drejtë, në përputhje me një menaxhim rreziku të dokumentuar apo strategji investimi. Njohja dhe matja e kësaj kategorie të aktiveve financiare është në përputhje me politikën e mësipërme për aktivet të tregtueshme.

(o) Aktivet afatgjata materiale

i Njohja dhe matja

Zërat e aktiveve afatgjata materiale paraqiten me kosto minus zhvlerësimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga rënia në vlerë.

Kosto përfshin shpenzime që janë drejtpërdrejt të ngarkueshme për blerjen e aktivit. Kosto e aktiveve të ndërtaura nga vetë Banka përfshin koston e materialeve dhe të fuqisë punëtore, si dhe ndonjë kosto tjetër që lidhet drejtpërdrejt me vënien e aktivit në vendin dhe kushtet e nevojshme që ai të jetë i përdorshëm në mënyrën e synuar nga Drejtimi dhe kostot e çmontimit dhe kthimit të vendndodhjes në kushtet e duhura

Kur pjesë të një elementi të aktiveve afatgjata materiale kanë jetëgjatësi të dobishme të ndryshme, ato kontabilizohen si elementë të veçanta të aktiveve afatgjata materiale.

i Kostot vijuese

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një elementi të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën e mbartur të elementit nëse është e mundshme që përfitime ekonomike, në të ardhmen që i atribuohen atij elementi, do të rrjedhin në Bankë, dhe kostoja e tij mund të matet me besueshmëri. Kostot e shërbimeve ditore të aktiveve afatgjata materiale njihen në pasqyrën e veçantë përmbledhëse të të ardhurave në momentin kur ndodhin.

iii Zhvlerësimi

Zhvlerësimi njihet me metodën lineare gjatë jetëgjatësisë së vlerësimit të përdorimit të çdo zëri të aktiveve afatgjata materiale. Aktivet e marra me qira zhvlerësohen për më të shkurtrën midis kohës së qirasë dhe jetëgjatësisë së aktivit. Toka dhe punimet në proces nuk zhvlerësohen.

Jetëgjatësitë të vlerësuara për periudhën aktuale dhe atë krahasuese janë si vijon:

	2015	2014
	(në vite)	(në vite)
• Ndërtesa	20	20
• Kompjutera dhe pajisje informatike	4	4
• Automjete	5	5
• Përmirësime	1 deri ne 10	1 deri ne 10
• Të tjera (Pajisje Zyre)	5	5

Jetëgjatësia dhe vlera e mbetur rishikohen në çdo datë raportimi.

(p) Aktive afatgjata jomateriale

Aktivitet afatgjata jomateriale të blera nga Banka paraqiten me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga rënia në vlerë.

Shpenzimet e mëvonshme mbi aktivet afatgjata jomateriale kapitalizohen vetëm kur këto shpenzime lidhen me rritjen e përfitimit të ardhshëm ekonomik prej aktivit. Të gjitha shpenzimet e tjera njihen në periudhën që ndodhin në pasqyrën e veçantë përmbledhëse të të ardhurave.

RAIFFEISEN BANK SH.A.

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare individuale për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015

(shumat në LEK '000)

3. Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

(p) Aktive afatgjata jomateriale (vazhdim)

Shpenzimi i amortizimit njihet bazuar mbi metodën lineare të amortizimit gjatë jetës së dobishme ekonomike, prej datës në të cilën aktivi është i gatshëm për përdorim. Jeta e dobishme ekonomike e aktiveve afatgjata jomateriale është 8 vjet.

(q) Aktive të riposeduara

Në disa rrethana të caktuara, pronat e vëna në hipotekë mund të rimerren nëpërmjet ekzekutimit të koleteraleve të hipotekuar për huatë e klasifikuara si hua të këqija. Pronat e rimarra në zotërim vlerësohen me më të voglën midis vlerës së ankandit të fundit dhe vlerës së drejtë pasi i janë zbritur kostot e shitjeve, të njohura në pasqyrat financiare të veçanta si "Aktive të tjera". Qëllimi i Drejtimit ndaj pronave të rimarra në zotërim është shitja sa më e shpejtë e tyre, duke i përdorur arkëtimet nga shitja për uljen e borxheve të këqija.

(r) Depozitat dhe detyrimet e tjera financiare

Depozitat dhe detyrimet e tjera financiare janë burimet kryesore të financimit të Bankës. Kur Banka shet një aktiv financiar dhe hyn në një marrëveshje ri-bletjeje për ta blerë këtë aktiv (ose një aktiv të ngjashëm) me një çmim fiks në të ardhmen, marrëveshja kontabilizohet si një depozitë, dhe aktivi vazhdon të njihet në pasqyrat financiare të veçanta të Bankës.

Banka klasifikon instrumentet kapitale si detyrime financiare ose instrumenta kapitale në përputhje me thelbin e kushteve kontraktuale të instrumentit. Depozitat dhe detyrimet e tjera financiare maten fillimisht me vlerën e drejtë duke i shtuar kostot e transaksionit dhe në vijim maten me kosto të amortizuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

(s) Zhvlerësimi i aktiveve jo-financiare

Vlera kontabël e aktiveve jo-financiare të Bankës, përveç aktiveve tatimore të shtyra rishikohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka evidenca për zhvlerësim. Nëse ka evidenca të tilla, atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivitetit. Humbje nga zhvlerësimi njihet nëse vlera kontabël e një aktivi ose e njësisë gjeneruese të mjeteve monetare tejkalon vlerën e rikuperueshme. Njësia gjeneruese e mjeteve monetare është grupi më i vogël i identifikueshëm i aktiveve që gjeneron rrjedhje monetare, të cilat janë të pavarura nga aktivet dhe grupet e tjera. Humbjet nga rënia në vlerë njihen në pasqyrën e veçantë përmbledhëse të të ardhurave.

Vlera e rikuperueshme e një aktivi ose e njësisë gjeneruese të mjeteve monetare është vlera më e madhe ndërmjet vlerës së drejtë minus kostot e shitjes dhe vlerës së tij në përdorim. Në vlerësimin e vlerës në përdorim, flukset e çmuara të ardhshme të mjeteve monetare janë skontuar në vlerën e tyre aktuale duke përdorur një normë skontimi para tatimit, që reflekton vlerësimin aktual të tregjeve për vlerën në kohë të parasë dhe rreziqet specifike për aktivin. Humbjet e mëparshme rishikohen për të vlerësuar nëse zhvlerësimi është ulur apo nuk ekziston më. Një humbje anulohet nëse ka evidencë se nuk ka zhvlerësim dhe ka patur ndryshim në vlerësimet e përdorura për përcaktimin e vlerës së rikuperueshme. Humbja nga zhvlerësimi anulohet deri në atë masë sa vlera kontabël e aktivitetit nuk tejkalon vlerën kontabël që do të përcaktohej duke i zbritur amortizimin dhe sikur të mos ishte njohur ndonjë humbje nga zhvlerësimi.

(t) Provigjonet

Një provigjon njihet nëse, si rezultat i ngjarjeve të mëparshme, Banka ka një detyrim ligjor ose konstruktiv, i cili mund të matet në mënyrë të besueshme dhe është e mundur që të mira ekonomike do të kërkohen për shlyerjen e këtij detyrimi. Provigjonet caktohen duke skontuar rrjedhjet e pritshme të parave me një normë para tatimit, e cila reflekton vlerën e tregut dhe nëse është e përshtatshme, rrezikun specifik të detyrimit.

Humbjet nga provigjonet e huave për detyrime dhe angazhime të mundshme

Angazhimet dhe detyrimet e mundshme të tilla si marrëveshjet undraën të jepen në rast se ata detyrohen formalisht. Detyrimet mund të zhvillohen në një mënyrë që nuk priten fillimisht. Për këtë arsye ato vlerësohen vazhdimisht për të përcaktuar nëse një dalje e burimeve që përpëmbajnë një përfitim ekonomik është bërë e mundshme. Në qoftë se detyrimi rezulton me një obligim aktual, i cili mund të matet në mënyrë të besueshme, duhet njohur një provigjon në pasqyrat financiare të veçanta.

3. Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)**(t) Provigjonet (vazhdim)**

Vetëm angazhimet e parevokueshme mund të shkaktojnë një rrezik kredie, prandaj vetëm angazhimet dhe pasiguritë e parevokueshme mund të jenë subjekt i provigjonimit. Për ekspozimet e rëndësishme, vlerësimi bëhet në mënyrë individuale. Në rastet e vlerësimeve të bazuara në portofol, ndërtimi i portofolit dhe llogaritja e provigjoneve të bazuara në portofol duhet të bëhen siç tregohet në zhvlerësimet e Huave dhe Paradhëniet për klientët.

(u) Angazhime të lidhura me kreditë

Banka lëshon garanci financiare dhe angazhime për të siguruar kredi. Garancitë financiare paraqesin garanci të pakthyeshme për të bërë pagesa në rast se një klient nuk mund të përmbushë detyrimet e saj ndaj të tretëve, dhe mbajnë të njëjtin rrezik kredie si huatë. Garancitë dhe angazhimet për të siguruar një kredi financiare njihen fillimisht me vlerën e tyre të drejtë, e cila është evidentuar normalisht nga shuma e tarifave të marra. Kjo shumë është e amortizuar në një bazë lineare mbi jetën e angazhimit, me përjashtim të angazhimeve me origjinë huatë në qoftë se është e mundur që Banka do të hyjë në një marrëveshje të veçantë të kreditimit dhe nuk pret të shesë kredi pas nisjes së marrëveshjes; tarifa të tilla në angazhimin e kredisë janë të shtyrë dhe janë përfshirë në vlerën kontabël neto të kredisë në njohjen fillestare. Në fund të çdo periudhe raportuese, angazhimet maten me vlerën më të lartë të (i) bilancit të mbetur të paamortizuar të shumës në njohjen fillestare dhe (ii) vlerësimin më të mirë të shpenzimit të kërkuar për të shlyer përkushtimin në fund të çdo periudhe raportimi.

(v) Paraqitja e pasqyrës së pozicionit financiar sipas likuiditetit

Banka nuk ka një cikël operativ në mënyrë të qartë të identifikueshme dhe për këtë arsye nuk paraqet aktivet dhe pasivet aktuale dhe afatgjata ndaras në pasqyrën e pozicionit financiar. Në vend të kësaj, Analiza e aktiveve dhe pasiveve sipas maturiteteve të tyre të pritshme paraqitet në Shënimin 36.

(w) Krahasueshmëria

Të gjitha shumat janë raportuar apo zbulohen me informacionin krahasues.

4. Vlerësime dhe gjykime të rëndësishme kontabël

Banka bën vlerësime dhe supozime të cilat ndikojnë shumat e njohura në pasqyrat financiare, dhe vlerat kontabël të aktiveve dhe detyrimeve brenda vitit të ardhshëm financiar. Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në përvojën e drejtimit dhe të faktorëve të tjerë, duke përfshirë pritjet e ngjarjeve të ardhshme të cilat besohet të jenë të arsyeshme në rrethanat.

Menaxhimi gjithashtu bën gjykime të caktuara, përveç atyre që përfshijnë vlerësimet, në procesin e zbatimit të politikave kontabël.

Vlerësimet që kanë efekt të konsiderueshëm në vlerat kontabël në pasqyrat financiare dhe vlerësimeve që mund të sjellë një rregullim të rëndësishëm në vlerën kontabël të aktiveve dhe detyrimeve brenda vitit të ardhshëm financiar përfshijnë:

i. Provigjone për humbje nga kreditë

Banka rishikon rregullisht protofolin e kredisë për të përcaktuar zhvlerësim. Në përcaktimin nëse një humbje nga zhvlerësimi duhet të regjistrohet në pasqyrën e të ardhurave për vitin, Banka bën gjykime nëse ka ndonjë të tregues të dukshëm që tregon se ka një ulje të ndjeshme në flukset e vlerësuara të mjeteve monetare të ardhshme nga një portofoli i kredive para se rënia mund të identifikohet me një kredi specifike e atij portofoli. Kjo evidencë mund të përfshijë të dhëna që tregojnë se ka pasur një ndryshim negativ në statusin e pagesave të huamarrësve në grup, ose të kushteve ekonomike kombëtare dhe rajonale që lidhen me mungesat në aktivet në grup.

Drejtimi përdor vlerësime të bazuara në përvojën historike për humbjet nga aktivet me karakteristika të rrezikut të kredisë dhe prova objektive të zhvlerësimit të ngjashme me ato në portofolin kur caktimin flukset e ardhshme të parasë.

Metodologjia dhe supozimet e përdorura për të vlerësuar të dy sasinë dhe kohën e flukseve monetare të ardhshme rishikohen rregullisht për të reduktuar diferencat midis vlerësimeve të humbjeve dhe përvojës aktuale të humbjes.

4. Vlerësime dhe gjykime të rëndësishme kontabël (vazhdim)

Humbjet nga zhvlerësimi për kreditë të rëndësishme individualisht janë të bazuar në vlerësimet e flukseve monetare të ardhshme të skontuara të kredive individuale, duke marrë në konsideratë. Pagesa dhe realizimin me çfarëdo lloj aktivi që mbahen si kolateral kundrejt huave. Një rritje 10% apo ulje në përvojën aktuale të humbjeve në krahasim me të ardhmen e vlerësuar skontuar flukset monetare nga kreditë të rëndësishme individualisht, të cilat mund të lindin nga dallimet në sasi dhe kohën e flukseve të mjeteve monetare, do të rezultojë në rritjen në vlerë të zhvlerësimit të huave me 68,962 mijë LEK respektivisht, (2014: 719,869 mijë LEK) ose një rënie të humbjeve nga zhvlerësimi të kredisë 48,091 mijë LEK (2014: 645,263 mijë LEK) respektivisht.

ii. Përcaktimi i vlerës së drejtë të letrave me vlerë të investimit

Informacioni dhe analiza e ndjeshmërisë për vlerat e drejta të instrumenteve që janë vlerësuar duke përdorur supozime të cilat nuk janë të bazuara në të dhëna të dukshme të tregut, është shpalosur në Shënimin 35.

5. Adoptimi i standardeve të reja të rishikuara dhe interpretimet

Standardet e reja dhe interpretimet e mëposhtme u bene efektive për Kompaninë që prej 1 janar 2015:

Standartet e mëposhtme, të cilat janë kryesisht amendime të standardeve ekzistuese dhe interpretime të nxjerra nga Bordi Nderkombëtar i Standardeve Kontabël janë efektive për periudhën aktuale.

- **Ndryshimet e SNK 19 “Perfitimet e punonjesve”** – Përcaktimi i planeve të perfitimit: Kontributet e Punonjesve (efektive për periudhat që fillojnë nga 1 korrik 2014),
- **Ndryshime në standartet e ndryshme “Permirësimet e SNRF-ve (cikli 2010-2012)”** – Ndryshime që rezultojnë nga rishikimi vjetor që u është bërë SNRF-ve (SNRF 2, SNRF 3, SNRF 8, SNRF 13, SNK 16, SNK 24 dhe SNK 38) kryesisht me qëllim që të shmangen mosperputhjet dhe të qartësohet formulimi i standartit (ndryshimet duhet të zbatohen për periudhat vjetore që fillojnë nga data 1 korrik 2014),
- **Ndryshime në standartet e ndryshme “Permirësimet e SNRF-ve (cikli 2011-2013)”** - Ndryshime që rezultojnë nga rishikimi vjetor që u është bërë SNRF-ve (SNRF 1, SNRF 3, SNRF 13 dhe SNK 40), kryesisht me qëllim që të shmangen mosperputhjet dhe të qartësohet formulimi i standartit (ndryshimet duhet të zbatohen për periudhat vjetore që fillojnë nga data 1 korrik 2014).

Adaptimi i këtyre ndryshimeve tek standartet ekzistuese nuk ka çuar në ndryshime për sa i përket politikave kontabël të Bankes.

RAIFFEISEN BANK SH.A.

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare individuale për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
(shumat në LEK'000)

6. Deklarime të reja kontabël

Disa standarte dhe interpretime të reja të cilat janë të detyrueshme për t'u zbatuar duke filluar nga 1 janari 2016 e në vazhdim janë publikuar, dhe Banka nuk i ka adaptuar ende:

- **SNRF 9 "Instrumentat financiare" – (efektive për periudhat që fillojnë nga 1 janari 2018).** Ky standard i ri përdor një mënyrë të vetme për të përcaktuar nëse një instrument financiar duhet të matet me koston e amortizuar apo vlerën e drejte, duke zëvendësuar kështu rregullat e ndryshme që përdorte SNK 39. Metoda e përdorur nga SNRF 9 bazohet në mënyrën se si Banka menaxhon instrumentat e saj financiare (modeli i saj i biznesit) dhe karakteristikat kontraktuale të flukseve monetare që derivojnë nga instrumentat financiare. Standarti i ri kërkon gjithashtu që të përdoret një mënyrë e vetme zhvleresimi, duke zëvendësuar kështu metodat e ndryshme që përdorte SNK 39. Kërkesat e reja për kontabilizimin e detyrimeve financiare trajtojnë problemin e luhatshmerisë në fitimin ose humbjen që vjen nga emetuesi duke zgjedhur kështu matjen e borxhit me vlerën e drejte. BSNK-ja vendosi të mbajë matjen ekzistuese me koston e amortizuar për shumicën e detyrimeve, duke kufizuar ndryshimin vetëm në elemente që lidhen me trajtimin e problematikave të kreditimit të vetë entitetit. Me kërkesat e reja një entitet që vendos të masë detyrimet financiare me vlerën e drejte duhet të paraqesë vlerën e ndryshimit në vlerën e drejte si rezultat i ndryshimit në riskun e kredise të vetë entitetit, në seksionin e të ardhurave të tjera përmbledhese dhe jo të trajtoje ato si fitim apo humbje. Ndryshimet e nxjerra që nga Nentori 2013 japin një efekt pozitiv për sa i përket adaptimit të kontabilitetit mbrojtës çka do lejojë kompanitë të reflektojnë në pasqyrat financiare riskun e tyre të menaxhimit. Ndryshimet lejojnë adresimin e të ashtuqujturit "kreditit i vet Bankes", problematike që është përfshirë tashmë në SNRF 9 "Instrumentat financiare" dhe që mund të zbatohet në mënyrë të izoluar pa pasur nevojën e ndryshimeve të politikave të tjera kontabël që lidhen me instrumentat financiare.
- **SNRF 14 "Rregullimi i Llogarive të Shtyra" - (efektive duke filluar 1 Janar 2016 e në vazhdim)**
- **SNRF 15 "Te ardhura nga Kontratat me Klientet" dhe ndryshime të metejshme (efektive duke filluar 1 Janar 2018 e në vazhdim),**
- **SNRF 16 "Qirate" (efektive duke filluar 1 janar 2019 e në vazhdim),**
- **Ndryshime në SNRF 10 "Pasqyrat financiare të konsoliduara" dhe SNK 28 "Investime në pjesëmarrje dhe sipërmarrje të përbashketa"-** Shitja apo kontributi i pasurive ndërmjet një investitori dhe bashkëpunëtorit të tij ose sipërmarrje të përbashkete (efektiv për periudhat vjetore që fillojnë me apo pas datës 1 janar 2016),
- **Ndryshime në SNRF 10 "Pasqyrat financiare të konsoliduara" dhe SNRF 12 "Dhenia e informacioneve shpjeguese për përfshirje me entitete të tjera" dhe SNK 28 "Investime në pjesëmarrje dhe sipërmarrje të përbashketa" -** Subjektet e investimeve: Përfshirje konsolidimi (efektiv për periudhat vjetore që fillojnë me apo pas datës 1 Janar 2016),
- **Ndryshime në SNRF 11 "Marreveshjet e përbashketa" -** Kontabiliteti për blerjet e interesave në operacionet e përbashkete (efektiv për periudhat vjetore që fillojnë me apo pas datës 1 Janar 2016),
- **Ndryshime në SNK 1 "Paraqitja e pasqyrave financiare" -** Iniciativat e zbulimit (efektiv për periudhat vjetore që fillojnë me apo pas datës 1 Janar 2016),
- **Ndryshimet në SNK 7 "Pasqyra e Fluksit të Parase" -** Nisma Per Paraqitje (efektive për periudhat vjetore që fillojnë me ose pas 1 Janar 2017),

RAIFFEISEN BANK SH.A.

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare individuale për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
(shumat në LEK '000)

6. Deklarime të reja kontabël (vazhdim)

- **Ndryshime ne SNK 12 "Tatimet mbi te ardhurat"**, - Njohja e aktiveve tatimore te shtyra per Humbjet e Parealizuara (efektive per vjetore periudhat qe fillojne me ose pas dates 1 Janar 2017)
- **Ndryshime ne SNK 16 "Prona, Impiantet dhe Pajisjet" dhe SNK 38 "Aktive jo-materiale"** - Sqarim i metodave te pranueshme te zhvleresimit dhe amortizimit (efektiv per periudhat vjetore qe fillojne me apo pas dates 1 Janar 2016),
- **Ndryshime ne SNK 16 "Prona, Impiantet dhe Pajisjet" dhe SNK 41 "Agrobiznesi"** - Agrobiznes: Bimet bartesi (efektiv per periudhat vjetore qe fillojne me apo pas dates 1 Janar 2016),
- **Ndryshime ne SNK 27 "Pasqyrat financiare individuale"** - Metoda e kapitalit ne pasqyrat financiare individuale (efektiv per periudhat vjetore qe fillojne me apo pas dates 1 Janar 2016),

Ndryshime ne disa standarde "Permiresimet e SNRF-ve (2012-2014)" qe rezultojne nga projekti i permiresimit vjetor te SNRF-ve (SNRF 5, SNRF 7, SNRF13, SNK 19, SNK 34) kryesisht me qellim heqjen e mosperputhjeve dhe sqarimin e fjaleve (ndryshimet duhet te aplikohen per periudhat vjetore qe fillojne me apo pas dates 1 Janar 2016).

Banka ka vendosur te mos i adaptoje keto standarde, rishikime dhe interpretime perpara datave efektive te tyre. Pervec impaktit te SNRF 9, i cili do te vleresohet nga kompania gjate vitit 2016, Banka beson se adaptimi i standarteve te reja, rishikimeve dhe interpretimeve nuk do te kete ndikim material ne pasqyrat individuale financiare te Bankes ne periudhen fillestare te aplikimit.

7. Paraja dhe ekuivalentët e saj

	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
<i>Arka</i>	3,172,435	3,323,499
<i>Banka Qëndrore</i>		
Llogari rrjedhëse	33,252,590	373,399
Depozita	-	7,000,000
Interesi i përlllogaritur i depozitave	-	96
<i>Banka</i>		
Llogari rrjedhëse me bankat jo- rezidente	1,784,395	915,868
Depozita me bankat rezidente me maturitet me të vogël se tre muaj	2,404,100	2,853,975
Depozita me bankat jo- rezidente me maturitet me të vogël se tre muaj	37,436,138	26,165,382
Totali	78,049,658	40,632,219

Llogaritë rrjedhëse me Bankën Qëndrore nuk fitojnë interes.

Norma e interesit e depozitave të Bankës me Bankën Qëndrore më 31 dhjetor 2014 ka qenë 0.5% .

Normat vjetore të interesit mbi depozitat me afat me bankat rezidente më 31 dhjetor 2015 variojnë nga 1.20% deri në 1.75% (31 dhjetor 2014: 1.50% deri në 2.25%). Normat vjetore të interesit mbi depozitat me afat me bankat jo-rezidente më 31 dhjetor 2015 variojnë nga -0.11% deri në 0.128% (31 dhjetor 2014: 0.05% deri në 0.8%).

RAIFFEISEN BANK SH.A.

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare individuale për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015

(shumat në LEK '000)

8. Shuma të kushtëzuara

	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
<i>Banka Qëndrore</i>		
Rezerva e detyrueshme	23,342,882	22,146,997
<i>Banka</i>		
Depozita me bankat jorezidente me maturitet original më shumë se tre muaj	3,432,978	-
Llogari garancie	1,856,458	703,575
Totali	28,632,318	22,850,572

Rezerva e detyrueshme me Bankën Qëndrore nuk është për përdorim të përditshëm nga Banka dhe përfaqëson një rezervë minimale depozite, të kërkuar nga Banka Qëndrore e Shqipërisë. Rezerva të tilla llogariten si 10% i shuma mesatare e depozitave për muajin të detyruar ndaj bankave dhe klientëve, dhe janë si në LEK dhe në monedhë të huaj (USD dhe EUR).

Normat e interesit të depozitave me bankat jorezidente më 31 dhjetor 2015 variojnë nga -1% deri në 1.85% (31 dhjetor 2014: asnjë).

Analiza e cilësisë së parasë, ekuivalentëve të saj dhe shumave të kushtëzuara mund të përmblihet bazuar vlerësimet e Standard and Poor si më poshtë më 31 dhjetor 2015:

	2015	2014
As në vonesë apo të zhvlerësuara		
A-1	11,744,571	6,040,445
A-1+	2,553,599	2,621,881
A-2	21,671,089	10,607,286
A-3	3,398	26,278
B	26,083	26,627
P-1	6,110,640	-
Të pavlerësuara	64,572,596	44,160,274
Vlera Kontabël	106,681,976	63,482,791

Në balancën e pavlerësuar përfshihet arka dhe balancat me Bankën Qendrore.

9. Investime në letra me vlerë**9.1 Investime të mbajtura për tregtim**

Letrat me vlerë të tregëtueshme përfshijnë bonot e thesarit të qeverisë shqiptare dhe Obligacione të qeverisë si më poshtë:

	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
Obligacione të qeverisë	20,996,111	28,339,952
Bono thesari	1,932	1,332
Totali	20,998,043	28,341,284

Bonot e thesarit më 31 dhjetor 2015 i referohen bonove të qeverisë me kupon zero me normë të brendshme kthimi që varion nga 2.45% deri në 3.64% në vit (31 dhjetor 2014: nga 3.21% deri në 3.9%).

Obligacionet e qeverisë më 31 dhjetor 2015 kanë të bëjnë me obligacionet në Lek 2- vjeçare, 3- vjeçare, 5- vjeçare dhe 7- vjeçare të emetuara nga qeveria e Shqipërisë me normë kuponi nga 4.82% deri në 10.85% në vit (31 dhjetor 2014: nga 4.04% deri në 10.85%).

RAIFFEISEN BANK SH.A.

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare individuale për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
(shumat në LEK'000)

9. Investime në letra me vlerë (vazhdim)**9.2 Investime të mbajtura deri në maturim**

Investime të mbajtura deri në maturim përfshijnë bono thesari dhe obligacione të qeverisë shqiptare si më poshtë:

	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
Obligacione të qeverisë (Shënimi 9.2.1)	30,133,064	33,250,417
Obligacione të qeverisë jo rezidente (Shënimi 9.2.3)	-	5,802,783
Bonde korporatash	4,115,251	2,939,700
Bono thesari (Shënimi 9.2.2)	17,686,691	17,541,113
Totali	51,935,006	59,534,013

Më 31 dhjetor 2015 nuk janë mbajtur bono thesari si garanci për portofolin e marrëveshjeve të anasjellta të riblerjes (2014: asnjë)

9.2.1 Obligacionet e qeverisë

Obligacionet e qeverisë më 31 dhjetor 2015 kanë të bëjnë me obligacionet në LEK 2-year, 3-vjeçare, 5-vjeçare, 7-vjeçare dhe 10-vjeçare të emetuara nga qeveria e Shqipërisë me përqindje kuponi nga 4.04% në 10.85% në vit (31 dhjetor 2014: nga 4.69% në 11.00%).

	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
Vlera nominale e obligacioneve	29,680,425	32,704,194
Primi i paamortizuar	3,304	3,717
Interesi i përllogaritur	449,335	542,506
Totali	30,133,064	33,250,417

9.2.2 Obligacionet e qeverisë jo rezidente

Nuk ka obligacione të qeverisë jo rezidente më 31 dhjetor 2015 (31 dhjetor 2014: bonde 1-vjeçare në EUR me përqindje kuponi 3.5% në vit).

	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
Vlera nominale e bondeve	-	5,605,600
Primi i paamortizuar	-	62,265
Interesi i përllogaritur	-	134,918
Totali	-	5,802,783

RAIFFEISEN BANK SH.A.

- Zhvillimin dhe përdorimin e sistemit të vlerësimit të rrezikut të Bankës në mënyrë që të kategorizojë ekspozimin në bazë të shkallës së rrezikut të humbjeve financiare, dhe të fokusojë Drejtimin në rreziqet aktuale të Bankës. Sistemi i kategorizimit të rrezikut përdoret për të përcaktuar se kur duhet të krijohen fonde për zhvlerësime të mundshme kundrejt ekspozimeve specifike ndaj rrezikut të kreditimit. Sistemi aktual i kategorizimit të rrezikut konsiston prej dhjetë kategorish, të cilat reflektojnë shkallën e rrezikut të mospagimit dhe disponibilitetin e kolateraleve, ose lehtësime të tjera të rrezikut të kreditimit. Përgjegjësia për të caktuar nivelet e rrezikut është e niveleve që aprovojnë kredinë. Kategoritë e rrezikut janë subjekt i vëzhgimeve nga Divizioni i Administrimit të Rrezikut të Kreditimit të Bankës.
- Monitorimin e zbatimit të kufijve të aprovuar të ekspozimit nga njësitë e biznesit, duke përfshirë dhe ato për industritë e zgjedhura, rrezikut të vendit dhe llojeve të produkteve. Divizioni i Administrimit të Rrezikut të Kredisë merr dhe shqyrton rregullisht raporte mbi cilësinë e kreditimit dhe ndërmerr veprime përkatëse korrigjuese.
- Sigurimin e këshillave, udhëzimeve dhe aftësi të specializuara njësisve të biznesit për të zhvilluar praktikat më të mira për administrimin e rrezikut të kreditimit në të gjithë Bankën.

Çdo njësi biznesi duhet të zbatojë politikat dhe procedurat e Bankës për administrimin e rrezikut të kreditimit. Kontrolli i brendshëm kryen në mënyrë të rregullt kontrolle ndaj njësisve të biznesit dhe Divizionit të Administrimit të Rrezikut të Kredisë.

Ekspozimi maksimal i Bankës ndaj rrezikut të kredisë është reflektuar në vlerat kontabël të aktiveve financiare në pasqyrë e pozicionit financiar. Për garancitë dhe angazhimet për të zgjeruar kredinë, ekspozimi maksimal ndaj riskut të kredisë është shuma e angazhimit. Referojuni shënimit 10. Rreziku i kreditit zbutet nga kolateralit dhe përmirësime të tjera të kredisë siç paraqitet në shënimin 10.

Banka strukturon nivelet e riskut të kredisë që ajo ndërmerr duke vendosur limite në shumën e rrezikut të pranuar në lidhje me një huamarrës, apo grupe huamarrësish, dhe për segmentet gjeografike dhe të industrisë. Kufijtë në nivelin e rrezikut të kredisë nga produkti dhe të sektorit të industrisë janë miratuar rregullisht nga drejtimi. Rreziqet të tilla monitorohen mbi baza të përtëritshme dhe janë subjekt i një rishikimi vjetor, apo më të shpeshtë.

Departamenti i kredisë së Bankës rishikon analizën e maturitetit të së tepricës së kredisë dhe ndjek balancat në vonesë. Menaxhimi, pra, e konsideron të përshtatshëm paraqitjen e maturitetit dhe informacione të tjera në lidhje me rrezikun e kredisë të paraqitura në shënimet shpjeguese 8,9,10.

Kërkesat për kredi të ngritura nga menaxherët përkatës të marrëdhënieve me klientët i kalohen në të komisionit përkatës të kredisë për miratimin e kufirit të kredisë. Ekspozimi ndaj rrezikut të kredisë administrohet, pjesërisht me marrjen e kolateraleve dhe garancive të korporatave dhe personale. Për të monitoruar ekspozimet e rrezikut të kreditit, raportet e rregullta janë të prodhuara nga zyrtarët e departamentit të kredisë në bazë të një analize të strukturuar duke u fokusuar në biznesin e konsumatorit dhe performancën financiare. Çdo ekspozimi i rëndësishëm për klientët me përkeqësimit kreditore i raportohen dhe rishikohen nga Bordi i Drejtorëve dhe Komiteti i Kredisë së Bankës. Banka përdor vlerësime të brendshme të formalizuara të kredisë për të monitoruar ekspozimin ndaj riskut të kredisë. Drejtimi i monitoron dhe ndjek balancat në vonesë.

Rreziku i kredisë për zërat jashtë bilancit përcaktohet si mundësia për mbajtjen e një humbje si rezultat i dështimit i një pale tjetër për një instrument financiar për të kryer në përputhje me kontratën. Grupi përdor politikat e njëjta të kredisë në marrjen e detyrimeve të kushtëzuara siç bën për instrumenteve financiare në bilanc, të krijuara përmes miratimeve të kreditit, kufijve të kontrollit të riskut dhe procedurave të monitorimit.

RAIFFEISEN BANK SH.A.

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare individuale për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015

(shumat në LEK'000)

32. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(c) Rreziku i tregut

Banka merr përsipër ekspozime të rrezikut të tregut. Rreziqet e tregut lindin nga pozicionet e hapura në : (a) monedha, (b) normat e interesit dhe (c) produktet e të kapitalit të gjithë të cilat janë të ekspozuar ndaj lëvizjeve të përgjithshme dhe specifike të tregut. Drejtimi vendos limite në vlerën e rrezikut që mund të jenë të pranueshme. Megjithatë, përdorimi i kësaj qasjeje nuk i ndalon humbjet jashtë këtyre kufijve në rast të lëvizjeve të mëdha të tregut. Objektivi i administrimit të rrezikut të tregut është të manaxhojë dhe kontrollojë që ekspozimi ndaj rrezikut të tregut të jetë brenda parametrave të pranueshëm, ndërkohë që optimizon kthimin nga rreziku.

Administrimi i rrezikut të tregut

Banka e ndan ekspozimin ndaj rrezikut të tregut në portofole të tregtueshme dhe jo të tregtueshme. Portfolet e tregtueshme përfshijnë pozicione që lindin nga lëvizjet e tregut bashkë me aktivet dhe detyrimet financiare që drejtohen mbi bazën e vlerës së drejtë.

Autoriteti i përgjithshëm për rrezikun e tregut i është dhënë ALCO-s. Departamenti i Rrezikut të Bankës është përgjegjës për zhvillimin e politikave të detajuara të manaxhimit të rrezikut (subjekt ndaj rishikimit dhe aprovimit nga ALCO) dhe për mbikqyrjen ditore të implementimit të tyre. Banka është e ekspozuar ndaj ndikimeve të ndryshimeve në kurset e këmbimit në pozicionin financiar dhe flukseve të parave. Mjeti parësor i përdorur për matjen dhe kontrollin e rrezikut të tregut brenda portofolit të tregtueshëm të Bankës është vlera me rrezik (VaR). VaR i rrezikut një portofoli të tregtueshëm është humbja e vlerësuar që do të shfaqet në një portofol gjatë një periudhe të caktuar kohe (periudha e mbajtjes) si rrjedhojë e lëvizjeve të pafavorshme të tregut me një probabilitet të specifikuar (niveli i besueshmërisë)

Ekspozimi ndaj rrezikut të kursit të këmbimit

Banka është e ekspozuar ndaj rrezikut të kursit të këmbimit për shkak të transaksioneve në monedhë të huaj. Duke qënë se Banka i prezanton pasqyrat e saj financiare të veçanta në Lek, pasqyrat e veçanta financiare të Bankës ndikohen nga lëvizjet e kursit të këmbimit ndërmjet Lek-ut dhe monedhave të tjera. Bordi i Drejtorëve vendos limitet e niveleve të ekspozimit për të dyja pozicionet; brenda ditës dhe gjatë natës "overnight", të cilat monitorohen çdo ditë nga Thesari dhe Zyra e ndërmjetme.

RAIFFEISEN BANK SH.A.

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare individuale për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
(shumat në LEK'000)

32. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)**(c) Rreziku i tregut (vazhdim)**

Tabela e mëposhtme përmbledh ekspozimin e Bankës ndaj riskut të kursit të këmbimit për periudhën e raportimit:

	31 dhjetor 2015			31 dhjetor 2014		
	Aktive financiare monetare	Pasive financiare monetare	Pozicioni neto	Aktive financiare monetare	Pasive financiare monetare	Pozicioni neto
LEK	134,729,222	115,561,557	19,167,665	139,227,265	119,372,710	19,854,555
US Dollars	20,803,426	15,180,281	5,623,145	16,440,873	14,182,146	2,258,727
Euro	122,051,323	121,209,406	841,917	108,806,237	105,074,312	3,731,925
Të tjera	6,367,317	6,368,983	(1,666)	5,646,712	5,383,711	263,001
Totali	283,951,288	258,320,227	25,631,061	270,121,087	244,012,879	26,108,208

Banka gjithashtu përgatit rregullisht testime stresi për të matur ndikimin e ekspozimit ndaj rrezikut të kursit të këmbimit të monedhës së huaj. Tabela e mëposhtme paraqet ndjeshmërinë e fitimit ose humbjes për ndryshime të arsyeshme të mundshme në kurset e këmbimit të aplikuar në fund të periudhës raportuese në krahasim me monedhën e paraqitjes, me variablat e tjerë të mbajtur të pandryshuar:

<i>Në mijë LEK</i>	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
	Ndikimi ne fitim / humbje	Ndikimi ne fitim / humbje
US Dollar vlerësim me 10% (2014: vlerësim me 10%)	411	42,208
US Dollar zhvlerësim me 10% (2014: zhvlerësim me 10%)	(411)	(42,208)
Euro vlerësim me 10% (2014: vlerësim me 10%)	633,073	46,277
Euro zhvlerësim me 10% (2014: zhvlerësim me 10%)	(633,073)	(46,277)
Te tjera vlerësim me 10% (2014: vlerësim me 10%)	(374)	22,318
Te tjera zhvlerësim me 10% (2014: zhvlerësim me 10%)	374	(22,318)

RAIFFEISEN BANK SH.A.

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare individuale për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015

*(shumat në LEK '000)***32. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)****(c) Rreziku i tregut (vazhdim)***Ekspozimi ndaj rrezikut të normave të interesit*

Grupi merr përsipër ekspozimin ndaj efekteve të luhatjeve në nivelet ekzistuese të normave të interesit të tregut në pozicionin e saj financiar dhe flukseve të parasë. Marzhet e interesit mund të rritet si rezultat i ndryshimeve të tilla, por mund të zvogëlojë ose të krijojë humbje në rast se lëvizje të papritura të lindin. Rreziku i normës së interesit menaxhohet kryesisht nëpërmjet diferencat midis normave të interesit të monitorimit dhe duke pasur limite paraprakisht të miratuara për grupe "reprising". ALCO është organi që monitoron zbatimin eith këtyre kufijve dhe ndihmohet nga administrimin e rrezikut në veprimtarinë e saj e ditë-për-ditë e monitorimit.

Administrimi i rrezikut të normave të interesit mbështetet edhe nga monitorimi i ndjeshmërisë së aktiveve dhe detyrimeve të Bankës ndaj skenarëve të ndryshëm të interesave standard dhe jo standard. Skenarët standard, të cilët merren në konsideratë në mënyrë të rregullt, përfshijnë 100 pika bazë (pb) rënie ose ngritje paralele në të gjitha normat e brendshme të kthimit. Më poshtë është paraqitur analiza e ndjeshmërisë ndaj rënies dhe ngritjes së normës së interesit (duke marrë parasysh që nuk ka lëvizje asimetrike në normën e kthimit dhe një pozicion financiar konstant).

Nëse normat e interesit ka qenë 100 pikë bazë më e ulët (2014: [100] pikë bazë më e ulët), me variablat e tjerë të mbajtur të pandryshuar, humbja do të ishte 410,193 mijë LEK (2014: 496,656 mijë lekë) më e ulët.

Nëse normat e interesit ka qenë 100 pikë bazë më e lartë (2014: [100] pikë bazë më e lartë), me variablat e tjerë të mbajtur të pandryshuar, fitimi do të ishte 744,195 mijë LEK (2014: 737,697 mijë lekë) më e lartë.

2015**Skenari deri në një vit**

	100 bp	100 bp
	Rritje	Rënie
Ndikimi në fitim/(humbje)	744,195	(410,193)

2014**Skenari deri në një vit**

	100 bp	100 bp
	Rritje	Rënie
Ndikimi në fitim/(humbje)	737,697	(496,656)

Ekspozimi ndaj rrezikut të normave të interest manaxhohet nga departamenti i Thesarit, i cili përdor investimet në letra me vlerë, huatë dhe depozitat ndaj bankave për të manaxhuar ekspozimin total të Bankës nga aktivitetet e saj tregtuese dhe jo-tregtuese.

RAIFFEISEN BANK SH.A.

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare individuale për vitin e mbylltur më 31 dhjetor 2015
(shumat në LEK'000)

32. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)**(c) Rreziku i tregut (vazhdim)**

Më poshtë paraqitet një përmbledhje e analizës së riçimitit të normave të interesit të Bankës:

Aktivet	31 dhjetor 2015						
	Deri në 1 muaj	1 deri në 3 muaj	3 deri në 6 muaj	6 muaj deri në 12 muaj	Mbi 1 vit	Pa specifikuar	Totali
Paraja dhe ekuivalentët e saj	78,049,476	-	-	-	-	-	78,049,476
Shuma të kushtëzuara	28,632,500	-	-	-	-	-	28,632,500
Investime të tregtueshme	160	557,108	1,217,541	3,859,968	15,363,266	-	20,998,043
Investime të mbajtura deri në maturim	3,981,088	6,920,289	5,844,383	15,569,095	19,620,151	-	51,935,006
Investime të mbajtura për shifje	-	-	-	450,310	2,973,548	-	3,423,858
Hua dhe paradhënie për klientët	14,201,282	14,925,675	14,865,834	55,128,365	2,389,826	(598,576)	100,912,406
Aktive të tjera	12,067	-	-	-	-	-	12,067
Totali	124,876,573	22,403,072	21,927,758	75,007,738	40,346,791	(598,576)	283,963,356
Detyrimet							
Detyrime ndaj institucioneve financiare	2,232,929	-	-	-	-	-	2,232,929
Detyrime ndaj klientëve	151,209,204	21,012,189	16,423,649	56,218,298	2,116,869	-	246,980,209
Borxhi i varur	-	-	-	-	9,107,088	-	9,107,088
Total	153,442,133	21,012,189	16,423,649	56,218,298	11,223,957	-	258,320,226
Pozicioni neto më 31 dhjetor 2015	(28,565,560)	1,390,883	5,504,109	18,789,440	29,122,834	(598,576)	25,643,130

RAIFFEISEN BANK SH.A.

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare individuale për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
(shumat në LEK '000)

32. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)**(c) Rreziku i tregut (vazhdim)**

Aktivet	Deri në 1 muaj	1 deri në 3 muaj	3 deri në 6 muaj	6 muaj deri në 12 muaj	Mbi 1 vit	Pa specifikuar	31 dhjetor 2014	
							Totali	Totali
Paraja dhe ekuivalentët e saj	40,632,219	-	-	-	-	-	-	40,632,219
Shuma të kushtëzuara	22,850,572	-	-	-	-	-	-	22,850,572
Investime të tregtueshme	279,341	1,689,835	1,564,836	3,119,592	21,687,680	-	-	28,341,284
Investime të mbajtura deri në maturim	3,744,878	9,941,679	12,692,625	15,220,483	17,934,348	-	-	59,534,013
Investime të mbajtura për shitje	-	-	-	-	6,841,526	-	-	6,841,526
Hua dhe paradhënie për klientët, neto	23,819,810	19,159,253	17,706,283	50,785,765	993,789	(543,427)	-	111,921,473
Aktive të tjera, neto	12,576	-	-	-	-	-	-	12,576
Totali	91,339,396	30,790,767	31,963,744	69,125,840	47,457,343	(543,427)	-	270,133,663
Detyrimet								
Detyrime ndaj institucioneve financiare	2,993,851	-	-	-	-	-	-	2,993,851
Detyrime ndaj klientëve	116,445,644	23,556,037	19,340,165	71,219,618	3,307,772	-	-	233,869,236
Borxhi i varur	-	-	-	-	7,149,792	-	-	7,149,792
Total	119,439,495	23,556,037	19,340,165	71,219,618	10,457,564	-	-	244,012,879
Pozicioni neto më 31 dhjetor 2014	(28,100,099)	7,234,730	12,623,579	(2,093,778)	36,999,779	(543,427)	-	26,120,784

32. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(d) Rreziku i likuiditetit

Rreziku i likuiditetit është rreziku që Banka nuk do të jetë në gjendje të shlyejë detyrimet e saj financiare në kohën e duhur. Banka është e ekspozuar në kërkesa ditore nga burimet e saj të disponueshme të parasë nga depozitat një ditore, llogaritë rrjedhëse, depozitat e maturuara, shtesat e kredive, garancitë dhe kërkesa të tjera për shlyerje në para të instrumentave derivateve.

Administrimi i rrezikut të likuiditetit.

Qëndrimi i Bankës në administrimin e likuiditetit është të sigurojë vazhdimisht likuiditet të mjaftueshëm për të shlyer detyrimet si në kushte normale ashtu edhe në kushte të pafavorshme, pa pësuar humbje të papranueshme apo të rrezikojë të dëmtojë emrin e saj.

Departamenti i Thesarit merr informacion nga njësitë e tjera për sa i përket rrezikut të aktiveve dhe detyrimeve financiare dhe rrjedhjeve të ardhshme të parave, që rezultojnë nga aktivitetet e ardhshme të projektuara. Në bazë të këtij informacioni, Departamenti i Thesarit mban një portofol me aktive afatshkurtra likuide, i përbërë kryesisht nga letra me vlerë me afat të shkurtër, hua dhe paradhënie ndaj bankave të tjera, dhe facilitete të tjera ndërbankare, për të siguruar një nivel të mjaftueshëm likuiditeti të Bankës. Kërkesat e njësisë të biznesit për likuiditet plotësohen nga Departamenti i Thesarit, i cili jep hua afat-shkurtra dhe afat-gjata për të mbuluar ndryshimet afat-shkurtra dhe për financimet afat-gjata.

Pozicioni ditor i likuiditetit monitorohet dhe testohet në mënyrë të rregullt nëpërmjet skenarëve të ndryshëm që mbulojnë kushte normale dhe të pafavorshme të tregut. Të gjitha politikat dhe procedurat janë subjekt i rishikimeve dhe aprovimeve nga ALCO.

RAIFFEISEN BANK SH.A.

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare individuale për vitin e mbylltur më 31 dhjetor 2015
(shumat në LEK '000)

32. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)**(d) Rreziku i likuiditetit (vazhdim)**

Tabela e mëposhtme paraqet rrjedhjet e paaktualizuara të parave të detyrimeve financiare të Bankës dhe angazhimeve të panjohura të huave në bazë të maturitetit më të hershëm kontraktual. Rrjedhjet e pritshme të parave nga këto instrumenta variojnë shumë nga kjo analizë. Për shembull, depozitat pa afat të klientëve priten të kenë një gjendje të qëndrueshme ose në rritje dhe angazhimet e panjohura të huave nuk priten të përdoren menjëherë

Maturitetet kontraktuale të aktiveve dhe detyrimeve financiar.

	Deri në 1 muaj	1 deri në 3 muaj	3 deri në 6 muaj	6 muaj deri në 12 muaj	Mbi 1 vit	Pa specifikuar	Totali
Aktive							31 dhjetor 2015
Paraja dhe ekuivalentët e saj	78,049,476	-	-	-	-	-	78,049,476
Shuma të kushtëzuara	28,632,500	-	-	-	-	-	28,632,500
Investime të tregtueshme	160	557,108	1,217,541	3,859,968	15,363,266	-	20,998,043
Investime të mbajtura deri në maturim	3,981,088	6,920,289	5,844,383	15,569,095	19,620,151	-	51,935,006
Investime të mbajtura për shitje	-	-	-	450,310	2,973,548	-	3,423,858
Hua dhe paradhënie klientëve, neto	17,962,291	12,698,772	7,832,025	33,482,055	42,305,526	(13,368,264)	100,912,405
Aktive të tjera, neto	12,067	-	-	-	-	-	12,067
Totali	128,637,582	20,176,169	14,893,949	53,361,428	80,262,491	(13,368,264)	283,963,355
Detyrime							
Detyrime ndaj institucioneve financiare	2,232,929	-	-	-	-	-	2,232,929
Detyrime ndaj klientëve	151,209,204	21,012,189	16,423,649	56,218,298	2,116,869	-	246,980,209
Detyrime të tjera	1,849,218	-	-	-	-	-	1,849,218
Borxhi i varur	-	-	-	-	9,107,088	-	9,107,088
Totali	155,291,351	21,012,189	16,423,649	56,218,298	11,223,957	-	260,169,444
Garanci dhe Angazhime	1,168,594	1,623,309	1,798,917	8,868,863	12,164,492	-	25,624,175
Rreziku i likuiditetit në 31 dhjetor 2015	(25,485,175)	787,289	269,217	6,011,993	81,203,026	(13,368,264)	49,418,086
Kumulative	(25,485,175)	(24,697,886)	(24,428,669)	(18,416,676)	62,786,349	49,418,086	-

RAIFFEISEN BANK SH.A.

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare individuale për vitin e mbylltur më 31 dhjetor 2015
(shumat në LEK '000)

32. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)**(d) Rreziku i likuiditetit (vazhdim)**

	Deri në 1 muaj	1 deri në 3 muaj	3 deri në 6 muaj	6 muaj deri në 12 muaj	Mbi 1 vit	Pa specifikuar	31 dhjetor 2014
Aktive							
Paraja dhe ekuivalentët e saj	40,632,219	-	-	-	-	-	40,632,219
Shuma të kushtëzuara	22,850,572	-	-	-	-	-	22,850,572
Investime të tregtueshme	279,341	1,689,835	1,564,836	3,119,592	21,687,680	-	28,341,284
Investime të mbajtura deri në maturim	3,744,878	9,941,679	12,692,625	15,220,483	17,934,348	-	59,534,013
Investime të mbajtura për shitje	-	-	-	-	6,841,526	-	6,841,526
Hua dhe paradhënie klientëve, neto	26,821,470	7,963,343	11,441,687	31,978,934	47,294,060	(13,578,021)	111,921,473
Aktive të tjera, neto	12,576	-	-	-	-	-	12,576
Totali	94,341,056	19,594,857	25,699,148	50,319,009	93,757,614	(13,578,021)	270,133,663
Detyrimet							
Detyrime ndaj institucioneve financiare	2,993,851	-	-	-	-	-	2,993,851
Detyrime ndaj klientëve	116,445,644	23,556,037	19,340,165	71,219,618	3,307,772	-	233,869,236
Detyrime të tjera	2,013,498	-	-	-	-	-	2,013,498
Borxhi i varur	-	-	-	-	7,149,792	-	7,149,792
Totali	121,452,993	23,556,037	19,340,165	71,219,618	10,457,564	-	246,026,377
Garanci dhe Angazhime	2,946,124	3,466,788	4,318,202	8,599,943	9,988,430	-	29,319,487
Rreziku i likuiditetit në 31 dhjetor 2014	(30,058,061)	(7,427,968)	2,040,781	(29,500,552)	73,311,620	(13,578,021)	(5,212,201)
Kumulative	(30,058,061)	(37,486,029)	(35,445,248)	(64,945,800)	8,365,820	(5,212,201)	

32. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(e) Rreziku Operacional

Rreziku operacional është rreziku i humbjes së drejtpërdrejtë apo të tërthortë, që vjen si rezultat i një sërë shkaqesh të lidhura me proceset, personelin, teknologjinë dhe infrastrukturën e Bankës, dhe nga faktorë të jashtëm të ndryshëm nga rreziqet e kreditimit, tregut dhe likuiditetit, të tilla si ato që lindin nga kërkesat ligjore dhe rregulluese si edhe nga standardet përgjithësisht të pranuar të sjelljes korporative. Rreziqet operative lindin si pasojë e të gjithë operacioneve të Bankës dhe shqyrtohen nga të gjitha njësitet e biznesit.

Objektivi i Bankës është të manaxhojë rrezikun operacional në mënyrë që të balancojë shmangien e humbjeve financiare dhe dëmtimin e reputacionit të Bankës me kosto efektive, si edhe të shmangë procedurat e kontrollit të cilat kufizojnë iniciativën dhe kreativitetin.

Përgjegjësia parësore për zhvillimin dhe implementimin e kontrolleve për të adresuar rrezikun operacional i caktohet Drejtimit të Lartë për çdo njësi biznesi. Kjo përgjegjësi mbështetet nga zhvillimi i standardeve të përgjithshme të Bankës për manaxhimin e rrezikut operacional në fushat e mëposhtme:

- kërkesa për ndarjen e duhur të detyrave, duke përfshirë dhe autorizimin e pavarur të transaksioneve
- kërkesa për bashkërendimin dhe monitorimin e transaksioneve
- përputhja me kërkesat ligjore dhe rregullative
- dokumentim i kontrolleve dhe i procedurave
- kërkesa për vlerësimin periodik të rreziqeve operationale të analizuar dhe përshtatshmërinë e kontrolleve dhe procedurave për të adresuar rreziqet e identifikuara
- kërkesa për raportimin e humbjeve operationale dhe veprimet rregullues të propozuar
- zhvillimi i planeve rastësore
- trajnim dhe zhvillim profesional
- standardet etike dhe të biznesit
- zvogëlim i rrezikut, duke përfshirë sigurim në rastet kur është efektiv.

Pajtimi me standardet e Bankës mbështetet nga një program kontrollesh periodike të ndërmarra nga Kontrolli i Brendshëm. Rezultatet e kontrolleve të bëra nga Kontrolli i Brendshëm diskutohen së bashku me Manaxhimin e njësisë së biznesit me të cilën lidhen, me përmbledhjet e dorëzuara Komitetit të Kontrollit dhe Drejtimit të Lartë të Bankës.

33. Administrimi i kapitalit

Objektivat e Grupit për menaxhimin e kapitalit janë (i) të jetë në përputhje me kërkesat e kapitalit të vendosura nga Banka Qendrore e Shqipërisë dhe (ii) për të ruaj aftësinë e Bankës për të vazhduar në vijimësi.

Kapitali rregullator

Banka monitoron mjaftueshmërinë e kapitalit të saj duke përdorur, përveç masave të tjera, rregullat dhe raportet e vendosura nga rregullatori Shqiptar, Banka e Shqipërisë ("BSh"), e cila përfundimisht përcakton kapitalin ligjor që kërkohet për përforcimin e biznesit të saj. Rregullorja "Mbi mjaftueshmërinë e kapitalit" është nxjerrë në vijim të Ligjit No. 8269 datë 23 dhjetor 1997 "Mbi Bankën e Shqipërisë" dhe "Ligji Bankar i Republikës së Shqipërisë".

Raporti i Mjaftueshmërisë së Kapitalit

Raporti i Mjaftueshmërisë së Kapitalit është raporti i kapitalit rregullator me aktivet me rrezik dhe zërat jashtë bilancit, të shprehur në përqindje. Minimumi i kërkuar nga Banka e Shqipërisë për Raportin e Mjaftueshmërisë së Kapitalit është 12%.

Raporti i modifikuar i Mjaftueshmërisë së Kapitalit është raporti i kapitalit bazë mbi aktivet me rrezik të ponderuar dhe zërat jashtë bilancit, të shprehur në përqindje. Norma minimale e modifikuar e mjaftueshmërisë së kapitalit është 6%.

RAIFFEISEN BANK SH.A.

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare individuale për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015

(shumat në LEK'000)

33. Administrimi i kapitalit (vazhdim)

Aktivët e Ponderuara për Rrezik

Aktivët ponderohen në përputhje me kategoritë e gjera të rrezikut kombëtar, të cilave i caktohet një peshë rreziku në përputhje me sasinë e kapitalit të pashlyer që është i nevojshëm për mbështetjen e tyre. Aplikohen pesë kategori të ponderimit të rrezikut (0%, 20%, 50%, 100%, 150%); për shembull instrumentat e tregut të parasë kanë një peshë zero në rrezik që do të thotë që për mbajtjen e këtyre aktiveve nuk nevojitet kapital. Aktivët afatgjata materiale mbajnë një peshë 100% të rrezikut, që do të thotë se duhet të mbështeten nga një kapital i njëjtë me 12% të vlerës kontabël. Krediti jashtë bilancit, që lidhet me angazhimet, gjithashtu merret në konsideratë. Me pas, sasitë peshohen me rrezikun duke përdorur të njëjtën përqindje si për aktivët në bilanc.

	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
Totali i aktiveve të ponderuara me rrezik	140,834,515	129,420,983
Kapitali rregullator	24,868,268	24,221,636
Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit	17.66%	18.72%

Raporti i modifikuar i Mjaftueshmërisë së Kapitalit është 12.08% në 31 dhjetor 2015 (31 dhjetor 2014: 15.66%). Politika e Bankës është që të mbajë një bazë të fortë kapitali të tillë që të mbajë besueshmërinë e investitorit, kreditorit dhe tregut dhe të mbështesë zhvillimin e ardhshëm të biznesit. Impakti i nivelit të kapitalit në kthimet për aksion njihet gjithashtu dhe Banka njeh nevojën për të mbajtur një balancë ndërmjet kthimeve më të larta të mundshme nëpërmjet levave financiare dhe avantazheve të sigurisë që vijnë nga një pozicion më i qëndrueshëm dhe i favorshëm i kapitalit. Banka dhe operacionet e saj rregullative kanë qenë në përputhje me të gjitha kërkesat e kapitalit të vendosura nga jashtë gjatë të gjithë periudhës.

34. Angazhime dhe detyrime të mundshme

	31 dhjetor 2015		31 dhjetor 2014
	Lek	Monedhë e huaj	Totali
<i>Detyrime të mundshme</i>			
Garanci bankare të lëshuara	2,929,734	6,977,344	9,907,078
Letër kredi	-	2,763,180	2,763,180
Linja të papërdorura krediti	4,115,773	8,838,145	12,953,918
Totali	7,045,507	18,578,669	25,624,176

Pjesa më e madhe e garancive bankare dhe letër kredive të mësipërme janë për periudha kohore më pak se një vit dhe kanë si kolateral depozitat e bllokuara të klientëve.

Në 31 dhjetor 2015 Banka është përfshirë në çështje gjyqësore me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve të Shqipërisë në lidhje me vlerësimin e taksës për 2013. Detyrimi shtesë dhe gjobat për tu paguar nga Banka janë 673 milionë lekë. Këto detyrime shtesë janë kundërshtuar nga Banka në Gjykatën e Rethit. Bazuar në ligjin nr. 9920 "Mbi procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", Banka ka lëshuar një garanci bankare që mbulon detyrimet, por jo gjobat e vlerësimit të taksës, prej 530 milion lekë në favor të Autoritetit Tatimor. Drejtuesit e Bankës synojnë të mbrojnë pozicionin dhe interpretimin e Bankës që është kundërshtuar nga autoriteti tatimor. Bazuar në vlerësimin e vetë Bankës dhe këshillimit ligjor të brendshëm dhe të jashtëm, drejtuesit e Bankës janë të mendimit që nuk do të ketë humbje materiale në lidhje me pretendimet, dhe si rrjedhim nuk ka asnjë provigjion të kontabilizuar në pasqyrat financiare.

RAIFFEISEN BANK SH.A.

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare individuale për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015

*(shumat në LEK'000)***34. Angazhime dhe detyrime te mundshme (vazhdim)****Angazhimet për qiratë e zakonshme operative**

Banka ka hyrë në angazhime të pakthyeshme qiraje të zakonshme operative për Drejtorinë e Përgjithshme dhe degët. Angazhime të tilla më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 janë si më poshtë:

	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
Jo më vonë se 1 vit	360,779	376,926
Më vonë se 1 vit dhe jo më vonë se 5 vjet	915,602	550,239
Më vonë se 5 vjet	-	62,586
Totali	1,276,381	989,751

35. Vlera e drejtë e aktiveve dhe detyrimeve financiare

Matjet e vlerës së drejtë analizohen nga niveli në hierarkinë e vlerës së drejtë si më poshtë:

(i) niveli parë janë një matje me çmime të kuotuar (të parregulluara) në tregje aktive për aktive ose detyrime të njëjta, (ii) matjet e nivelit të dytë janë teknika të vlerësimit me të gjitha inputet materiale të vëzhgueshme për aktivin ose pasivin në mënyrë të drejtpërdrejtë (që është, si çmimet) ose indirekt (domethënë, rrjedhin nga çmimet), dhe (iii) të nivelit të tre matjet janë vlerësimet jo të bazuara në të dhëna të vëzhgueshme në treg (pra, jo të inpueteve vëzhgueshme). Drejtimi aplikon gjykimin në kategorizimin e instrumenteve financiare duke përdorur hierarkinë e vlerës së drejtë. Nëse matja e një vlere të drejtë përdor të dhëna të vëzhgueshme që kërkojnë rregullim të rëndësishëm, ajo matje është matje e Nivelit 3. Rëndësia e një inputi vlerësimi vlerësohet kundrejt matjen e vlerës së drejtë në tërësinë e tij. Matjet e përsëritura të vlerës së drejtë janë ata që standarde të kontabilitetit kërkojnë ose lejojnë në pasqyrën e pozicionit financiar në fund të çdo periudhe raportuese. Vlerat e drejta të analizuara nga niveli në hierarkinë e vlerës së drejtë dhe vlerat kontabël të aktiveve jo të matura me vlerën e drejtë janë si më poshtë:

	2015			Totali
	Vlera e drejtë Nivel 1	Vlera e drejtë Nivel 2	Vlera e drejtë Nivel 3	
Hua dhe paradhënie me bankat	-	30,064,621	29,370,047	59,434,668
Hua dhe paradhënie për klientët	-	-	100,912,406	100,912,406
Letrat me vlerë të tregëtueshme	-	20,998,043	-	20,998,043
Letrat me vlerë të tjera të destinuara për shitje përmes fitim/ humbjes	-	3,423,858	-	3,423,858
Investime të mbajtura në maturim	-	52,502,144	-	52,502,144
Detyrime nga bankat	-	4,811	2,228,118	2,232,929
Depozita nga klientët	-	-	246,989,620	246,989,620
Huaja e varur	-	9,107,088	-	9,107,088
Garanci dhe angazhime	-	1,639,967	23,984,208	25,624,175

RAIFFEISEN BANK SH.A.

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare individuale për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
(shumat në LEK '000)

35. Vlera e drejtë e aktiveve dhe detyrimeve financiare (vazhdim)

	Vlera e drejtë Nivel 1	2014		Totali
		Vlera e drejtë Nivel 2	Vlera e drejtë Nivel 3	
Hua dhe paradhënie me bankat	-	20,128,723	39,657,169	59,785,892
Hua dhe paradhënie për klientët	-	-	111,921,473	111,921,473
Letrat me vlerë të tregëtueshme	-	28,341,284	-	28,341,284
Letrat me vlerë të tjera të destinuara për shitje përmes fitim/ humbjes	-	6,841,526	-	6,841,526
Investime të mbajtura në maturim	-	59,559,996	-	59,559,996
Detyrime nga bankat	-	194,890	2,798,962	2,993,852
Depozita nga klientët	-	-	233,881,121	233,881,121
Huaja e varur	-	-	7,149,792	7,149,792
Garanci dhe angazhime	-	-	29,319,487	29,319,487

Paraja dhe ekuivalentët e saj

Paraja dhe ekuivalentët e saj përfshijnë depozita ndërmjet bankave dhe mjete të tjera në procesin e arkëtimit. Duke qënë se këto balanca kanë afat të shkurtër dhe janë me norma interesi të ndryshueshme, vlera e drejtë e tyre është pothuajse e barabartë me vlerën kontabël.

Investimet në letrat me vlerë

Investimet në letrat me vlerë përfshijnë bono thesari dhe obligacione të qeverive dhe korporatave. Vlera e drejtë e tyre llogaritet duke përdorur modelin e rrjedhjeve të skontuara të parave bazuar në normën e brendshme aktuale të kthimit e përshtatshme për maturitetin e mbetur.

Hua dhe paradhënie klientëve

Huatë dhe paradhëniet mbarten me vlerën e mbetur pakësuar nga provigjonet. Portofoli i huave të Bankës ka një vlerë të drejtë të barabartë me vlerën e tyre kontabël për shkak të afatit të shkurtër ose normave të interesit të afërta me normat e tregut. Pjesa më e madhe e portofolit të huave është subjekt i ricmimeve brenda një viti.

Detyrime nga/ ndaj bankave dhe institucioneve financiare

Vlera e drejtë e huave dhe paradhënieve ndaj bankave dhe institucioneve financiare është pothuajse e barabartë me vlerën e tyre të mbartur për shkak të afatit të shkurtër ose normave të interesit të përafërta me normat e tregut

Depozita nga klientët

Vlera e drejtë e depozitave me maturim të pa përcaktuar, të cilat përfshijnë depozitat që mbartin interes, është shuma e pagueshme me kërkesë.

Borxhi i varur

Vlera e drejtë e borxhit të varur ka një vlerë totale drejtë të barabartë me vlerën e tij kontabël për shkak të normës së interesit themelor të cilat përafrohen me normat e tregut.

Garancite dhe angazhimet

Vlera e drejtë e garancive dhe angazhimeve është e barabartë me vlerën e tyre bartëse për shkak të natyrës së tyre afatshkurtër ose të normës bazë e interesit e cila përafrohet me normat e tregut.

RAIFFEISEN BANK SH.A.

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare individuale për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
(shumat në LEK '000)

35. Vlera e drejtë e aktiveve dhe detyrimeve financiare (vazhdim)

Ndjeshmeria e matjes me vlerën e drejtë

Teknika e vlerësimit, inputet e përdorura në matjen e vlerës së drejtë për matje te nivelit 2 dhe ndjeshmërinë e lidhur me ndryshimet e arsyeshme të mundshme në këto inpute në 31 dhjetor 2015 janë si vijon:

<i>Në mijë Lek</i>	Vlera e drejtë	Vlerësimi teknik	Inputet e përdorura	Variance e imputeve (mesatarja e ponderuar)		Ndjeshmëria ndaj vlerës së drejtë	
				Ndryshimi i arsyeshëm	Ndjeshmëria ndaj vlerës së drejtë	Ndjeshmëria ndaj vlerës së drejtë	Ndjeshmëria
Aktive financiare të matura me vlerën e drejtë							
Letra me vlerë të tregtueshme							
		Flukse monetare të skontuara [FMS]	Kurba e interesave të bonove të thesarit	2.5% - 9.9%	(10)	10	
Bono thesari shqiptare	1,932		Kurba e interesave të obligacioneve qeveritare	2.5% - 9.9%	(327,485)	336,083	
Obligacione qeveritare shqiptare	20,996,111	FMS					
Letra të tjera me vlerë të matura nëpërmjet fitimit ose humbjes							
Obligacione qeveritare shqiptare	3,423,858	FMS	Kurba e interesave të obligacioneve qeveritare	2.5%-9.9%	(120,251)	126,482	

RAIFFEISEN BANK SH.A.

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare individuale për vitin e mbylltur më 31 dhjetor 2015
(shumat në LEK '000)

35. Vlera e drejtë e aktiveve dhe detyrimeve financiare (vazhdim)

Teknika e vlerësimit, inputet e përdorura në matjen e vlerës së drejtë për matje te nivelit 2 dhe ndjeshmërinë e lidhur me ndryshimet e arsyeshme të mundshme në këto inpute në 31 dhjetor 2014 janë si vijoni:

Në mijë Lek	Vlera e drejtë	Vlerësimi teknik	Inputet e përdorura	Varianca e inputeve		Ndjeshmëria ndaj vlerës së drejtë
				(mesatarja e ponderuar)	Ndryshimi i arsyeshëm	
Aktive financiare të matura me vlerën e drejtë						
Letra me vlerë të tregtueshme						
Bono thesari shqiptare	1,332	Flukse monetare të skontuara [FMS]	Kurba e interesave të bonove të thesarit	2.5% - 9.9%	+ 1 %/-1%	(5)
Obligacione qeveritare shqiptare	28,339,952	FMS	Kurba e interesave të obligacioneve qeveritare	2.5% - 9.9%	+ 1 %/-1%	(586,162)
Letra të tjera me vlerë të matura nëpërmjet fitimit ose humbjes						
Obligacione qeveritare shqiptare	6,841,526	FMS	Kurba e interesave të obligacioneve qeveritare	2.5% - 9.9%	+ 1 %/-1%	(294,460)
						608,996

Tabelat e mësipërme zbulojnë ndjeshmërinë ndaj inputeve vlerësimit për aktive financiare, nëse ndryshimi i një ose më shumë nga inputet jo të vëzhgueshme për të reflektuar në mënyrë të arsyeshme supozime alternative të mundshme, do të ndryshojnë në mënyrë të konsiderueshme vlerën e drejtë. Për këtë qëllim, rëndësia është gjykuar në lidhje me fitimin ose humbjen, dhe totalit të aktiveve.

RAIFFEISEN BANK SH.A.

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare individuale për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
(shumat në LEK '000)

36. Paraqitja e instrumentave financiarë sipas kategorisë së matjes

Për qëllime matjeje, SNK 39 "Instrumentat financiarë: Njohja dhe Matja", i klasifikon aktivet financiare në kategoritë e mëposhtme: (a) hua dhe paradhënie; (b) aktive financiare të mbajtura për shitje; (c) aktive financiare të mbajtura në maturim dhe (d) aktive financiare me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarive të fitim humbjes ("FVTPL"). Aktivet financiare me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarive të fitim humbjes ndahen në dy kategori: (i) aktive të destinuara si të tilla që në njohje dhe (ii) ato të klasifikuara të mbajtura për tregtim. Qeraja financiare është një kategori më vete. Tabela e mëposhtme paraqet aktivet financiare sipas këtyre kategorive të matjes në 31 dhjetor 2015:

	Hua dhe paradhnie	Investime te mbajtura per shitje	Investime te mbajtura per tregtim	Investime te mbajtura ne maturim	Totali
Aktivët					
Paraja dhe ekuivalentët e saj	78,049,658	-	-	-	78,049,658
Shuma të kushtëzuara	28,632,318	-	-	-	28,632,318
Investime të mbajtura për tregtim	-	-	20,998,043	-	20,998,043
Investime të mbajtura për shitje	-	3,423,858	-	-	3,423,858
Investime të mbajtura deri në maturim	-	-	-	51,935,006	51,935,006
Hua dhe paradhënie për klientët, neto	100,912,406	-	-	-	100,912,406
Total Aktive financiare	207,594,382	3,423,858	20,998,043	51,935,006	283,951,289

RAIFFEISEN BANK SH.A.

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare individuale për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
(shumat në LEK '000)

36. Paraqitja e instrumentave financiarë sipas kategorisë së matjes (vazhdim)

Tabela e mëposhtme paraqet aktivet financiare sipas këtyre kategorive të matjes në 31 dhjetor 2014:

	Hua dhe paradhënie	Investime te mbajtura per shitje	Investime te mbajtura per tregtim	Investime te mbajtura ne maturim	Totali
Aktivët					
Paraja dhe ekuivalentët e saj	40,632,219	-	-	-	40,632,219
Shuma të kushtëzuara	22,850,572	-	-	-	22,850,572
Investime të mbajtura për tregtim	-	-	28,341,284	-	28,341,284
Investime të mbajtura për shitje	-	6,841,526	-	-	6,841,526
Investime të mbajtura deri në maturim	-	-	-	59,534,013	59,534,013
Hua dhe paradhënie për klientët, neto	111,921,473	-	-	-	111,921,473
Total Aktive financiare	175,404,264	6,841,526	28,341,284	59,534,013	270,121,087

Në 31 dhjetor 2015 and 31 dhjetor 2014, të gjitha detyrimet financiare të Bankës përveç derivativeve mbahen me vlerë të mbetur.

37. Transaksione me palët e lidhura

Palët konsiderohen në përgjithësi të jenë të lidhura në qoftë se palët janë nën kontroll të përbashkët, ose njëra palë ka aftësinë për të kontrolluar palën tjetër ose mund të ushtrojë ndikim të rëndësishëm mbi palën tjetër në marrjen e vendimeve financiare ose operacionale. Kur konsiderohet çdo marrëdhënie ndërmjet palëve, vëmendje i kushtohet përmbajtjes së marrëdhënies dhe jo thjesht formës ligjore. Transaksionet me palët e lidhura përbëhen nga transaksione me Raiffeisen International AG, Raiffeisen Zentralbank Österreich Aktiengesellschaft (RZB AG), me filialet e Bankës, me drejtorët dhe me zyrtarët ekzekutivë. Vlera agregate e transaksioneve të kryera dhe gjendjet pezull me palët e lidhura janë si më poshtë:

	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
Kërkesa nga		
Kompani të lidhura	23,306,331	11,790,226
Personeli kryesor drejtues	214,363	108,518
Totali i aktiveve	23,520,694	11,898,744
Detyrimet ndaj		
Kompani të lidhura	9,183,452	7,479,346
Personeli kryesor drejtues	122,513	74,535
Totali i detyrimeve	9,305,965	7,553,881

RAIFFEISEN BANK SH.A.

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare individuale për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
(shumat në LEK '000)

37. Transaksione me palët e lidhura (vazhdim)

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2015	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2014
Të ardhurat nga interesi, neto		
Kompani të lidhura	(390,947)	(301,137)
Shpenzime komisioni, neto		
Kompani të lidhura	(193,271)	(179,315)
Shpenzime administrative		
Kompani të lidhura	(449,206)	(501,745)
Pagat, rroga dhe shpërblimet		
Personeli kryesor drejtues	(270,477)	(211,227)
Totali	(1,303,901)	(1,193,424)

Vlera agregate e detyrimeve të mundshme të Bankës ndaj kompanive të lidhura është 2,830,810 mijë Lek më 31 dhjetor 2015 (31 dhjetor 2014: 4,481,888 mijë Lek) dhe përfaqëson garanci bankare, letra të kredisë dhe angazhime të lëshuara.

38. Ngjarje pas datës së raportimit

Pas ngjarjeve të ndodhura pas datës së raportimit në lidhje me dy klientë në segmentin e korporatave, të lidhura me përkeqësimin e situatës financiare të këtyre klientëve, Drejtimi i Bankës është në procesin e vlerësimit të ndikimit të këtyre ngjarjeve në pozicionin financiar dhe në performancën financiare të Bankës. Drejtimi gjykon se këto ngjarje nuk ndikojnë pozicionin financiar apo performancën financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015, por do të reflektohen në periudhat e ardhshme financiare.

Nuk ka ngjarje të tjera të rëndësishme pas datës së raportimit, të cilat kërkojnë rregullim apo paraqitje në pasqyrat individuale financiare.

RAIFFEISEN BANK SH.A.

**Raporti i Audituesit të pavarur dhe
Pasqyrat financiare të konsoliduara
më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015**

PËRMBAJTJA

	FAQE
RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR	
PASQYRAT FINANCIARE TË KONSOLIDUARA	
BILANCI I KONSOLIDUAR	2 - 3
PASQYRA E KONSOLIDUAR E TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE	4 - 5
PASQYRA E KONSOLIDUAR E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	6
PASQYRA E KONSOLIDUAR E FLUKSEVE TË PARASË	7
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE TË KONSOLIDUARA	8 – 38

INFORMACION I PËRGJITHSHËM

Drejtuesit dhe Administratorët më 31 dhjetor 2015 dhe 2014

Këshilli Drejtues (Këshilli Mbikëqyrës)

Helmut Breit	Kryetar
Heinz Hodl	Anëtar
Razvan Munteanu	Anëtar
Harald Kreuzmair	Anëtar
Andreas Engels	Anëtar

Komiteti i Kontrollit

Heinz Hödl	Kryetar
Johannes Kellner	Anëtar
Susana Benoit	Anëtar

Bordi Drejtues

Christian Canacaris	Drejtor Ekzekutiv
Alexander Zsolnai	Nën kryetar i Bordit të Drejtimit
John McNaughton	Anëtar
Elona Mullahi	Anëtar

Selia e regjistruar

Rruga e Kavajës, Ndërtesa 71, Apt. 4
Tiranë, Shqipëri
Telefon: +355 4 2381 381
Fax: +355 4 2275 599

Auditues

Deloitte Audit Albania sh.p.k.
Rruga Elbasanit, Pallati poshtë Fakultetit Gjeologji - Miniera, Tiranë, Shqipëri
Telefon: +355 (4) 451 7920/ 451 7954
Fax: +355 (4) 451 7990

RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR

Për Aksionarin dhe Drejtimin e Raiffeisen Bank Sh.a.:

Raport mbi pasqyrat financiare të konsoliduara

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të konsoliduara të Raiffeisen Bank Sh.a., të cilat përmbajnë bilancin e konsoliduar kontabël më datë 31 dhjetor 2015, pasqyrën e konsoliduar të të ardhurave dhe shpenzimeve, pasqyrën e konsoliduar të ndryshimeve të kapitalit, pasqyrën e konsoliduar të flukseve të parasë për vitin e mbyllur më këtë datë, si dhe një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabël dhe shënimeve të tjera shpjeguese.

Përgjegjësia e Drejtimit për pasqyrat financiare të konsoliduara

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të këtyre pasqyrave financiare të konsoliduara në përputhje me Nenin 47 të Ligjit Për Bankat në Republikën e Shqipërisë (Ligji Nr. 9662 datë 18 dhjetor 2006) dhe për kontrollin e brendshëm i cili, në masën që përcaktohet nga Drejtimi, është i nevojshëm për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare të konsoliduara pa pasaktësi materiale, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve.

Përgjegjësia e Audituesit

Përgjegjësia jonë është të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare të konsoliduara bazuar në auditimin tonë. Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne të përmbushim kërkesat e etikës dhe të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin, me qëllim që të përfitojmë siguri të arsyeshme që pasqyrat financiare të konsoliduara nuk kanë pasaktësi materiale.

Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për sigurimin e të dhënave të auditimit për vlerat dhe deklaratimet në pasqyrat financiare të konsoliduara. Procedurat e përzgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, përfshirë këtu edhe vlerësimin e rrezikut të ekzistencës së pasaktësive materiale në pasqyrat financiare të konsoliduara, qoftë si rezultat i mashtrimeve apo i gabimeve. Gjatë vlerësimit të rrezikut, audituesi merr në konsideratë kontrollin e brendshëm në lidhje me përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare të konsoliduara në mënyrë që të projektojë procedurat e auditimit të cilat janë të përshtatshme në rrethana të caktuara, por jo për qëllimin e shprehjes së një opinionimi mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Bankës. Një auditim përfshin gjithashtu vlerësimin për përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kryesore të bëra nga Drejtimi, si dhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare të konsoliduara.

Ne besojmë se të dhënat e auditimit që ne kemi siguruar, janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të bazuar opinionin tonë të auditimit.

Opinionimi

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare të konsoliduara paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin e konsoliduar financiar të Raiffeisen Bank Sh.a. më 31 dhjetor 2015, performancën e konsoliduar financiare dhe flukset e konsoliduara të parasë për vitin e mbyllur më këtë datë, në përputhje me Nenin 47 të Ligjit Për Bankat në Republikën e Shqipërisë (Ligji Nr. 9662 datë 18 dhjetor 2006).

Çështje të tjera

Pasqyrat financiare të konsoliduara të Raiffeisen Bank Sh.a. për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014 janë audituar nga një auditues tjetër, i cili ka shprehur një opinion të pa modifikuar mbi ato pasqyra më 17 prill 2015.

Deloitte Audit Albania sh.p.k.
24 qershor 2016
Tiranë, Shqipëri

Elvis Ziu
Elvis Ziu
Partner Angazhim

DELOITTE AUDIT ALBANIA
Ad.Rr. Elbasanit, Pk. nr.1, Nr.2, poshte Fakulteti Gjeologji Miniera
Tel: 0445 17920
NIPT: L 41709002 H TIRANA - ALBANIA

RAIFFEISEN BANK SH.A.**Bilanci i konsoliduar më 31 dhjetor 2015***(të gjitha shumat janë në mijë Lek)*

AKTIVET	Shënime	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
Arka dhe Banka Qëndrore	4	59,767,725	32,843,991
Arka		3,172,435	3,323,499
Banka Qëndrore		56,595,290	29,520,492
Bono thesari dhe bono të tjera të pranueshme për refinancim me Bankën Qëndrore	5	17,688,624	17,601,735
Hua dhe paradhënie neto për institucionet e kreditit	6	47,227,160	31,359,003
Llogari rrjedhëse		1,791,213	922,352
Depozita		43,273,216	29,019,311
Hua		306,273	713,764
Të tjera		1,856,458	703,576
Hua dhe paradhënie neto për klientët	7, 8	95,953,881	104,610,881
Hua dhe paradhënie standarde		82,947,999	82,280,961
Hua të pakthyera në afat		1,022,523	587,954
Hua në ndjekje		7,885,719	10,019,576
Hua nënstandard		3,082,513	8,483,283
Hua të dyshimta		608,610	2,773,657
Hua të humbura		406,517	465,450
Letrat me vlerë	9	58,581,966	77,332,551
Letra me vlerë me të ardhura të pandryshueshme		58,581,966	77,332,551
Letra me vlerë me të ardhura të ndryshueshme		-	-
Mjetet e qëndrueshme, neto	10	4,901,207	4,959,591
Mjete të patrupëzuara		1,694,416	1,611,695
Mjete të qëndrueshme në funksion të veprimtarisë		3,111,452	3,333,901
Mjete të qëndrueshme të investimit		89,736	11,816
Mjete të qëndrueshme në proçes		5,603	2,179
Mjete të tjera, neto	11	3,233,236	2,535,000
TOTALI I AKTIVEVE		287,353,799	271,242,752

Shënimet shoqëruese në faqet 8 deri në 38 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare të konsoliduara.

RAIFFEISEN BANK SH.A.

Pasqyra e konsoliduar e të ardhurave dhe shpenzimeve për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
(të gjitha shumat janë në mijë Lek)

DETYRIMET DHE KAPITALI AKSIONAR	Shënime	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
Detyrimet ndaj institucioneve të kreditit përveç Bankës Qëndrore	12	4,945,344	7,004,959
Llogari rrjedhëse		1,875,596	3,453,126
Depozita		3,069,748	2,990,518
Huamarrje		-	561,315
Detyrimet ndaj klientëve	13	242,674,678	228,438,606
Llogari rrjedhëse		118,825,043	81,974,007
Llogari depozite		119,171,919	143,595,804
Të tjera		4,677,716	2,868,795
Borxhi ndaj Qeverisë shqiptare dhe organizatave publike		342,133	621,971
Ndihma dhe financim publik		-	-
Mjete të mbajtura në emër të të tretëve	14	1,056,925	1,209,733
Administrimi fiskal		249,184	637,185
Të tjera		807,741	572,548
Fonde rezervë për rreziqe dhe shpenzime Borxh i varur	15	2,353,963	1,425,242
		9,107,088	7,149,792
Detyrime të tjera	16	1,728,409	2,466,430
Detyrime gjithsej		262,208,540	248,316,733
Kapitali aksionar			
Kapitali aksionar	18	14,178,593	14,178,593
Rezerva e përgjithshme	19	4,800,903	4,571,327
Diferenca rivlerësimi		(208,943)	(48,300)
Fitimet e pashpërndara		2,172,676	429,335
Fitimi i vitit ushtrimor		4,100,413	3,700,230
Kapitali aksionar gjithsej		25,043,642	22,831,185
Interesi aksionarëve pa kontroll	21	101,617	94,834
TOTALI I DETYRIMEVE DHE KAPITALIT AKSIONAR		287,353,799	271,242,752

Pasqyrat financiare të konsoliduara të Bankës janë miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës.



Christian Canacaris
Drejtore i Përgjithshëm



Alexander Zsolnai
Zv. Drejtore i Bordit Drejtues

Shënimet shoqëruese në faqet 8 deri në 38 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare të konsoliduara.

RAIFFEISEN BANK SH.A.

Pasqyra e konsoliduar e të ardhurave dhe shpenzimeve për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
(të gjitha shumat janë në mijë Lek)

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014
Të ardhura nga interesat	6,912,623	8,032,526
Për veprimet me thesarin dhe ndërbankare	179,762	310,688
Për veprimet me klientët	6,703,699	7,671,566
Të tjera	29,162	50,272
Shpenzime për interesat	(1,200,502)	(2,416,002)
Për veprimet me thesarin dhe ndërbankare	(78,287)	(137,664)
Për veprimet me klientët	(637,589)	(1,813,713)
Për borxhet e varura	-	(20,954)
Interesa për letrat me vlerë të shitura sipas marrëveshjes së riblerjes	(484,626)	(443,671)
Të ardhura neto nga interesat	5,712,121	5,616,524
Të ardhura nga operacionet financiare	5,811,677	7,104,480
Të ardhura nga bonot e thesarit	815,619	720,371
Të ardhura nga veprimet me letrat me vlerë	4,695,925	6,213,463
Të tjera	300,133	170,646
Humbje nga operacionet financiare	(230,944)	(139,268)
Humbje nga bonot e thesarit	(7,293)	(2,184)
Humbje nga transaksionet me letrat e tjera me vlerë	(223,651)	(137,084)
Fitimi neto nga veprimet financiare	5,580,733	6,965,212
Të ardhura neto nga operacionet e qirasë	32,398	2,922
Të ardhura nga operacionet e qirasë	37,126	2,922
Shpenzime për operacionet e qirasë	(4,728)	-
Fitimi neto nga komisionet	1,556,555	2,456,673
Të ardhura nga komisionet për veprimtarinë huadhënëse	438,892	1,377,019
Të ardhura nga komisionet për shërbimet bankare	1,571,428	1,455,311
Shpenzime për komisione për veprimtarinë huamarrëse	(143,172)	(114,213)
Shpenzime për komisione për shërbimet bankare	(310,593)	(261,444)
Humbja neto nga veprimtaritë e tjera bankare	760,727	393,492
Të ardhura nga veprimtaritë e tjera bankare	971,446	692,201
Shpenzime nga veprimtaritë e tjera bankare	(210,719)	(298,709)
Fitimi neto nga veprimtaria valutore	488,507	747,878
Fitimi nga veprimtaria valutore	661,644	750,321
Humbja nga veprimtaria valutore	(173,137)	(2,443)
Të ardhura neto nga veprimtaria bankare	14,131,041	16,182,701

RAIFFEISEN BANK SH.A.**Pasqyra e konsoliduar e të ardhurave dhe shpenzimeve për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015***(të gjitha shumat janë në mijë Lek)*

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014
Shpenzime të përgjithshme të veprimtarisë		(5,844,754)	(5,457,127)
Shpenzime për personelin	22	(2,498,988)	(2,423,966)
Taksa përveç taksave mbi të ardhurat		(139,842)	(106,659)
Shpenzime për shërbime të jashtme	23	(3,205,924)	(2,926,502)
Të ardhurat e veprimtarisë përpara shpenzimeve për fonde rezervë		8,286,287	10,725,574
Shpenzime neto për amortizimin dhe zhvlerësimin e mjeteve të qëndrueshme		(730,098)	(719,213)
Humbjet neto dhe shpenzimet për fondin rezervë për llogaritë e dyshimta, letrat me vlerë dhe zërat jashtë bilancit		(3,619,261)	(6,278,660)
Rimarrje/(shpenzime) neto për fondet e rezervës statistikore		(174,096)	36,482
Shpenzime neto/ transferime për fondet e rezervës për huatë nënstandard, të dyshimta dhe të humbura		2,402,404	(3,036,615)
Shpenzime/transferime neto për fonde rezervë për letrat me vlerë të ndryshme nga bonot e thesarit		27	-
Transferime/Shpenzime neto për fonde të tjera rezervë		(969,455)	(124,336)
Humbje nga llogaritë për t'u arkëtuar të pambledhshme		(4,878,141)	(3,154,191)
Fitimi neto nga veprimtaritë e jashtëzakonshme		615,437	861,304
Të ardhura të jashtëzakonshme		632,813	995,382
Shpenzime të jashtëzakonshme		(17,376)	(134,078)
Fitimi para tatimit		4,552,365	4,589,005
Tatimi mbi fitimin	24	(430,464)	(882,917)
Fitimi i vitit ushtrimor		4,121,901	3,706,088
I përket:			
Aksionarëve të Bankës		4,100,413	3,700,230
Interesi i aksionarëve pa kontroll		21,488	5,858

Shënimet shoqëruese në faqet 8 deri në 38 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare të konsoliduara.

RAIFFEISEN BANK SH.A.**Pasqyra e konsoliduar e ndryshimeve në kapital për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015***(të gjitha shumat janë në mijë Lek)*

	Kapitali aksionar	Rezerva e përgjithshme	Rezerva Rivlerësimi	Diferenca e rivlerësimit	Fitimi i pashpërndarë	Totali	Interesi i aksionarëve pa kontroll	Totali
Gjendja më 31 dhjetor 2013	14,178,593	2,835,352	2,379,529	(46,500)	5,811,747	25,158,721	104,864	25,263,586
Rivlerësim ndërtesa	-	-	(643,554)		85,865	(557,689)		(557,689)
Diferencë rivlerësimi i kapitalit	-	-	-	(1,800)	-	(1,800)	-	(1,800)
Pagesa e dividendit	-	-	-	-	(5,468,277)	(5,468,277)	(15,888)	(5,484,165)
Fitimi neto për vitin	-	-	-	-	3,700,230	3,700,230	5,858	3,706,088
Gjendja më 31 dhjetor 2014	14,178,593	2,835,352	1,735,975	(48,300)	4,129,565	22,831,185	94,834	22,926,019
Rivlerësim ndërtesa	-	-	(70,424)		68,243	(2,181)		(2,181)
Rritje rezerve	-	300,000	-	-	(300,000)	-	-	-
Diferencë rivlerësimi i kapitalit	-	-	-	(160,643)		(160,643)	-	(160,643)
Pagesa e dividendit	-	-	-	-	(1,725,132)	(1,725,132)	(14,705)	(1,739,837)
Fitimi neto për vitin	-	-	-	-	4,100,413	4,100,413	21,488	4,121,901
Gjendja më 31 dhjetor 2015	14,178,593	3,135,352	1,665,551	(208,943)	6,273,089	25,043,642	101,617	25,145,259

Shënimet shoqëruese në faqet 8 deri në 38 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare të konsoliduara.

RAIFFEISEN BANK SH.A.**Pasqyra e konsoliduar e flukseve të parasë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015***(të gjitha shumat janë në mijë Lek)*

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014
FLUKSET E PARASË NGA AKTIVITETI OPERACIONAL		
Fitimi neto për periudhën para tatimit	4,552,364	4,589,004
Rregullime për zëra jo-monetarë		
Zhvlërësimi dhe amortizimi	730,098	719,213
Aktivitet e qëndrueshme të nxjerra jashtë përdorimi	3,317	155,799
Provizjone për humbjet në hua	(1,429,931)	3,073,647
Rritja në interesat e arkëtueshme	(404,079)	166,661
Pakësimi në interesat e pagueshme	(215,572)	(1,977,117)
Diferenca e rivlerësimit	(160,643)	(1,800)
Flukset e parave nga aktiviteti operacional përpara ndryshimeve në kapitalin qarkullues	3,075,554	6,725,407
Ndryshime të kapitalit qarkullues		
Pakesim në hua dhe paradhënie për bankat	(12,707,824)	6,640,943
Pakesim në hua dhe paradhënie për klientët	10,833,158	1,795,897
Pakësim / (Rritje) në letra me vlerë të tregtueshme dhe të vendosjes	11,328,673	15,709,794
Rritje në aktive të tjera	(148,162)	(168,839)
Rritje/(pakësim) në detyrimet ndaj institucioneve financiare	(5,170,102)	(3,734,609)
Pakësim në detyrimet ndaj klientëve	14,400,678	(12,242,165)
Rritje/(pakësim) në detyrimet ndaj palëve të treta	(170,304)	668,401
Rritje në borxhin e varur	1,916,200	-
(Pakësim) / Rritje në detyrimet e tjera	(1,015,058)	(1,082,998)
Flukset e parasë nga aktiviteti operacional pas ndryshimeve në kapitalin qarkullues	22,342,813	14,311,831
Tatimi i paguar mbi fitimin	(750,408)	(817,581)
Paraja neto e (përdorur)/gjeneruar nga aktiviteti operacional	21,592,405	13,494,250
FLUKSET E PARASË NGA AKTIVITETI INVESTUES		
Blerje e pronave dhe pajisjeve	(687,556)	(909,585)
Blerje e aktiveve të patrupëzuara	(5,974)	(277,277)
Shitje e mjeteve të qëndrueshme	16,318	536,338
Maturimi i letrave me vlerë të mbajtura deri në maturim	7,748,378	(991,492)
Paraja neto gjeneruar/(përdorur) nga aktiviteti investues	7,071,166	(1,642,016)
FLUKSET E PARASË NGA AKTIVITETI FINANCUES		
Dividend i paguar nga fitimi i vitit të shkuar	(1,739,837)	(5,484,165)
Paraja neto e përdorur në aktivitetin financues	(1,739,837)	(5,484,165)
	26,923,734	
Rritja neto në para dhe ekuivalentë të saj gjatë vitit		6,368,069
Arka dhe llogaritë me Bankën Qëndrore në fillim të vitit	32,843,991	26,475,922
Arka dhe llogaritë me Bankën Qëndrore në fund të vitit	59,767,725	32,843,991

Shënimet shoqëruese në faqet 8 deri në 38 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare të konsoliduara.

RAIFFEISEN BANK SH.A.

Shënime për pasqyrat financiare të konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015

(të gjitha shumat janë në mijë Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)

1. TË PËRGJITHSHME

Raiffeisen Bank Sh.a., më poshtë referuar (“Banka”) është një institucion bankar i cili vepron në përputhje me Ligjin 9901, datë 14 Prill 2008 “Për tregtarët dhe Shoqërite tregtare” dhe Ligjin 9662, datë 18 Dhjetor 2006 “Mbi Bankat në Republikën e Shqipërisë”, si dhe me ligjet e tjera të rëndësishme. Banka është themeluar dhe vendosur në Shqipëri dhe zhvillon aktivitetin e saj operativ në Shqipëri. Raiffeisen Bank Sh.a. është bijë 100% e zotëruar nga Raiffeisen SEE Region Holding GmbH, Austri, e cila është pala kontrolluese finale.

Aktiviteti kryesor. Aktiviteti kryesor i biznesit të Grupit janë operacionet bankare me pakicë brënda Republikës së Shqipërisë. Banka vepron nëpërmjet një rrjeti prej 89 vendodhjesh shërbimi më 31 dhjetor 2015, (31 dhjetor 2014: 90 vendodhje shërbimi) në të gjithë Shqipërinë, të cilat administrohen në 8 rrethe dhe nuk ka operacione jashtë shtetit.

Pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 janë autorizuar për tu publikuar nga Bordi Drejtues më xx xxxxx 2016. Aproxim i pasqyrave financiare nga Aksionarët do të kryhet në Mbledhjen Vjetore të Përgjithshme të Aksionarëve.

2. BAZAT E PËRGATITJES

Pasqyrat financiare të konsoliduara të Bankës janë përgatitur në përputhje me “Metodologjinë e raportimit dhe përmbajtjen e raporteve financiare” (“Metodologjia e Raportimit Financiar” ose “MRF”) e miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë më 24 dhjetor 2008. MRF u miratua për qëllime rregullatore, në zbatim të Nenit 47 të Ligjit nr. 9662, datë 18 dhjetor 2006 “Për Bankat në Republikën e Shqipërisë”.

Pasqyrat financiare të konsoliduara janë prezantuar në Lekë Shqiptar (“Lek”), të përafuar në mijë Lek dhe janë të përgatitura mbi bazën e kostos historike, përveç letrave me vlerë të disponueshme për shitje dhe letrave me vlerë të tregtueshme që vlerësohen mbi bazën e vlerës së tregut si edhe ndërtesave që mbahen me vlerë të drejtë, të rivlerësuar.

3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KONTABËL MË TË RËNDËSISHME

3.1 Baza e konsolidimit

Konsolidimi i rezultatit financiar të Bankës me atë të Filialeve, në të cilin ka më shumë se 50 për qind të aksioneve dhe mbi biznesin dhe politikat financiare të së cilës ushtron kontroll, bëhet duke ndjekur metodën e konsolidimit të plotë.

Të gjitha llogaritë e aktiveve, detyrimeve dhe pasqyrës së të ardhurave konsolidohen plotësisht me llogaritë e të njëjtës natyrë të Bankës. Transaksionet midis Bankës dhe Filialeve eliminohen gjatë konsolidimit të pasqyrave. Pjesa e interesit të aksionarëve pa kontroll në kapitalin aksionar dhe në të ardhurat neto paraqitet si një detyrim.

Sipas natyrës së aktivitetit, filialet e Grupit kanë disa politika kontabël specifike të cilat detajohen në shënimin 3.6 për Raiffeisen Leasing sh.a. dhe 3.8 dhe 3.9 për Raiffeisen INVEST - Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive sh.a.

3.2 Transaksionet me monedhat e huaja

(i) Monedha funksionale dhe prezantuese

Pasqyrat financiare të konsoliduara janë prezantuar në Lek, e cila është edhe monedha funksionale dhe prezantuese e Grupit.

3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KONTABËL MË TË RËNDËSISHME (VAZHDIM)**3.2 Transaksionet me monedhat e huaja (vazhdim)****(ii) Transaksionet dhe gjendjet**

Transaksionet e kryera në monedha të tjera (jo Lek) janë regjistruar fillimisht me kurset e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit. Aktivet dhe detyrimet monetare në këto monedha janë rikonvertuar me kurset e këmbimit të datës së bilancit. Fitimet dhe humbjet që rezultojnë nga këmbimi janë paraqitur në pasqyrën e konsoliduar të të ardhurave dhe shpenzimeve. Aktivet dhe detyrimet jomonetare në këto monedha janë konvertuar me kurset e këmbimit të datës së transaksionit. Kurset e këmbimit që janë aplikuar më 31 dhjetor 2015 dhe 2014 (nga Lek në monedhë të huaj) për monedhat e huaja kryesore janë paraqitur më poshtë:

	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
Monedha Europiane (EUR)	137.28	140.14
Dollari Amerikan (USD)	125.79	115.23
Paundi Britanik (GBP)	186.59	179.48
Dollari Kanadez (CAD)	90.53	99.55
Franga Zvicerane (CHF)	126.74	116.52
Jeni Japonez (JPY) (për 100)	104.50	96.49

3.3 Arka dhe llogaritë me Bankën Qëndrore

Për të raportuar rrjedhjet e parave, paraja dhe ekuivalentët në para janë përcaktuar si arka dhe llogaritë me Bankën Qendrore, duke përfshirë rezervën minimale të detyrueshme me Bankën e Shqipërisë (“Banka Qëndrore”).

Rezerva minimale e detyrueshme me Bankën e Shqipërisë është një rezervë që duhet ta mbajnë të gjitha bankat tregtare të licensuara në Shqipëri.

3.4 Investime në letrat me vlerë

Investime në letrat me vlerë përfshijnë bono thesari, obligacione të Qeverisë dhe obligacione të huaja. Këto investime maten fillimisht me kosto, duke përfshirë kostot e transaksionit dhe klasifikohen si më poshtë:

- Letra me vlerë të mbajtura deri në maturim
- Letra me vlerë të disponueshme për shitje, dhe
- Letra me vlerë të tregtueshme

(i) Letra me vlerë të mbajtura deri në maturim

Të gjithë instrumentet financiare fillimisht regjistrohen në kosto, e cila përbëhet nga vlera e drejtë e pagesës së dhënë duke përfshirë kostot e blerjes së instrumenteve financiare. Të gjithë fitimet apo humbjet e realizuara apo të përlllogaritura janë përfshirë në të ardhurat neto.

Letrat me vlerë, të cilat kanë pagesa fikse apo të përcaktueshme synohen të mbahen deri në maturim. Ato përfaqësojnë bonot e thesarit dhe bonot qeveritare të emetuara nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë. Pas regjistrimit fillestar, letrat me vlerë të mbajtura për maturim, mbahen me kosto të amortizuar, minus provizionet për zhvlerësime në vlerë. Amortizimi vjetor i zbritjeve apo i primeve për blerjen e letrave me vlerë të mbajtura për maturim i bashkohet të ardhurave të tjera nga investimi gjatë gjithë afatit të instrumentit në mënyrë që të ardhurat e njohura në çdo periudhë të përfaqësojnë të ardhura konstante nga letrat me vlerë.

3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KONTABËL MË TË RËNDËSISHME (VAZHDIM)

3.4 Investime në letrat me vlerë (vazhdim)

(ii) Letra me vlerë të disponueshme për shitje

Letrat me vlerë të disponueshme për shitje përfshijnë bono thesari dhe obligacione të huaja. Pas vlerësimit fillestar, letrat me vlerë, të cilat klasifikohen si të disponueshme për shitje, rivlerësohen me vlerën e tregut. Fitimet dhe humbjet si rrjedhojë e ndryshimeve në vlerën e tregut të këtyre letrave me vlerë të disponueshme për shitje përfshihen në fitimin ose humbjen neto për periudhën në të cilën ndodhin këto ndryshime.

(iii) Letra me vlerë të tregtueshme

Letrat me vlerë të tregtueshme përfshijnë bono thesari. Letrat me vlerë të tregtueshme regjistrohen në ditën e blerjes me çmimin e blerjes, duke përfshirë kostot dhe interesin e përllogaritur. Pas vlerësimit të parë, letrat me vlerë të tregtueshme rivlerësohen me vlerën e tregut. Fitimet dhe humbjet si rrjedhojë e ndryshimeve në vlerën e tregut të këtyre letrave me vlerë përfshihen në fitimin ose humbjen neto të periudhës në të cilën ndodhin këto ndryshime.

(iv) Vlera e drejte

Përcaktimi i vlerës së drejtë të aktiveve dhe detyrimeve financiare mbështetet mbi çmimet e kuotuarat të tregut, ose çmimet e agjentëve të shitjes për instrumenta financiarë të tregtueshme në tregje aktive. Për të gjitha instrumentat e tjerë financiarë vlera e drejtë përcaktohet mbi bazën e teknikave të vlerësimit. Metodot e vlerësimit përfshijnë teknikën e vlerës aktuale neto, metodën e rrjedhjeve monetare të skontuara, dhe krahasimin me instrumenta të tjerë të ngjashëm për të cilët ekzistojnë çmime tregu dhe metoda vlerësimi. Grupi përdor gjerësisht metodat e vlerësimit për të përcaktuar vlerën e drejtë të instrumentave financiarë të zakonshëm e të thjeshtë si opsionet dhe sëap-et e normave të interesit dhe të monedhës. Për të tilla instrumenta, të dhënat për t'u përdorur në modelet e vlerësimit janë lehtësisht të vëzhgueshme në treg. Përcaktimi i vlerës së drejtë detajohet Shënimin 29 "Vlera e drejtë e aktiveve dhe detyrimeve financiare".

(v) Marrëveshjet e riblerjes dhe marrëveshjet e anasjellta të riblerjes

Letrat me vlerë të blera sipas marrëveshjeve për t'u rishitur (marrëveshje riblerjeje të anasjellta) dhe letrat me vlerë të shitura sipas marrëveshjeve për t'u riblerë (marrëveshje riblerjeje) në përgjithësi trajtohen si veprime financiare të kolateralizuara dhe mbahen me shumat e dhëna ose të marra, plus interesin e përllogaritur. Interesi nga marrëveshjet e anasjellta të riblerjes dhe për marrëveshjet e riblerjes shprehet si e ardhur ose shpenzim interesi gjatë kohëzgjatjes së çdo marrëveshjeje. Të gjitha marrëveshjet e riblerjes dhe marrëveshjet e anasjellta të riblerjes bëhen me Bankën e Shqipërisë.

3.5 Huatë dhe paradhëniet për klientët

Huatë që Grupi i jep huamarrësve duke i siguruar atyre para në mënyrë të drejtpërdrejtë, kategorizohen si hua të dhëna nga Grupi dhe mbarten me vlerën e mbetur, pakësuar nga provigjonet për rënien në vlerë. Të gjitha huatë dhe paradhëniet kontabilizohen kur huamarrësve iu disbursohet shuma totale në para.

Përveç provigjoneve të përgjithshme, një provigjon për rënien e vlerës së huasë përcaktohet nëse është e qartë që Grupi nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjithë shumën e pashlyer.

3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KONTABËL MË TË RËNDËSISHME (VAZHDIM)**3.5 Huatë dhe paradhëniet për klientët (vazhdim)**

Politika huadhënese e Bankës është në përputhje me ligjet në fuqi (Ligji për Bankat dhe Rregullorja e Bankës së Shqipërisë “Për Administrimin e Rrezikut të Kredisë” miratuar me Vendimin Nr. 52, datë 14 korrik 2004, ndryshuar me Vendimin Nr.101, datë 27 dhjetor 2006, ndryshuar me Vendimin Nr. 31, datë 30 prill 2008, ndryshuar me Vendimin Nr. 59 dhe Nr. 61, datë 29 gusht 2008 dhe ndryshuar me Vendimin Nr. 47, datë 10 qershor 2009, ndryshuar me Vendimin Nr. 62 datë 14 shtator 2014 të Këshillit Mbikëqyrës së Bankës së Shqipërisë). Banka e klasifikon portofolin e huasë në pesë kategori duke aplikuar normat e mëposhtme për krijimin e fondeve rezervë të provigjoneve:

Kategoria e huasë	Provigjoni i humbjes
Standarde	1%
Në ndjekje	5%
Nënstandarde	20%
Të dyshimta	50%
Të humbura	100%

Kur huaja është e pakthyeshme, ajo anulohet me provigjonin për huatë e këqija; shumat e rikuperueshme më pas kreditohen në pasqyrën e konsoliduar të të ardhurave dhe shpenzimeve.

Banka nuk përllogarit më interes mbi huatë e klasifikuara të humbura për shkak të falimentimit të klientit ose moskthimit në afat të huasë. Vlera e mbartur e huave, për të cilat nuk përllogaret interes, përfaqëson shumën për t’u marrë minus provigjonin për humbjet e pritshme. Provigjoni zakonisht përcaktohet si 100% e vlerës për t’u marrë.

3.6 Qiraja financiare

Një qira klasifikohet si qira financiare nëse ajo transferon në mënyrë të konsiderueshme të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë tek qiramarrësi, dhe kështu arkëtimet e qirasë së pagueshme janë trajtuar nga Grupi si shlyerje të principalit dhe të të ardhurës financiare për të rimbursuar dhe shpërblyer investimin dhe shërbimin e Grupit. Çdo marrëveshje tjetër qiraje, përveç qirasë financiare klasifikohet si qira e zakonshme.

Shumat për t’u marrë nga qiramarrësit njihen si të arkëtueshme me vlerën e investimit neto të Grupit në qiranë financiare.

Kostot fillestare të drejtpërdrejta bëra nga Grupi janë të përfshira në matjen fillestare të qirasë financiare të arkëtueshme dhe për të zvogëluar sasinë e të ardhurave të njohura gjatë afatit të qirasë. Norma e interesit e nënkuptuar në qira është përcaktuar në mënyrë të tillë që kostot fillestare të drejtpërdrejta përfshihen automatikisht në qiranë financiare të arkëtueshme, nuk ka nevojë të shtoni ato veç e veç.

E ardhura financiare shpërndahet në çdo periudhë gjatë jetës së qirasë në mënyrë që të prodhojë normë interesi konstante mbi shumën e mbetur të aktivitetit. Pagesat e qirasë që lidhen me periudhën, me përjashtim të shpenzimeve për shërbime, janë aplikuar kundër investimit bruto në qira për të reduktuar si principalin ashtu edhe të ardhurën financiare të pafiturar.

Pagesat minimale të qirasë nën qiratë financiare shpërndahen ndërmjet të ardhurave financiare dhe reduktimit të aktiveve të mbetura.

Pagesat e mundshme të qirasë kontabilizohen duke rishikuar minimumin e pagesave të qirasë mbi jetën e mbetur të qirasë kur konfirmohen rregullimet.

3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KONTABËL MË TË RËNDËSISHME (VAZHDIM)**3.7 Prona, pajisjet dhe aktivet e patrupëzuara**

Toka dhe ndërtesa shprehen me vlerë të rivlerësuar minus zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar, ndërsa aktivet e tjera shprehen me kosto historike minus zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar.

Zhvlerësimi dhe amortizimi janë paraqitur si pakësim i kostos së pronës, pajisjeve dhe aktiveve të patrupëzuara kundrejt periudhës së vlerësuar të përdorimit të tyre, duke përdorur metodën lineare, me pikënisje nga muaji i vënies së tyre në përdorim, dhe duke aplikuar përqindjet e zhvlerësimit dhe amortizimit si më poshtë:

Kategoria	Përqindjet vjetore të zhvlerësimit dhe amortizimit (%)
Ndërtesa	5
Pajisje kompjuterike	25
Kompjuterat e ATM	25
Mjete transporti	20
Të tjera (Mobilje dhe pajisje)	20
Aktive të patrupëzuara	12.5

Toka dhe punimet në proces nuk zhvlerësohen. Fitimet dhe humbjet nga shitja e ndërtesave dhe pajisjeve në përdorim paraqiten në pasqyrën e konsoliduar të të ardhurave dhe shpenzimeve për periudhën kur janë shitur ose nxjerrë jashtë përdorimit.

3.8 Fondi i pensioneve vullnetare dhe Fondet e Investimeve

Raiffeisen INVEST vepron si një Shoqëri administruese për Fondet me kontribute të përcaktuara si më poshtë:

- Fondi me kontribute të përcaktuara “Fondin e Pensionit Vullnetar Raiffeisen”, i cili u miratua nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare më 18 tetor 2010;
- “Raiffeisen Prestige”, i miratuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare Shqiptare më 13 dhjetor 2014;
- “Raiffeisen Invest Euro Investment Fund”, i miratuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare Shqiptare më 26 shtator 2013.

Kërkesat e ligjit të ri nr. 10197 datë 10 dhjetor 2009 “Për Fondet e Pensioneve Vullnetare” dhe ligji nr. 10198 datë 10 dhjetor 2009 “Për Sipërmarrjet kolektive të investimit”, përfshijnë përgjegjësinë e Shoqërisë administruese për të përgatitur pasqyra financiare të veçanta për Shoqërinë dhe Fondet. Në 30 nëntor 2014, bazuar në vendimin e Asamblesë së Zakonshme të Aksionarit të Vetëm, objekti i aktivitetit të Shoqërisë u zgjerua dhe përfshinte edhe:

- administrimin e fondeve të pensionit vullnetar duke mbledhur dhe investuar fonde bazuar në ligjin nr. 10197, datë 10 dhjetor 2009 “Për Fondet e Pensionit Vullnetar”, si dhe në përputhje me parimet e shpërndarjes së rrezikut (diversifikimi), për qëllimin e sigurimit të përfitimeve të daljes në pension për personat që marrin pjesë në fondin e pensioneve. Shoqëria mund të ofrojë dhe shpërndarjen e pensioneve,
- për të krijuar dhe/ose administruar sipërmarrjet e investimeve kolektive bazuar në ligjin nr. 10198, datë 10 dhjetor 2009 “Për Sipërmarrjet e Investimeve Kolektive”,
- aktivitete të tjera të përcaktuara në ligjin nr. 10198, datë 10 dhjetor 2009 “Për Sipërmarrjet e Investimeve Kolektive”.

Më 31 dhjetor 2015, vlera e aktiveve neto të fondit të pensionit vullnetar Raiffeisen kishte shumën 324,298 mijë Lek (2014: 232,855 mijë Lek), shuma e Raiffeisen Prestige 56,633,644 mijë Lek (2014: 52,548,055 mijë Lek) dhe shuma Raiffeisen Invest Euro 10,355,508 mijë Lek (2014: mije Lek 11,187,721).

3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KONTABËL MË TË RËNDËSISHME (VAZHDIM)

3.9 Plani i kontributeve të përcaktuara (Fondet Vullnetare të Pensioneve dhe Fondet e Investimeve)

Në një fond me kontribute të përcaktuara, shuma e përfitimeve të ardhshme të pjesëmarrësve përcaktohet nga kontributet e paguara dhe fitimi nga investimet e fondit. Detyrimet njihen në fitim ose humbje kur maturohen dhe paraqiten si interesa të kredituara të fondit të pensioneve nën të ardhurat nga investimi dhe të ardhurat nga transaksioni. Fondet veprojnë në përputhje me ligjin nr. 10197, datë 10 dhjetor 2009 “Për Fondet e Pensionit Vullnetar” dhe ligjit nr. 10198 me date 10 dhjetor 2009 “Për Sipërmarrjet e Investimeve Kolektive”. Gjithashtu, strategjia investuese e aktiveve të këtyre Fondeve bazohet në politikën e brendshme të investimeve të Shoqërisë Administruese dhe në rregulloren “Për aktivet e lejuara, kufizimet dhe kurifi maksimal i investimeve të fondit të pensionit” e miratuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare Shqiptare. Më 31 dhjetor 2015 dhe 2014 portofoli i investimeve të fondeve përfshin obligacione qeveritare dhe bono thesari, depozita afatshkurtra në banka të nivelit të dytë dhe të tjera para dhe ekuivalentë të saj. Banka e Parë e Investime Shqipëri sh.a. vepron si bankë depozitare për të gjitha Fondet.

Vlera neto e aktiveve

Vlera neto e asetëve është e barabartë me totalin e aktiveve neto minus detyrimet e Fondit.

Vlera e njësisë së Fondit

Vlera e njësisë është e barabartë me vlerën neto të aktiveve, pjesëtuar me numrin e njësisë në datën e raportimit. Bazuar në politikën e secilit Fond, vlera fillestare e një njësie ka qenë e barabartë me 1,000 Lek.

Të ardhurat nga interesi

Të ardhurat nga interesi përfshijnë të ardhurat nga kuponat e obligacioneve dhe interesave të depozitave. Të ardhurat nga interesi paraqitet bazuar në bazë të përlllogaritur.

Komisione të Shoqërisë Administruese

Secili Fond duhet t'i paguajë Shoqërisë Administruese një tarifë, e cila është e ndryshme për çdo Fond. Raiffeisen Prestige ka aplikuar një komision prej 1.25% (në vit) mbi vlerën neto të aktiveve (2014: 1%). Fondi Raiffeisen Invest Euro paguan një komision prej 1.5% mbi vlerën neto të aktiveve (2014: 1.5%). Fondi Vullnetar i Pensioneve paguan një komision prej 1.5% (vjetore) mbi vlerën neto të aktiveve (2014: 1.5%).

Fitimi/ humbja e realizuar dhe fitimet/ humbjet e parealizuar

Fitimi/ humbjet e realizuara njihen në bazë të shitjes së letrave me vlerë me një diferencë ndërmjet çmimit të ofruar me vlerën e principalit dhe interesin e maturuar e letrave me vlerë të blera me prim apo zbritje. Këto dallime njihen në fitim ose humbje kur ndodhin. Fitim/ humbjet e parealizuar njihen si diferencë midis kostos dhe vlerës së drejtë. Kur letrat me vlerë janë shitur fitimi/ humbja e parealizuar transferohet në fitimin ose humbjen e periudhës.

3.10 Detyrimet ndaj klientëve

Detyrimet ndaj klientëve shprehen në shumën e mbetur të principalit. Interesi është kontabilizuar mbi bazë përlllogaritjeje.

3.11 Detyrimet ndaj institucioneve financiare

Detyrimet ndaj institucioneve financiare shprehen në shumën e mbetur të principalit. Interesi është kontabilizuar mbi bazë përlllogaritjeje.

3.12 Interesat dhe komisionet

Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesi janë regjistruar mbi bazë përlllogaritjeje. Të ardhurat nga komisionet për llogaritë rrjedhëse, çeqet, transfertat e parave dhe transaksionet e tjera bankare regjistrohen si të ardhura kur arkëtohen. Komisionet për huatë shtyhen në kohë dhe njihen gjatë jetës së huasë. Shpenzimet e komisionit regjistrohen kur shpenzimet paguhen.

3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KONTABËL MË TË RËNDËSISHME (VAZHDIM)

3.13 Shpenzimet

(i) Shpenzimet operative

Shpenzimet operative regjistrohen kur ndodhin.

(ii) Përfitimet e punonjësve

- *Kontributi i detyrueshëm i sigurimeve shoqërore*

Grupi derdh vetëm kontributin e detyrueshëm të sigurimeve shoqërore që siguron përfitimin e pensionit për punonjësit kur dalin në pension. Qeveria e Shqipërisë ka përgjegjësi sigurimin e pragut minimal të pensionit në Shqipëri sipas një skeme pensioni me kontribut të përcaktuar. Kontributet e Bankës në skemën e kontributit të përcaktuar regjistrohen në pasqyrën e konsolidat të të ardhurave dhe shpenzimeve kur ndodhin.

- *Leja vjetore e paguar*

Grupi regjistron si detyrim koston e vlerësuar të paaktualizuar në lidhje me lejen vjetore që pritet të paguhet në këmbim të shërbimit të punonjësit për periudhën e mbyllur.

(iii) Përmirësimi i ambienteve me qira

Përmirësimi i ambienteve me qira shprehet me koston historike të blerjes minus zhvlerësimin e akumuluar. Zhvlerësimi llogaritet duke përdorur metodën lineare përgjatë periudhës së qirasë. Sipas rregullores së Bankës së Shqipërisë, vlera e mbetur e përmirësimit të ambienteve me qira përfshihet në aktive të tjera.

3.14 Tatimi

Tatimi mbi fitimin llogaritet 15% (31 dhjetor 2014: 15%) mbi fitimin e tatueshëm në përputhje me legjislacionin tatimor shqiptar. Fitimi i tatueshëm llogaritet duke rregulluar fitimin përpara taksave me disa të ardhura dhe shpenzime sipas kërkesave të legjislacionit shqiptar.

3.15 Vlerësimi i vlerës së tregut

Duke qënë se për instrumentat financiare të krijuara në Shqipëri nuk ekziston asnjë treg, vlerësimet e vlerës së tregut bazohen në gjykimet rreth pritjeve të ardhshme të humbjeve, kushtet aktuale ekonomike, karakteristikat e rrezikut të instrumentave financiarë të ndryshëm dhe në faktorë të tjerë. Të vetmet instrumenta financiarë të gatshëm për t'u tregtuar janë letrat shqiptare me vlerë, të cilat paraqiten në Shënimin 10.

Vlerësimet e vlerave të tregut bazohen mbi instrumentet financiare të bilancit të konsoliduar ekzistues, pa vlerësuar këtu vlerën e biznesit të pritshëm si dhe vlerën e aktiveve dhe detyrimeve që nuk konsiderohen instrumenta financiarë. Aktive dhe detyrime të rëndësishme, që nuk konsiderohen instrumenta financiarë, përfshijnë pronat, pajisjet dhe aktivet e patrupëzuara. Në përgjithësi, instrumentat financiarë të bilancit të konsoliduar të Grupit kanë një vlerë tregu të vlerësuar afërsisht të barabartë me vlerën e tyre kontabël për shkak të natyrës së tyre afatshkurtër apo të normave bazë të interesit, të cilat përafrojnë me normat e tregut. Shumica e instrumentave financiarë monetarë ose kanë norma interesi të luhatshme, ose riçmohen brenda vitit.

3.16 Përdorimi i vlerësimeve

Përgatitja e pasqyrave financiare të konsoliduara në përputhje me Ligjin për Bankat në Republikën e Shqipërisë kërkon që organet drejtuese të bëjnë vlerësime dhe supozime, të cilat ndikojnë direkt në vlerën e raportuar të aktiveve dhe detyrimeve, në vlerën e aktiveve dhe detyrimeve të mundshme në momentin e përgatitjes së pasqyrave financiare të konsoliduara, dhe në shumën e të ardhurave dhe shpenzimeve gjatë periudhës për të cilën bëhet raportimi. Rezultatet reale mund të ndryshojnë nga ato të parashikuara.

RAIFFEISEN BANK SH.A.**Shënime për pasqyrat financiare të konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015***(të gjitha shumat janë në mijë Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)***4. ARKA DHE BANKA QËNDRORE**

Gjendjet në arkë dhe në Bankën Qëndrore trajtohen si shumë likuide dhe më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 ato përbëhen nga:

	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
Para në arkë	3,172,435	3,323,499
Gjendjet në Bankën e Shqipërisë (aktivet)		
Llogari rrjedhëse	33,252,408	373,399
Rezervë e detyrueshme	23,342,882	22,146,997
Llogari depozitash	-	7,000,096
Totali	59,767,725	32,843,991

Llogaritë rrjedhëse me Bankën Qëndrore nuk fitojnë interes. Banka nuk ka depozita me Bankën Qëndrore më 31 dhjetor 2015 (31 dhjetor 2014: 0.5%).

Rezerva e detyrueshme me Bankën Qëndrore nuk është për përdorim të përditshëm nga Banka dhe përfaqëson një rezervë minimale depozite, të kërkuar nga Banka Qëndrore e Shqipërisë. Rezerva të tilla llogariten si 10% i shumave mesatare e depozitave për muajin të detyruar ndaj bankave dhe klientëve, dhe janë si në LEK dhe në monedhë të huaj (USD dhe EUR).

5. BONO THESARI DHE BONO TË TJERA TË PRANUESHME PËR RIFINANCIM ME BANKËN QËNDRORE

	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
Bono thesari:		
Të tregtueshme	1,932	35,694
Të investimit	17,686,692	17,566,041
Totali	17,688,624	17,601,735

Bonot e thesarit të tregtueshme më 31 dhjetor 2015 i referohen bonove të Qeverisë me kupon zero, me normë të brendshme kthimi që variojnë nga 2.45% në 3.64% në vit (31 dhjetor 2014: nga 3.21% në 3.90%).

Bonot e thesarit të investimit më 31 dhjetor 2015 kanë të bëjnë me bonot e thesarit të Qeverisë së Shqipërisë me kupon zero, me normë të brendshme kthimi nga 2.3% në 4.5% në vit (31 dhjetor 2014: nga 2.27% në 4.85%).

RAIFFEISEN BANK SH.A.**Shënime për pasqyrat financiare të konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015**
(të gjitha shumat janë në mijë Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)**6. HUA DHE PARADHËNIE NETO PËR INSTITUCIONET E KREDITIT**

	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
Llogari rrjedhëse:		
Banka rezidente	6,818	6,483
Banka jorezidente	1,784,395	915,868
Llogari depozitash:		
Banka rezidente	2,404,100	2,853,930
Banka jorezidente	40,869,116	26,165,381
Hua:		
Banka rezidente	306,273	713,765
Të tjera (llogari garancie, sigurie dhe të tjera)	1,856,458	703,576
Totali	47,227,160	31,359,003

Normat vjetore të interesit mbi depozitat me afat me bankat rezidente më 31 dhjetor 2015 variojnë nga 1.2% deri në 1.75% (31 dhjetor 2014 : 1.50% deri në 2.25%). Normat vjetore të interesit mbi depozitat me afat me bankat jo-rezidente më 31 dhjetor 2015 variojnë nga - 0.11% deri në 1.85% (31 dhjetor 2014: 0.05% deri në 0.8%).

RAIFFEISEN BANK SH.A.**Shënime për pasqyrat financiare të konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015***(të gjitha shumat janë në mijë Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)***7. HUA DHE PARADHËNIE NETO PËR KLIENTËT**

Huatë dhe paradhëniet neto për klientët më 31 dhjetor 2015 dhe 2014 përbëhen nga:

Afat:	31 dhjetor 2015					31 dhjetor 2014				
	Shkurtër	Mesëm	Gjatë	Të tjera	Totali	Shkurtër	Mesëm	Gjatë	Të tjera	Totali
Hua standarde	42,222,278	14,405,793	19,200,866	7,119,062	82,947,999	39,503,031	14,345,915	21,789,071	6,642,944	82,280,961
Hua e pakthyer në afat	4,180	633,617	381,302	3,424	1,022,523	4,398	165,833	414,080	3,643	587,954
Hua në ndjekje	2,914,837	2,466,322	2,220,126	284,434	7,885,719	3,844,625	3,897,956	1,940,198	336,797	10,019,576
Hua nënstandard	2,363,099	787,776	548,922	182,550	3,882,347	4,090,120	3,260,978	3,150,703	123,932	10,625,733
Fonde rezervë për huatë nënstandard	(591,460)	(198,349)	(10,025)	-	(799,834)	(1,026,248)	(830,466)	(224,047)	(61,689)	(2,142,450)
Hua të dyshimta	784,140	175,485	184,997	61,715	1,206,337	936,810	1,462,515	3,232,263	36,322	5,667,910
Fonde rezervë për hua të dyshimta	(392,417)	(81,349)	(92,935)	(31,026)	(597,727)	(468,612)	(748,216)	(1,659,196)	(18,229)	(2,894,253)
Hua të humbura	7,810,706	6,239,188	3,537,527	193,096	17,780,517	8,530,822	5,018,592	2,637,593	369,779	16,556,786
Fonde rezervë për hua të humbura	(7,804,094)	(6,097,644)	(3,279,166)	(193,096)	(17,374,000)	(8,523,674)	(4,878,724)	(2,319,159)	(369,779)	(16,091,336)
Totali	47,311,269	18,330,839	22,691,614	7,620,159	95,953,881	46,891,272	21,694,383	28,961,506	7,063,720	104,610,881

Përqindjet e interesit për huatë dhe paradhëniet për klientët në monedhë të huaj variojnë nga 0.17% në 12.17% në vit dhe në Lek nga 3.77% në 15.64% në vit (2014: nga 1.57% në 11.58% në vit në monedhë të huaj dhe nga 3.21% në 19.13% në vit në Lek).

RAIFFEISEN BANK SH.A.**Shënime për pasqyrat financiare të konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015***(të gjitha shumat janë në mijë Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)***8. FONDET REZERVË PËR HUMBJET NGA LLOGARITË PËR T'U ARKËTUAR ME STATUS TË DYSHIMTË**

Fondet rezervë për humbjet nga llogaritë për t'u arkëtuar me status të dyshimtë më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 përbëhen nga:

	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
Hua dhe paradhënie për klientët (Shënimi 7)	(18,771,561)	(21,128,039)
Totali	(18,771,561)	(21,128,039)

Lëvizjet në fondet rezervë për humbje nga llogaritë për t'u arkëtuar me status të dyshimtë më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 janë analizuar si më poshtë:

	2015	2014
Fonde rezervë për humbjet nga llogaritë për t'u arkëtuar në fillim të vitit	(21,128,039)	(18,108,996)
Shpenzimet për fonde rezervë për llogaritë për t'u arkëtuar	(4,932,378)	(9,797,802)
Rimarrje për fonde rezervë për llogaritë për t'u arkëtuar	7,334,782	6,761,187
Rezerva per blerjen e portofolit te Tirana Leasing	(97,946)	-
Fshirje kredish-Raiffeisen Leasing	52,020	17,572
Fondet rezervë për humbjet nga llogaritë për t'u arkëtuar në fund të vitit	(18,771,561)	(21,128,039)

9. LETRAT ME VLERË

Letrat me vlerë më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 përbëhen nga:

	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
Letra me vlerë të tregtueshme:		
Me të ardhura fikse	21,016,263	28,501,713
Letra me vlerë të vendosjes		
Me të ardhura fikse	3,317,389	6,837,938
Letra me vlerë të investimit		
Me të ardhura fikse	34,248,314	41,992,900
Totali	58,581,966	77,332,551

Obligacionet e tregtueshme më 31 dhjetor 2015 kanë të bëjnë me obligacionet 2-vjeçare, 3-vjeçare, 5-vjeçare dhe 7-vjeçare në Lek të emetuara nga Qeveria e Shqipërisë me përqindje kuponi nga 4.82% në 10.85% në vit (31 dhjetor 2014: nga 4.69% në 11.00% në vit).

Obligacionet e vendosjes më 31 dhjetor 2015 kanë të bëjnë me obligacionet në LEK 2-year, 5-vjeçare, 7-vjeçare dhe 10-vjeçare të emetuara nga qeveria e Shqipërisë me përqindje kuponi nga 4.89% në 7.85% në vit (31 dhjetor 2014: 4.89% në 7.85%).

Obligacionet e investimit më 31 dhjetor 2015 kanë të bëjnë me obligacionet 2-vjeçare, 3-vjeçare, 5-vjeçare, 7-vjeçare dhe 10 vjeçare në Lek të emetuara nga Qeveria e Shqipërisë me përqindje kuponi nga 4.59% në 10.85% në vit (31 dhjetor 2014: 4.04% në 10.85% në vit).

RAIFFEISEN BANK SH.A.**Shënime për pasqyrat financiare të konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015**
*(të gjitha shumat janë në mijë Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)***10. MJETET E QËNDRUESHME, NETO**

Mjetet e qëndrueshme, neto më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 përbëhen nga:

	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
Mjetet e patrupëzuara	2,831,142	2,518,954
Minus : Amortizimin e akumuluar	(1,136,726)	(907,259)
	1,694,416	1,611,695
Mjetet e trupëzuara që përdoren për veprimtarinë e përditshme:		
Toka dhe ndërtesat	2,829,927	2,845,450
Pajisje zyre	3,353,005	3,317,382
Minus: Zhvlerësimin e akumuluar	(3,071,480)	(2,828,931)
	3,111,452	3,333,901
Mjetet e trupëzuara të mbajtura për investim:		
Toka dhe ndërtesat	106,465	15,248
Minus: Amortizimin e akumuluar	(16,729)	(3,432)
	89,736	11,816
Mjete të qëndrueshme në proces	5,603	2,179
Totali	4,901,207	4,959,591

Në zërin Toka dhe Ndërtesat përfshihet rivlerësimi i ndërtesave i kryer në 1 korrik 2013 me vlerë prej 2,424,139 mijë lekë. Rivlerësimi është bërë nga eksperti i jashtëm i pavarur Ernst & Young sh.p.k-Shkup me datë 15 korrik 2014.

RAIFFEISEN BANK SH.A.**Shënime për pasqyrat financiare të konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015***(të gjitha shumat janë në mijë Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)***10. MJETET E QËNDRUESHME, NETO (VAZHDIM)**

Lëvizjet e aktiveve jo-materiale për vitin e mbyllur 31 dhjetor 2015 dhe 2014 detajohen si më poshtë:

	Software	Liçensa	Emri i mirë	Totali
Kosto				
Gjendja më 1 janar 2013	1,930,415	354,714	92,783	2,377,912
Shtesa	250,918	26,359	-	277,277
Nxjerrje jashtë përdorimi	(120,064)	(16,170)	-	(136,234)
Gjendja më 31 dhjetor 2014	2,061,270	364,902	92,783	2,518,955
Gjendja më 1 janar 2015	2,061,270	364,902	92,783	2,518,955
Shtesa	154,031	160,649	-	314,680
Nxjerrje jashtë përdorimi	(1,340)	-	-	(1,340)
Transferim nga punime ne proces	(1,175)	23	-	(1,152)
Gjendja më 31 dhjetor 2015	2,212,786	525,574	92,783	2,831,143
Amortizimi i akumuluar				
Gjendja më 1 Janar 2013	(568,696)	(274,172)	-	(842,867)
Amortizimi gjatë vitit	(189,174)	(11,335)	-	(200,509)
Nxjerrje jashtë përdorimi	122,800	13,317	-	136,116
Gjendja më 31 dhjetor 2014	(635,070)	(272,190)	-	(907,260)
Gjendja më 1 janar 2015	(635,070)	(272,190)	-	(907,260)
Amortizimi gjatë vitit	(214,938)	(15,869)	-	(230,807)
Nxjerrje jashtë përdorimi	1,340	0	-	1,340
Gjendja më 31 dhjetor 2015	(848,668)	(288,059)	-	(1,136,727)
Vlera e mbetur neto:				
Më 1 janar 2015	1,426,199	92,713	92,783	1,611,695
Më 31 dhjetor 2015	1,364,118	237,515	92,783	1,694,416

Gjatë vitit 2008, Raiffeisen Bank bleu 100% të aksioneve të Raiffeisen INVEST – Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive sh.a. (“Raiffeisen INVEST”), për një shumë prej 109,648 mijë lekë. Emri i mirë në datën e blerjes është llogaritur si tejkallim i kostos së kombinimit të biznesit mbi aktivet neto të njësisë ekonomike të blerë që janë identifikuar, duke rezultuar në një shumë prej 92,783 mijë lekë. Aktivet neto të njësisë ekonomike të blerë në datën e blerjes të identifikuar përafrohen me vlerën e tyre të drejtë prej 16,865 mijë lekë.

RAIFFEISEN BANK SH.A.**Shënime për pasqyrat financiare të konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015***(të gjitha shumat janë në mijë Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)***10. MJETET E QËNDRUESHME, NETO (VAZHDIM)**

	Toka dhe ndërtesa	Kompjutera e ATM	Mjete transporti	Punime në proçes	Të tjera	Totali
Kosto						
Gjendja më 1 janar 2014	3,560,214	2,333,983	379,317	44,108	626,833	6,944,455
Shtesa	12,406	175,116	19,735	117,075	27,563	351,895
Nxjerrje jashtë përdorimi	(728,270)	(212,521)	(105,815)	(18,982)	(50,499)	(1,116,088)
Transferim nga punime në proçes	16,349	115,826	42	(140,022)	7,805	-
Gjendja më 31 dhjetor 2014	2,860,699	2,412,404	293,279	2,179	611,702	6,180,263
Gjendja më 1 janar 2015	2,860,699	2,412,404	293,279	2,179	611,702	6,180,263
Shtesa	66,242	130,210	45,668	89,887	46,748	378,756
Nxjerrje jashtë përdorimi	(8,324)	(205,106)	(13,821)	(3,621)	(34,295)	(265,167)
Transferim nga punime në proçes	17,775	41,797	18,159	(82,841)	6,263	1,152
Gjendja më 31 dhjetor 2015	2,936,392	2,379,306	343,284	5,603	630,418	6,295,004
Amortizimi dhe Zhvlerësimi i akumuluar						
Gjendja më 1 janar 2014	(351,641)	(1,654,900)	(254,189)	-	(477,000)	(2,737,730)
Shpenzimi gjatë vitit	(136,293)	(284,745)	(42,147)	-	(55,519)	(518,704)
Nxjerrje jashtë përdorimi	76,713	209,619	90,241	-	47,494	424,067
Gjendja më 31 dhjetor 2014	(411,221)	(1,730,026)	(206,095)	-	(485,025)	(2,832,367)
Gjendja më 1 janar 2015	(411,221)	(1,730,026)	(206,095)	-	(485,025)	(2,832,367)
Shpenzimi gjatë vitit	(114,691)	(289,470)	(41,002)	-	(54,081)	(499,244)
Riklasifim I amortizimit vleresim ndertese nga viti kaluar	(2,086)	-	-	-	-	(2,086)
Nxjerrje jashtë përdorimi	488	201,652	11,955	-	31,389	245,484
Gjendja më 31 dhjetor 2015	(527,510)	(1,817,845)	(235,142)	-	(507,717)	(3,088,213)
Vlera e kontabël:						
Më 1 janar 2014	3,208,573	679,083	125,128	44,108	149,833	4,206,725
Më 31 dhjetor 2014	2,449,478	682,377	87,184	2,179	126,677	3,347,896
Më 31 dhjetor 2015	2,408,883	561,462	108,142	5,603	122,701	3,206,791

RAIFFEISEN BANK SH.A.**Shënime për pasqyrat financiare të konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015**
(të gjitha shumat janë në mijë Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)**11. MJETE TË TJERA NETO, NETO**

	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
Inventarët	1,736,750	1,655,455
TVSH e arkëtueshme	417,696	484,976
Debitorë të tjerë, neto	269,122	147,830
Tatimi mbi fitimin i arkëtueshëm	614,274	111,497
Shpenzimet e parapaguara dhe të përlllogaritura	137,103	82,083
Përmirësime të ambienteve me qira, neto	46,224	40,584
Moneygram	12,067	12,576
Totali	3,233,236	2,535,000

Gjatë këtij viti, kolateralët e marrë në posedim nga Grupi kanë vlerën 1,525,273 mijë Lek (2014: 1,510,158 mijë Lek).

Përmirësime të ambienteve me qira, neto përbëhen si më poshtë:

	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
Përmirësime të ambienteve me qira	348,900	342,038
Zhvlerësimi i akumuluar	(302,676)	(301,454)
Totali	46,224	40,584

Debitorë të tjerë, neto përfshin zërat e mëposhtëm:

	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
Debitorë të tjerë	422,457	303,762
Provigjon për humbjet nga debitorë të tjerë	(153,336)	(155,932)
Totali	269,121	147,830

Lëvizja në provigjonet për debitorë të tjerë paraqitet si më poshtë:

	2015	2014
Gjendja në fillim të periudhës	155,932	11,583
Provigjon për humbjet nga debitorë të tjerë	-	144,108
Humbje nga kursi i këmbimit	(2,596)	241
Gjendja në fund të vitit	153,336	155,932

RAIFFEISEN BANK SH.A.**Shënime për pasqyrat financiare të konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015**
(të gjitha shumat janë në mijë Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)**12. DETYRIMET NDAJ INSTITUCIONEVE TË KREDITIT PËRVEÇ BANKËS QËNDRORE**

Detyrimet ndaj institucioneve të kreditit përveç Bankës Qëndrore më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 përbëhen nga:

	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
Llogari rrjedhëse:		
Banka dhe institucione financiare rezidente	1,812,222	3,375,679
Banka dhe institucione financiare jorezidente	63,374	77,447
	1,875,596	3,453,126
Llogari depozitash:		
Banka dhe institucione financiare rezidente	3,069,748	2,868,157
Banka dhe institucione financiare jorezidente	-	122,361
	3,069,748	2,990,518
Huamarrje		
Banka dhe institucione financiare rezidente	-	561,315
Totali	4,945,344	7,004,959

Normat e interesit vjetor për fondet e marra hua nga institucionet financiare variojnë nga -0.45% në 0.01% gjatë vitit të mbyllur më 31 dhjetor 2015 (2014: 0% në 1.2%).

Normat e interesit vjetor për fondet e marra hua nga institucionet financiare jorezidente janë 0.56% gjatë vitit të mbyllur më 31 dhjetor 2015 (2014:0.56%)

13. DETYRIMET NDAJ KLIENTËVE

Detyrimet ndaj klientëve më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 përbëhen nga:

	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
Llogari rrjedhëse	118,825,043	81,974,007
Llogari depozitash	119,171,919	143,595,804
Llogari të tjera	4,677,716	2,868,795
Totali	242,674,678	228,438,606

Normat vjetore të interesit të llogarive rrjedhëse dhe depozitave me afat të aplikuara gjatë periudhës nga 1 janar 2015 deri më 31 dhjetor 2015 për afate të ndryshme janë si më poshtë:

(në %)	LEK	USD	EUR
Llogari rrjedhëse	0.01-1.50	0.01-0.30	0.01-0.50
Depozita pa afat	0.05-1.50	0.01-0.50	0.05-0.50
Depozita me afat – 3 mujore	0.01-0.10	0.01-0.25	0.01-0.15
Depozita me afat – 6 mujore	0.01-0.15	0.01-0.25	0.01-0.15
Depozita me afat – 9 mujore	0.01-0.15	0.01-0.25	0.01-0.15
Depozita me afat – 12 mujore	0.01-0.15	0.01-0.30	0.01-0.15
Depozita me afat – 24 mujore	0.01-0.35	0.01-0.30	0.01-0.20
Depozita me afat – 36 mujore	0.01-0.35	0.01-0.30	0.01-0.20
Depozita me afat – 60 mujore	0.01-0.35	0.01-0.30	0.01-0.20

RAIFFEISEN BANK SH.A.**Shënime për pasqyrat financiare të konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015***(të gjitha shumat janë në mijë Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)***13. DETYRIMET NDAJ KLIENTËVE (VAZHDIM)**

Detyrimet ndaj klientëve sipas maturiteteve origjinale dhe llojit të monedhës janë si më poshtë:

	31 dhjetor 2015			31 dhjetor 2014		
Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare të konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
(shumat në LEK '000, përveç rasteve kur specifikohet ndryshe)

3. POLITIKAT KONTABEL TE RENDESISHME (VAZHDIM)

(u) Fondi vullnetar i pensionit dhe Fondet e investimit

Raiffeisen INVEST vepron si një Kompania Menaxhuese për Fondet me kontribute të caktuara si më mëposhtë:

o Fondi me kontribute të caktuara "Fond i pensioneve vullnetar Raiffeisen", i cili është miratuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare të Shqipërisë më 18 tetor, 2010;

o "Raiffeisen Prestige", i cili është miratuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare të Shqipërisë më 13 dhjetor, 2011;

o "Fondi i Investimeve Raiffeisen Euro Invest", i cili është miratuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare të Shqipërisë më 26 shtator, 2014.

Kërkesat e ligjit të ri nr 10197 datë më 10 dhjetor 2009 "Për fondet e pensionit vullnetar" dhe ligji nr 10198 datë më 10 dhjetor 2009 "Për sipërmarrjet e investimeve kolektive", përfshijnë përgjegjësinë e shoqërisë administruese për të përgatitur pasqyra financiare të konsoliduara për të kompanine dhe fondet.

Më 30 nëntor 2011, në bazë të vendimit të Asamblesë së Përgjithshme të aksionarit të vetëm, objekti i kompanisë së menaxhimit të aktivitetit është zgjeruar për të përfshirë:

- menaxhimi i fondit të pensioneve vullnetare përmes mbledhjes dhe investimin e fondeve në bazë të ligjit nr. 10197, datë 10 dhjetor 2009 "Për Fondet e Pensioneve Vullnetare", si dhe në përputhje me parimin e rrezikut-përhapjes (diversifikim), me qëllim të sigurimit të përfitimeve të daljes në pension për personat që marrin pjesë në fondin e pensioneve. Kompania mund të ofrojë edhe shpërndarjen e pensionit,

- për të krijuar dhe / ose menaxhuar sipërmarrjet kolektive të investimit në bazë të ligjit nr. 10.198, datë 10 dhjetor 2009 "Për sipërmarrjet e investimeve kolektive",

- Aktivitetet e tjera të përcaktuara në ligjin nr. 10.198, datë 10 dhjetor 2009 "Për sipërmarrjet e investimeve kolektive".

Më 31 dhjetor 2015, vlera e aktiveve neto të fondit të pensionit vullnetar Raiffeisen kishte shumën 324,298 mijë Lek (2014: 232,855 mijë Lek), shuma e Raiffeisen Prestige 56,633,644 mijë Lek (2014: 52,548,055 mijë Lek) dhe shuma Raiffeisen Invest Euro 10,355,508 mijë Lek (2014: mijë Lek 11,187,721).

(v) Planet e kontributeve të përcaktuara (Fondi i Pensionit Vullnetar dhe fondet e investimeve)

Në një fond me kontribute të përcaktuara, shuma e përfitimeve të ardhshme të pjesëmarrësve përcaktohet nga kontributet e paguara dhe fitimi nga investimet e fondit. Detyrimet njihen në fitim ose humbje kur maturohen dhe paraqiten si interesa të kredituara të fondit të pensioneve nën të ardhurat nga investimi dhe të ardhurat nga transaksioni. Fondet veprojnë në përputhje me ligjin nr. 10197, datë 10 dhjetor 2009 "Për Fondet e Pensionit Vullnetar" dhe ligjit nr. 10198 me datë 10 dhjetor 2009 "Për Sipërmarrjet e Investimeve Kolektive". Gjithashtu, strategjia investuese e aktiveve të këtyre fondeve bazohet në politikën e brendshme të investimeve të Shoqërisë Administruese dhe në rregulloren "Për aktivet e lejuara, kufizimet dhe kurifi maksimal i investimeve të fondit të pensionit" e miratuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare Shqiptare. Më 31 dhjetor 2015 dhe 2014 portofoli i investimeve të fondeve përfshin obligacione qeveritare dhe bono thesari, depozita afatshkurtra në banka të nivelit të dytë dhe të tjera para dhe ekuivalentë të saj. First Investment Bank (FiB) Shqipëri sh.a. vepron si bankë depozitare për të gjitha Fondet.

Vlera neto e aktiveve

Vlera neto e aseteve është e barabartë me totalin e aktiveve neto minus detyrimet e Fondit.

Vlera e njësisë së Fondit

Vlera e njësisë është e barabartë me vlerën neto të aktiveve, pjesëtuar me numrin e njësive në datën e raportimit. Bazuar në politikën e secilit Fond, vlera fillestare e një njësie ka qenë e barabartë me 1,000 Lek.

Të ardhurat nga interesi

Të ardhurat nga interesi përfshijnë të ardhurat nga kuponat e obligacioneve dhe interesave të depozitave. Të ardhurat nga interesi paraqitet bazuar në bazë të përlllogaritur.

GRUPI RAIFFEISEN

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare të konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
(shumat në LEK '000, përveç rasteve kur specifikohet ndryshe)

3. POLITIKAT KONTABEL TE RENDESISHME (VAZHDIM)

(v) Planet e kontributeve të përcaktuara (Fondi i Pensionit Vullnetar dhe fondet e investimeve)

Komisione të Shoqërisë Administruese

Secili Fond duhet t'i paguajë Shoqërisë Administruese një tarifë, e cila është e ndryshme për çdo Fond. Raiffeisen Prestige ka aplikuar një komision prej 1.25% (në vit) mbi vlerën neto të aktiveve (2014: 1%). Fondi Raiffeisen Invest Euro paguan një komision prej 1.5% mbi vlerën neto të aktiveve (2014: 1.5%. Fondi Vullnetar i Pensioneve paguan një komision prej 1.5% (vjetore) mbi vlerën neto të aktiveve (2014: 1.5%).

Fitimi/ humbja e realizuar dhe fitimet/ humbjet e perealizuara

Fitimi/ humbjet e realizuara njihen në bazë të shitjes së letrave me vlerë me një diferencë ndërmjet çmimit të ofruar me vlerën e principalit dhe interesin e maturuar e letrave me vlerë të blera me prim apo zbritje. Këto dallime njihen në fitim ose humbje kur ndodhin. Fitim/ humbjet e perealizuara njihen si diferencë midis kostos dhe vlerës së drejtë. Kur letrat me vlerë janë shitur fitimi/ humbja e perealizuar transferohet në fitimin ose humbjen e periudhë.

Bazuar në SNRF 10 kërkesa, ekspozimi ndaj kthimeve të ndryshueshme duhet të jetë shumë më lart se ekspozimi nga tarifat e menaxhimit të nivelit të tregut të aseteve, në mënyrë që të marrin në konsideratë konsolidimin e fondeve që menaxhohen nga subjekti, që nuk është rasti për Grupin e cila ka të drejtë të 1,5% të vlera neto asetet e fondeve të s. Më tej, Grupi nuk ka në pronësi ndonjë njësi e investimeve ose në fondin e pensioneve apo në fondet e investimeve. Asetet e Fondit janë "unazë e rrethuar" nga kompania e Administratës (filial i grupit). Sipas legjislacionit shqiptar për fondet e pensioneve dhe fondeve të investimeve, titulli ligjor mbi asetet e Fondit mbetet me kontribuesve. Si pasojë, Grupi nuk e ka konsoliduar ndonjë prej fondeve të administruara nga një prej filialeve të saj në 2015 pasqyrat financiare të konsoliduara.

(w) Depozitat dhe detyrimet e tjera financiare

Depozitat dhe detyrimet e tjera financiare janë burimet kryesore të financimit të Grupit. Kur Grupi shet një aktiv financiar dhe hyn në një marrëveshje ri-blerjeje për ta blerë këtë aktiv (ose një aktiv të ngjashëm) me një çmim fiks në të ardhmen, marrëveshja kontabilizohet si një depozitë dhe aktivi vazhdon të njihet në pasqyrat financiare të konsoliduara të Grupit. Grupi klasifikon instrumentet kapitale si detyrime financiare ose instrumenta kapitale në përputhje me thelbin e kushteve kontraktuale të instrumentit. Depozitat dhe detyrimet e tjera financiare maten fillimisht me vlerën e tregut duke i shtuar kostot e transaksionit dhe në vijim maten me kosto të amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

(x) Shitja dhe riblerja e marrëveshjeve dhe huadhënia e letrave me vlerë

Marrëveshjet e shitje dhe riblerjes ("marrëveshjet repo"), të cilat në fakt ofrojnë kthimin e huadhënësit ndaj palës tjetër, trajtohen si transaksione financiare të siguruara. Letra me vlerë të shitura sipas marrëveshjeve të tilla të shitjes dhe të riblerjes nuk çregjistrohen. Letrat me vlerë nuk riklasifikohen në bilanc, përveç nëse i transferuari ka të drejtën sipas kontratës ose të zakonit të shitjes ose të rivendosjes letrat me vlerë, në të cilin rast ato janë riklasifikuar si të arkëtueshme të riblerjes. Detyrim korrespondues është paraqitur brenda shumave për shkak të bankave të tjera ose fonde të tjera të marra hua.

Letrat me vlerë të blera sipas marrëveshjeve për t'u rishitur ("marrëveshjet repo të inversuara"), e cila në mënyrë efektive kërkon të sigurojë kthimin e huadhënësit për Grupin, regjistrohen si shkak nga bankat e tjera ose huave dhe paradhëniet për klientët, sipas rastit. Dallimi midis shitjes dhe riblerjes me çmimin e rregulluar nga interesi dhe dividendët, të ardhurat e mbledhura nga pala tjetër, trajtohen si e ardhur nga interesi dhe të përllogaritura mbi jetën e marrëveshjeve repo duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Letrat me vlerë të huazuara për palët e treta për një tarifë fikse janë mbajtur në pasqyrat financiare të konsoliduara në kategorinë e tyre origjinale në pasqyrën e pozicionit financiar përveç nëse pala tjetër ka të drejtën sipas kontratës ose të zakonit të shitjes ose të rivendosjes letrat me vlerë, në të cilin rast ato janë riklasifikuar dhe paraqitur veç e veç. Letrat me vlerë të huazuara për një tarifë fikse nuk janë të regjistruara në pasqyrat financiare të konsoliduara, nëse këto janë u shiten palëve të treta, në të cilin rast blerje dhe shitje regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave për vitin brenda fitimet më pak humbjet e krijuara nga letrat me vlerë të tregtueshme. Detyrimi për kthimin e letrave me vlerë është regjistruar me vlerën e drejtë në fonde të tjera të marra hua.

GRUPI RAIFFEISEN

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare të konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
(shumat në LEK '000, përveç rasteve kur specifikohet ndryshe)

3. POLITIKAT KONTABEL TE RENDESISHME (VAZHDIM)

(y) Zhvlerësimi i aktiveve jo-financiare

Vlera kontabël e aktiveve jo-financiare të Grupit, përveç aktiveve tatimore të shtyra rishikohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka evidenca për zhvlerësim. Nëse ka evidenca të tilla, atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivitetit. Humbje nga zhvlerësimi njihet nëse vlera kontabël e një aktivi ose e njësisë gjeneruese të mjeteve monetare tejkalon vlerën e rikuperueshme. Njësia gjeneruese e mjeteve monetare është grupi më i vogël i identifikueshëm i aktiveve që gjeneron rrjedhje monetare, të cilat janë të pavarura nga aktivitetet dhe grupet e tjera. Humbjet nga rënia në vlerë njihen në pasqyrën e konsoliduar përmbledhëse të të ardhurave. Vlera e rikuperueshme e një aktivi ose e njësisë gjeneruese të mjeteve monetare është vlera më e madhe ndërmjet vlerës së drejtë minus kostot e shitjes dhe vlerës së tij në përdorim. Në vlerësimin e vlerës në përdorim, flukset e çmuara të ardhshme të mjeteve monetare janë skontuar në vlerën e tyre aktuale duke përdorur një normë skontimi para tatimit, që reflekton vlerësimin aktual të tregjeve për vlerën në kohë të parasë dhe rreziqet specifike për aktivitetin. Humbjet e mëparshme rishikohen për të vlerësuar nëse zhvlerësimi është ulur apo nuk ekziston më. Një humbje anulohet nëse ka evidencë se nuk ka zhvlerësim dhe ka patur ndryshim në vlerësimet e përdorura për përcaktimin e vlerës së rikuperueshme. Humbja nga zhvlerësimi anulohet deri në atë masë sa vlera kontabël e aktivitetit nuk tejkalon vlerën kontabël që do të përcaktohej duke i zbritur amortizimin dhe sikur të mos ishte njohur ndonjë humbje nga zhvlerësimi.

(z) Provigjonet

Një provigjon njihet nëse, si rezultat i ngjarjeve të mëparshme, Grupi ka një detyrim ligjor ose konstruktiv, i cili mund të matet në mënyrë të besueshme dhe është e mundur që të mira ekonomike do të kërkohen për shlyerjen e këtij detyrimi. Provigjonet caktohen duke skontuar rrjedhjet e pritshme të parave me një normë para tatimit, e cila reflekton vlerën e tregut dhe nëse është e përshtatshme, rrezikun specifik të detyrimit.

Humbjet nga provigjonet e huave për detyrime dhe angazhime të mundshme

Angazhimet dhe detyrimet e mundshme të tilla si marrëveshjet undraën të jepen në rast se ata detyrohen formalisht. Detyrimet mund të zhvillohen në një mënyrë që nuk priten fillimisht. Për këtë arsye ato vlerësohen vazhdimisht për të përcaktuar nëse një dalje e burimeve që përpëmbajnë një përfitim ekonomik është bërë e mundshme. Në qoftë se detyrimi rezulton me një obligim aktual, i cili mund të matet në mënyrë të besueshme, duhet njohur një provigjon në pasqyrat financiare të konsoliduara. Vetëm angazhimet e parevokueshme mund të shkaktojnë një rrezik kredie, prandaj vetëm angazhimet dhe pasiguritë e parevokueshme mund të jenë subjekt i provigjonimit. Për ekspozimet e rëndësishme, vlerësimi bëhet në mënyrë individuale. Në rastet e vlerësimeve të bazuara në portofol, ndërtimi i portofolit dhe llogaritja e provigjoneve të bazuara në portofol duhet të bëhen siç tregohet në zhvlerësimet e Huave dhe Paradhëniet për klientët.

Kapitali aksioner. Aksionet e zakonshme dhe aksionet preferenciale jo-të-shlyera me dividendët diskrecionale klasifikohen si kapital. Kostot rritëse që lidhen drejtpërdrejt me emetimin e aksioneve ose opsioneve të reja janë paraqitur në kapitalin neto si një zbritje neto e tatimit nga të ardhurat. Çdo tejkallim i vlerës së drejtë të shumës së marrë mbi vlerën nominale të aksioneve të emetuara është regjistruar si premium aksioneve në kapitalin neto.

Dividendët. Dividendët janë të regjistruar në kapitalin neto në periudhën në të cilën ato janë deklaruar. Çdo dividend i deklaruar pas përfundimit të periudhës së raportimit dhe para se pasqyrat financiare të konsoliduara janë autorizuar për publikim, janë paraqitur në ngjarjet pasuese. Raportet statutorë të kontabilitetit të Bankës janë bazë për shpërndarjen e fitimit dhe ndarjeve të tjera. Legjislacioni shqiptar përcakton bazën e shpërndarjes si tanishme fitimit neto të vitit.

Fitimet për aksion. Fitimet për aksion përcaktohen duke pjesëtuar fitimin ose humbjen që i takon pronarëve të Bankës me numrin mesatar të ponderuar të aksioneve të papaguara që marrin pjesë gjatë vitit raportues.

GRUPI RAIFFEISEN

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare të konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
(shumat në LEK '000, përveç rasteve kur specifikohet ndryshe)

3. POLITIKAT KONTABEL TE RENDESISHME (VAZHDIM)

(aa) Angazhimet e lidhura me kredinë

Grupi lëshon garanci financiare dhe angazhime për të disbursuar kredi. Garancitë financiare paraqesin garanci të pakthyeshme për të bërë pagesat në rast se një klient nuk mund të përmbushë detyrimet e saj ndaj të tretëve, dhe mbajnë të njëjtin rrezik krede si kreditë. Garancitë dhe angazhimet për të siguruar një kredi financiar njihen fillimisht me vlerën e tyre të drejtë, e cila është evidentuar normalisht nga shuma e tarifave të marra. Kjo shumë është e amortizuar në një bazë lineare mbi jetën e angazhimit, me përjashtim të angazhimeve për origjinën e kredisë në qoftë se është e mundur që Grupi do të hyjë në një marrëveshje të veçantë të kreditimit dhe nuk presin të shesin kredi pak pas disbursimit; tarifën dhe angazhimet e kredive të tilla janë të shtyra dhe përfshijnë vlerën kontabël neto të kredisë në njohjen fillestare. Në fund të çdo periudhe raportuese, angazhimet maten me më të lartën midis (i) balancës së mbetur të paamortizuar të shumës në njohjen fillestare dhe (ii) vlerësimin më të mirë të shpenzimit të kërkuar për të shlyer detyrimin në fund të çdo periudhe raportimi .

(bb) Kompensimi

Aktivet dhe detyrimet financiare kompensohen dhe shuma neto raportohet në pasqyrën e konsoliduar të pozicionit financiar vetëm kur ekziston një e drejtë ligjrisht të zbatueshme për të kompensuar shumat e njohura, dhe ka një synim për të ose të shlyejë mbi një bazë neto, ose të realizojë aktivin dhe të shlyejë detyrimin njëkohësisht. Një e drejtë e tillë i vendosur jashtë (a) nuk duhet të jetë i kushtëzuar në një ngjarje në të ardhmen dhe (b) duhet të jenë të zbatueshme ligjrisht në të gjitha rrethanat e mëposhtme: (i) në rrjedhën normale të biznesit, (ii) rast të mospagimit dhe (iii) ngjarja e paaftësisë paguese ose falimentimit.

(cc) Paraqitja e pasqyrës së pozicionit financiar sipas likuiditetit

Grupi nuk ka një cikël operativ në mënyrë të qartë të identifikueshme dhe për këtë arsye nuk paraqet aktivet dhe pasivet aktuale dhe afatgjata ndaras në pasqyrën e pozicionit financiar. Në vend të kësaj, analiza e aktiveve dhe pasiveve sipas maturiteteve të tyre të pritshme paraqitet në Shënimin 33.

(dd) Krahasueshmëria

Të gjitha shumat janë raportuar apo zbulohen me informacionin krahasues.

GRUPI RAIFFEISEN

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare të konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
(shumat në LEK '000, përveç rasteve kur specifikohet ndryshe)

4. VLERËSIME DHE GJYKIME TË RËNDËSISHME KONTABËL

Grupi bën vlerësime dhe supozime të cilat ndikojnë shumat e njohura në pasqyrat financiare, dhe vlerat kontabël të aktiveve dhe detyrimeve brenda vitit të ardhshëm financiar. Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në përvojën e drejtimit dhe të faktorëve të tjerë, duke përfshirë pritjet e ngjarjeve të ardhshme të cilat besohet të jenë të arsyeshme në rrethanat. Menaxhimi gjithashtu bën gjykime të caktuara, përveç atyre që përfshijnë vlerësimet, në procesin e zbatimit të politikave kontabël. Vlerësimet që kanë efekt të konsiderueshëm në vlerat kontabël në pasqyrat financiare dhe vlerësimeve që mund të sjellë një rregullim të rëndësishëm në vlerën kontabël të aktiveve dhe detyrimeve brenda vitit të ardhshëm financiar përfshijnë:

i. Provigjone për humbje nga kreditë

Grupi rishikon rregullisht protofolin e kredisë për të përcaktuar zhvlerësim. Në përcaktimin nëse një humbje nga zhvlerësimi duhet të regjistrohet në pasqyrën e të ardhurave për vitin, Grupi bën gjykime nëse ka ndonjë të tregues të dukshëm që tregon se ka një ulje të ndjeshme në flukset e vlerësuar të mjeteve monetare të ardhshme nga një portofoli i kredive para se rënia mund të identifikohet me një kredi specifike e atij portofoli. Kjo evidencë mund të përfshijë të dhëna që tregojnë se ka pasur një ndryshim negativ në statusin e pagesave të huamarrësve në grup, ose të kushteve ekonomike kombëtare dhe rajonale që lidhen me mungesat në aktivet në grup. Drejtimi përdor vlerësime të bazuara në përvojën historike për humbjet nga aktivet me karakteristika të rrezikut të kredisë dhe prova objektive të zhvlerësimit të ngjashme me ato në portofolin kur caktimin flukset e ardhshme të parasë. Metodologjia dhe supozimet e përdorura për të vlerësuar të dy sasinë dhe kohën e flukseve monetare të ardhshme rishikohen rregullisht për të reduktuar diferencat midis vlerësimeve të humbjeve dhe përvojës aktuale të humbjes. Humbjet nga zhvlerësimi për kreditë të rëndësishme individualisht janë të bazuar në vlerësimet e flukseve monetare të ardhshme të skontuara të kredive individuale, duke marrë në konsideratë. Pagesa dhe realizimin me çfarëdo lloji asetit që mbahen si kolateral kundrejt huave. Një rritje 10% apo ulje në përvojën aktuale të humbjeve në krahasim me të ardhmen e vlerësuar skontuar flukset monetare nga kreditë të rëndësishme individualisht, të cilat mund të lindin nga dallimet në sasi dhe kohën e flukseve të mjeteve monetare, do të rezultojë në rritjen në vlerë të zhvlerësimit të huave me 88,073 mijë LEK respektivisht, (2014: 759,596 mijë LEK) ose një rënie të humbjeve nga zhvlerësimi të kredisë 76,583 mijë LEK (2014: 707,890 mijë lekë LEK), respektivisht.

5. ADOPTIMI I STANDARDEVE TË REJA TË RISHIKUARA DHE INTERPRETIMET

Standardet e reja dhe interpretimet e mëposhtme u bene efektive për Grupin që prej 1 Janar 2015:

Standardet e mëposhtme, të cilat janë kryesisht amendime të standardeve ekzistuese dhe interpretime të nxjerra nga Bordi Nderkombëtar i Standardeve Kontabël janë efektive për periudhën aktuale.

- **Ndryshimet e SNK 19 “Perfitimet e punonjesve”** – Përcaktimi i planeve të perfitimit: Kontributet e Punonjesve (efektive për periudhat që fillojnë nga 1 korrik 2014),
- **Ndryshime në standartet e ndryshme “Permirosimet e SNRF-ve (cikli 2010-2012)”** – Ndryshime që rezultojnë nga rishikimi vjetor që u është bërë SNRF-ve (SNRF 2, SNRF 3, SNRF 8, SNRF 13, SNK 16, SNK 24 dhe SNK 38) kryesisht me qëllim që të shmangen mosperputhjet dhe të qartësohet formulimi i standartit (ndryshimet duhet të zbatohen për periudhat vjetore që fillojnë nga data 1 korrik 2014),
- **Ndryshime në standartet e ndryshme “Permirosimet e SNRF-ve (cikli 2011-2013)”** - Ndryshime që rezultojnë nga rishikimi vjetor që u është bërë SNRF-ve (SNRF 1, SNRF 3, SNRF 13 dhe SNK 40), kryesisht me qëllim që të shmangen mosperputhjet dhe të qartësohet formulimi i standartit (ndryshimet duhet të zbatohen për periudhat vjetore që fillojnë nga data 1 korrik 2014).

Adaptimi i këtyre ndryshimeve tek standartet ekzistuese nuk ka çuar në ndryshime për sa i përket politikave kontabël të Grupit.

GRUPI RAIFFEISEN

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare të konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
(shumat në LEK '000, përveç rasteve kur specifikohet ndryshe)

6. DEKLARIME TË REJA KONTABËL

Janë hartuar disa standarde dhe interpretime të reja që janë të detyrueshme për periudha një-vjeçare duke filluar nga 1 Janar 2016 ose më vonë, dhe të cilat nuk janë përdorur nga Grupi më përpara.

- **SNRF 9 “Instrumentat financiare” – (efektive për periudhat që fillojnë nga 1 janari 2018). Ky standard** i ri përdor një mënyrë të vetme për të përcaktuar nëse një instrument financiar duhet të matet me koston e amortizuar apo vlerën e drejte, duke zëvendësuar kështu rregullat e ndryshme që përdorte SNK 39. Metoda e përdorur nga SNRF 9 bazohet në mënyrën se si Banka menaxhon instrumentat e saj financiare (modeli i saj i biznesit) dhe karakteristikat kontraktuale të flukseve monetare që derivojnë nga instrumentat financiare. Standarti i ri kërkon gjithashtu që të përdoret një mënyrë e vetme zhvleresimi, duke zëvendësuar kështu metodat e ndryshme që përdorte SNK 39. Kërkesat e reja për kontabilizimin e detyrimeve financiare trajtojnë problemin e luhatshmerisë në fitimin ose humbjen që vjen nga emetuesi duke zgjedhur kështu matjen e borxhit me vlerën e drejte. BSNK-ja vendosi të mbajë matjen ekzistuese me koston e amortizuar për shumicën e detyrimeve, duke kufizuar ndryshimin vetëm në elemente që lidhen me trajtimin e problematikave të kreditimit të vetë entitetit. Me kërkesat e reja një entitet që vendos të mase detyrimet financiare me vlerën e drejte duhet të paraqesë vlerën e ndryshimit në vlerën e drejte si rezultat i ndryshimit në riskun e kredisë të vetë entitetit, në seksionin e të ardhurave të tjera përmbledhese dhe jo ta trajtojë atë si fitim apo humbje. Ndryshimet e nxjerra që nga Nentori 2013 japin një efekt pozitiv për sa i përket adaptimit të kontabilitetit mbrojtës çka do lejojë kompanitë të reflektojnë në pasqyrat financiare riskun e tyre të menaxhimit. Ndryshimet lejojnë adresimin e të ashtuqujturit “kreditit i vet Bankes”, problematike që është përfshirë tashmë në SNRF 9 “Instrumentat financiare” dhe që mund të zbatohet në mënyrë të izoluar pa pasur nevojën e ndryshimeve të politikave të tjera kontabel që lidhen me instrumentat financiare.
- **SNRF 14 “Rregullimi i Llogarive të Shtyra”** - (efektive duke filluar 1 Janar 2016 e në vazhdim)
- **SNRF 15 “Te ardhura nga Kontratat me Klientet”** dhe ndryshime të metejshme (efektive duke filluar 1 Janar 2018 e në vazhdim),
- **SNRF 16 “Qirate”** (efektive duke filluar 1 janar 2019 e në vazhdim),
- **Ndryshime në SNRF 10 “Pasqyrat financiare të konsoliduara” dhe SNK 28 “Investime në pjesëmarrje dhe sipërmarrje të përbashkëta”**- Shitja apo kontributi i pasurive ndërmjet një investitori dhe bashkëpunëtorit të tij ose sipërmarrje të përbashkëta (efektiv për periudhat vjetore që fillojnë me apo pas datës 1 janar 2016),
- **Ndryshime në SNRF 10 “Pasqyrat financiare të konsoliduara” dhe SNRF 12 “Dhenia e informacioneve shpjeguese për përfshirje me entitete të tjera” dhe SNK 28 “Investime në pjesëmarrje dhe sipërmarrje të përbashkëta”** - Subjektet e investimeve: Përfshirje konsolidimi (efektiv për periudhat vjetore që fillojnë me apo pas datës 1 Janar 2016),
- **Ndryshime në SNRF 11 “Marreveshjet e përbashkëta”** - Kontabiliteti për blerjet e interesave në operacionet e përbashkëta (efektiv për periudhat vjetore që fillojnë me apo pas datës 1 Janar 2016),
- **Ndryshime në SNK 1 “Paraqitja e pasqyrave financiare”** - Iniciativat e zbulimit (efektiv për periudhat vjetore që fillojnë me apo pas datës 1 Janar 2016),
- **Ndryshimet në SNK 7 “Pasqyra e Fluksit të Parase”** - Nisma Për Paraqitje (efektive për periudhat vjetore që fillojnë me ose pas 1 Janar 2017),

GRUPI RAIFFEISEN

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare të konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
(shumat në LEK '000, përveç rasteve kur specifikohet ndryshe)

6. DEKLARIME TE REJA KONTABEL (VAZHDIM)

- **Ndryshime ne SNK 12 "Tatimet mbi te ardhurat"**, - Njohja e aktiveve tatimore te shtyra per Humbjet e Parealizuara (efektive per vjetore periudhat qe fillojne me ose pas dates 1 Janar 2017)
- **Ndryshime ne SNK 16 "Prona, Impiantet dhe Pajisjet" dhe SNK 38 "Aktive jo-materiale"** - Sqarim i metodave te pranueshme te zhvleresimit dhe amortizimit (efektiv per periudhat vjetore qe fillojne me apo pas dates 1 Janar 2016),
- **Ndryshime ne SNK 16 "Prona, Impiantet dhe Pajisjet" dhe SNK 41 "Agrobiznesi"** - Agrobiznes: Bimet bartesi (efektiv per periudhat vjetore qe fillojne me apo pas dates 1 Janar 2016),
- **Ndryshime ne SNK 27 "Pasqyrat financiare individuale"** - Metoda e kapitalit ne pasqyrat financiare individuale (efektiv per periudhat vjetore qe fillojne me apo pas dates 1 Janar 2016),

Ndryshime në disa standarde "Përmiresimet e SNRF-ve (2012-2014)" qe rezultojne nga projekti i permiresimit vjetor te SNRF-ve (SNRF 5,SNRF 7, SNRF13, SNK 19, SNK 34) kryesisht me qëllim heqjen e mospërputhjeve dhe sqarimin e fjalëve (ndryshimet duhet të aplikohen për periudhat vjetore që fillojnë më apo pas datës 1 Janar 2016).

Grupi ka vendosur të mos i aplikojë këto standarde, rishikime dhe interpretime përpara datave efektive të tyre. Përveç impaktit të SNRF 9, i cili do të vlerësohet nga Grupi gjatë vitit 2016, Grupi beson se aplikimi i standardeve të reja, rishikimeve dhe interpretimeve nuk do të ketë ndikim material në pasqyrat e konsoliduara financiare të Grupit në periudhën fillestare të aplikimit.

GRUPI RAIFFEISEN

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare të konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
(shumat në LEK '000, përveç rasteve kur specifikohet ndryshe)

7. PARAJA DHE EKVIVALENTËT E SAJ

	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
<i>Arka</i>	3,172,435	3,323,499
<i>Banka Qëndrore</i>		
Llogari rrjedhëse	33,252,590	373,399
Depozita	-	7,000,000
Interesi i përlllogaritur i depozitave	-	96
<i>Banka</i>		
Llogari rrjedhëse me bankat rezidente	6,818	6,438
Llogari rrjedhëse me bankat jo- rezidente	1,784,395	915,868
Depozita me bankat rezidente me maturitet me të vogël se tre muaj	2,404,099	2,853,975
Depozita me bankat jo- rezidente me maturitet me të vogël se tre muaj	37,436,138	26,165,382
Totali	78,056,475	40,638,657

Llogaritë rrjedhëse me Bankën Qëndrore nuk fitojnë interes.

Banka ka depozita me Bankën Qëndrore më 31 dhjetor 2014 me normë interesi 0.5% .

Normat vjetore të interesit mbi depozitat me afat me bankat rezidente më 31 dhjetor 2015 variojnë nga 1.20% deri në 1.75% (31 dhjetor 2014: 1.50% deri në 2.25%). Normat vjetore të interesit mbi depozitat me afat me bankat jo-rezidente më 31 dhjetor 2015 variojnë nga -0.11% deri në 0.128% (31 dhjetor 2014: 0.05% deri në 0.8%).

Analiza e cilësisë së parasë në Banka mund të përmblihet bazuar vlerësimet e Standard and Poor si më poshtë:

	2015	2014
As në vonesë apo të zhvlerësuara		
A-1	11,744,571	5,976,492
A-1+	2,553,599	2,621,881
A-2	16,407,736	9,994,290
A-3	3,398	26,278
P-1	6,110,640	-
Të pavlerësuara	41,236,531	22,019,716
Vlera Kontabël	78,056,475	40,638,657

8. SHUMA TË KUSHTËZUARA

	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
<i>Banka Qëndrore</i>		
Rezerva e detyrueshme	23,342,882	22,146,997
<i>Banka</i>		
Depozita me bankat jo- rezidente me maturitet me të madh se tre muaj	3,432,978	-
Llogari garancie	1,856,458	703,575
Totali	28,632,318	22,850,572

Rezerva e detyrueshme me Bankën Qëndrore nuk është për përdorim të përditshëm nga Banka dhe përfaqëson një rezervë minimale depozite, të kërkuar nga Banka Qëndrore e Shqipërisë. Rezerva të tilla llogariten si 10% i shuma mesatare e depozitave per muajin të detyruar ndaj bankave dhe klientëve, dhe janë si në LEK dhe në monedhë të huaj (USD dhe EUR). Normat e interesit të depozitave me bankat jorezidente më 31 dhjetor 2015 variojnë nga -1% deri në 1.85% (31 dhjetor 2014: asnjë).

GRUPI RAIFFEISEN

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare të konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
(shumat në LEK '000, përveç rasteve kur specifikohet ndryshe)

8. SHUMA TË KUSHTËZUARA (VAZHDIM)

Analiza e cilësisë së shumave të kushtëzuara mund të përmblihet bazuar vlerësimet e Standard and Poor si më poshtë më 31 dhjetor:

	2015	2014
As në vonesë as të zhvlerësuara		
A-1	-	63,953
A-2	5,263,353	612,996
B	26,083	26,627
Të pavlerësuara	23,342,882	22,146,997
Vlera Kontabël	28,632,318	22,850,572

Në grupimin të pavlerësuara ndodhet reyerua e detyrueshme të Banka Qëndrore

9. INVESTIME NË LETRA ME VLERË

9.1 Investime të mbajtura për tregtim

Letrat me vlerë të tregëtueshme përfshijnë bonot e thesarit të qeverisë shqiptare dhe Obligacione të qeverisë si më poshtë:

	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
Obligacione të qeverisë	20,996,111	28,481,561
Bono thesari	1,932	35,694
Totali	20,998,043	28,517,255

Bonot e thesarit më 31 dhjetor 2015 i referohen bonove të qeverisë me kupon zero me normë të brendshme kthimi që varion nga 2.45% deri në 3.64% në vit (31 dhjetor 2014: nga 3.21% deri në 3.9%).

Obligacionet e qeverisë më 31 dhjetor 2015 kanë të bëjnë me obligacionet në Lek 2- vjeçare, 3- vjeçare, 5- vjeçare dhe 7- vjeçare të emetuara nga qeveria e Shqipërisë me normë kuponi nga 4.82% deri në 10.85% në vit (31 dhjetor 2014: nga 4.04% deri në 10.85%).

9.2 Investime të mbajtura deri në maturim

Investime të mbajtura deri në maturim përfshijnë bono thesari dhe obligacione të qeverisë shqiptare si më poshtë:

	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
Bono thesari (Shënimi 9.2.1)	17,686,691	17,566,041
Obligacione të qeverisë (Shënimi 9.2.2)	30,153,216	33,270,569
Obligacione të qeverisë jo residente (Shënimi 9.2.3)	-	5,802,783
Bonde korporatash (9.2.3)	4,115,251	2,939,700
Totali	51,955,158	59,579,093

Më 31 dhjetor 2015 nuk janë mbajtur bono thesari si garanci për portofolin e marrëveshjeve të anasjellta të riblerjes (2014: asnjë)

GRUPI RAIFFEISEN

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare të konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
(shumat në LEK '000, përveç rasteve kur specifikohet ndryshe)

9. INVESTIME NË LETRA ME VLERË (VAZHDIM)

9.2.1 Bono thesari

Bonot e thesarit më 31 dhjetor 2015 kanë të bëjnë me Bonot e Thesarit të Qeverisë së Shqipërisë me kupon zero dhe norma të brendshme të kthimit nga 2.3% në 4.5% në vit (31 dhjetor 2014: nga 2.27% në 4.85%).

	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
Vlera nominale e obligacioneve	17,864,231	17,815,230
Zbritja e paamortizuar	(177,540)	(249,189)
Totali	17,686,691	17,566,041

9.2.2 Obligacionet e qeverisë

Obligacionet e qeverisë më 31 dhjetor 2015 kanë të bëjnë me obligacionet në LEK 2-year, 3-vjeçare, 5-vjeçare, 7-vjeçare dhe 10-vjeçare të emetuara nga qeveria e Shqipërisë me përqindje kuponi nga 4.04% në 10.85% në vit (31 dhjetor 2014: nga 4.69% në 11.00%).

	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
Vlera nominale e bondeve	29,700,425	32,724,194
Primi i paamortizuar	3,304	3,717
Interesi i përlogaritur	449,487	542,658
Totali	30,153,216	33,270,569

9.2.3 Obligacionet e qeverisë jo rezidente

Obligacionet e qeverisë jo rezidente më 31 dhjetor 2014 përfaqësojnë bonde 1-vjeçare në EUR me përqindje kuponi 3.5% në vit (31 dhjetor 2015: 0).

	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
Vlera nominale e bondeve	-	5,605,600
Primi i paamortizuar	-	62,265
Interesi i përlogaritur	-	134,918
Totali	-	5,802,783

9.2.4 Obligacionet e Korporatave

Obligacionet e Korporatave më 31 dhjetor 2015 përfaqësojnë bonde 1-vjeçare në EUR me përqindje kuponi që varion nga 0.75% në 5.88% në vit (31 dhjetor 2014: 3.25% deri në 5.88%).

	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
Vlera nominale e bondeve	3,981,120	2,799,997
Primi i paamortizuar	105,700	11,916
Interesi i përlogaritur	28,431	127,787
Totali	4,115,251	2,939,700

GRUPI RAIFFEISEN

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare të konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
(shumat në LEK '000, përveç rasteve kur specifikohet ndryshe)

9. INVESTIME NË LETRA ME VLERË (VAZHDIM)**9.3 Investime të përcaktuara me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes**

Letra me vlerë të tjera të përcaktuara me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes përfshijnë obligacionet e Qeverisë Shqiptare, performanca e së cilës është menaxhuar dhe vlerësuar mbi bazën e vlerës së drejtë, në përputhje me strategjinë e investimeve të Bankës. Informacion mbi këtë bazë është dhënë rregullisht dhe shqyrtuar nga Bordi i Drejtorëve të Grupit.

	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
Vlera nominale e bondeve	3,423,858	6,841,526
Total	3,423,858	6,841,526

Obligacionet e qeverisë më 31 dhjetor 2015 kanë të bëjnë me obligacionet në LEK 2-year, 3-vjeçare, 5-vjeçare, 7-vjeçare dhe 10-vjeçare të emtuara nga qeveria e Shqipërisë me përqindje kuponi nga 4.89% në 7.85% në vit (31 dhjetor 2014: 4.89% në 7.85%). Analiza sipas cilësisë së kredisë së letrave me vlerë të investimit është përmbledhur si më poshtë në 31 dhjetor 2015 dhe 2014:

	Investime të mbajtura për tregtim		Investime të mbajtura deri në maturim		Investime të përcaktuara me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes	
	2015	2014	2015	2014	2015	2014
As në vonesë as të zhvlerësuar	-	-	-	-	-	-
B	20,998,043	28,517,255	47,839,907	50,836,610	3,423,858	6,841,526
A1	-	-	724,085	-	-	-
A2	-	-	692,851	-	-	-
A3	-	-	715,152	-	-	-
A-	-	-	1,286,393	-	-	-
Aa2	-	-	553,592	-	-	-
AA	-	-	143,178	-	-	-
A	-	-	-	956,974	-	-
Aa1u	-	-	-	5,802,783	-	-
AA+	-	-	-	-	-	-
BBB+	-	-	-	-	-	-
BBB	-	-	-	1,982,726	-	-
Të pavlerësuar	-	-	-	-	-	-
Vlera Kontabël	20,998,043	28,517,255	51,955,158	59,579,093	3,423,858	6,841,526

GRUPI RAIFFEISEN

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare të konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
(shumat në LEK '000, përveç rasteve kur specifikohet ndryshe)

10. HUA DHE PARADHËNIE PËR KLIENTËT

	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
Hua dhe paradhënie për klientët	114,610,752	126,033,716
Provigjone për zhvlerësimin e huave	(13,714,055)	(13,817,545)
Vlera neto	100,896,697	112,216,171

Lëvizjet në provigjonet për zhvlerësimin e huave janë si më poshtë: :

	2015	2014
Gjendja në fillim të periudhës	13,817,545	12,106,877
Shpenzime provigjioni për huatë për periudhën	6,652,888	5,933,851
Rimartje nga provigjioni nga huatë	(2,407,882)	(1,736,663)
Reserva për blerjen e Portfolit të Tirana Leasing	108,502	-
Kreditë e çregjistruara	(4,456,998)	(2,486,520)
Gjendja në fund të periudhës	13,714,055	13,817,545

Përqindjet e interesit për huatë dhe paradhëniet për klientët variojnë nga 0.17% në 12.17% në vit në monedhë të huaj dhe nga 3.77% në 15.64 % në vit në LEK (31 dhjetor 2014: nga 1.57% në 11.58% në vit në monedhë të huaj dhe nga 3.21% në 19.13% në vit në LEK).

Huatë dhe huadhëniet për klientët të detajuara sipas segmenteve të biznesit më 31 dhjetor 2015 dhe 2014 janë paraqitur në tabelat e mëposhtme:

31 dhjetor 2015

	Individë	Korporata	SME	Mikro - Biznese	Punonjës	TOTALI
Overdraft	2,005,399	46,337,285	4,246,007	620,927	68,776	53,278,394
Karta krediti	469,748	10,668	11,337	-	51,123	542,876
Kredi						
Afat-shkurtër	169,075	2,177,692	40,339	885	3,846	2,391,837
Afat-mesëm	4,588,310	14,726,220	2,110,138	340,708	136,844	21,902,220
Afat-gjatë	6,891,439	10,275,529	2,506,845	338,794	351,057	20,363,664
	11,648,824	27,179,441	4,657,322	680,387	491,747	44,657,721
Hipotekë	8,630,060	-	591,380	209,278	3,079,127	12,509,845
Të tjera	446,481	2,391,420	681,187	507,266	16,343	4,042,697
<i>Minus tarifë administrimi</i>	(175,785)	(196,624)	(38,291)	(10,081)	-	(420,781)
TOTALI	23,024,727	75,722,190	10,148,942	2,007,777	3,707,116	114,610,752

GRUPI RAIFFEISEN

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare të konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
(shumat në LEK '000, përveç rasteve kur specifikohet ndryshe)

10. HUA DHE PARADHËNIE PËR KLIENTËT (VAZHDIM)

31 dhjetor 2014

	Individë	Korporata	SME	Mikro - Biznese	Punonjës	TOTAL
Overdraft	1,797,341	47,450,801	4,435,749	635,739	70,605	54,390,235
Karta krediti	439,661	2,267	4,690	-	47,290	493,908
Huatë						
Afat-shkurtër	166,115	2,193,719	71,597	6,186	2,937	2,440,554
Afat-mesëm	3,852,706	19,463,517	2,380,273	456,045	119,320	26,271,861
Afat-gjatë	6,428,316	18,239,668	2,500,360	406,230	252,515	27,827,089
	10,447,137	39,896,904	4,952,230	868,461	374,772	56,539,504
Hipotekë	8,002,580	-	508,759	244,500	2,723,672	11,479,511
Të tjera	313,101	2,367,112	634,926	211,722	22,665	3,549,526
Minus tarifë administrimi	(154,975)	(212,847)	(40,756)	(10,390)	-	(418,968)
TOTALI	20,844,845	89,504,237	10,495,598	1,950,032	3,239,004	126,033,716

Lëvizjet në provigjonet për zhvlerësimin e huave për klientët të detajuara sipas segmenteve të biznesit më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 janë paraqitur në tabelat e mëposhtme:

31 dhjetor 2015

	Individë	Korporata	SME	Mikro - Biznese	Punonjës	TOTAL
Gjendja në fillim të periudhës	1,694,679	10,326,786	1,462,777	328,909	4,394	13,817,545
Shpenzime provigjioni për huatë për periudhën	573,021	5,601,006	378,699	99,640	522	6,652,888
Rimartje nga provigjioni nga huatë	(328,330)	(1,720,669)	(280,747)	(76,596)	(1,542)	(2,407,884)
Reserva për blerjen e Portfolit të Tirana Leasing	17,385	41,360	13,074	36,684	-	108,503
Kreditë e çregjistruara	(172,198)	(3,678,174)	(487,925)	(118,697)	(3)	(4,456,997)
Gjendja në fund të periudhës	1,784,557	10,570,309	1,085,878	269,940	3,371	13,714,055

31 dhjetor 2014

	Individë	Korporata	SME	Mikro - Biznese	Punonjës	TOTAL
Gjendja në fillim të periudhës	1,458,872	8,898,160	1,427,382	319,900	2,563	12,106,877
Shpenzime provigjioni për huatë për periudhën	556,937	4,424,760	780,896	167,792	3,466	5,933,851
Rimartje nga provigjioni nga huatë	(190,326)	(1,188,657)	(301,538)	(56,085)	(56)	(1,736,662)
Kreditë e çregjistruara	(130,804)	(1,807,477)	(443,963)	(102,698)	(1,579)	(2,486,521)
Gjendja në fund të periudhës	1,694,679	10,326,786	1,462,777	328,909	4,394	13,817,545

GRUPI RAIFFEISEN

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare të konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
(shumat në LEK '000, përveç rasteve kur specifikohet ndryshe)

10. HUA DHE PARADHENIE PER KLIENTET (VAZHDIM)

Përqëndrimet e riskut në sektorin ekonomik brenda portofolit të kredive të klientëve është si më poshtë:

<i>Ne mijë Lekë</i>	2015		2014	
	Shuma	%	Shuma	%
Tregtia, riparimi i automjeteve dhe artikujve shtëpiake	31,763,616	28%	40,705,160	32%
Individë	26,787,647	23%	24,179,468	19%
Prodhimi dhe shpërndarja e energjisë elektrike, gazit dhe ujit	22,958,973	20%	21,537,890	17%
Industria e përpunimit	8,488,403	7%	11,097,687	9%
Ndërtim	6,500,532	6%	8,279,829	7%
Ndërmjetësimi monetar dhe financiar	3,407,346	3%	6,309,608	5%
Transporti, magazinimi dhe telekomunikacioni	2,317,477	2%	4,093,015	3%
Industria nxjerrëse	4,709,244	4%	2,455,961	2%
Bujqësia dhe gjuetia	1,839,321	2%	2,329,354	2%
Kolektive, sociale dhe personale	2,044,445	2%	2,320,342	2%
Shëndetësi dhe punë sociale	1,100,196	1%	1,185,948	1%
Të tjera	2,693,552	2%	1,539,454	1%
Totali i huave dhe huadhënies për klientët (përpara zhvlerësimit)	114,610,752	100%	126,033,716	100%

GRUPI RAIFFEISEN

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare të konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
(shumat në LEK '000, përveç rasteve kur specifikohet ndryshe)

10. HUA DHE PARADHËNIE PËR KLIENTET (VAZHDIM)

Më 31 dhjetor 2015 Grupi kishte 15 huamarrës (2014:18 huamarrës) me shumën e kredisë mbi 1,000,000 mijë lekë. Totali i kredisë së marrë nga këta klientë është 46,434,150 mijë (2014: LEK 53,892,375 mijë) ose 40.6% e totalit të portofolit të kredisë (2014: 48.8%). Informacioni mbi kolateralin më 31 dhjetor 2015 është si më poshtë:

	Individë	Korporata	SME	Mikro - Biznese	Punonjës	Totali
Kredi te pasiguruara	13,737,215	132,643	72,318	40,419	667,922	14,650,517
Kredi te siguruara nga te trete	780,713	25,740,805	360,025	472,531	631,849	27,985,923
Kredi te kolateralizuara me:						
- pasuri te paluajtshme rezidente	6,894,928	4,162,904	2,431,836	491,833	2,324,740	16,306,241
- te tjera pasuri te paluajtshme	694,995	24,813,875	5,096,559	341,934	59,625	31,006,988
- investime te tregtueshme	409,480	1,149,639	2,128	4,231	125	1,565,603
- depozite cash	93,508	17,345,976	1,512,355	167,963	-	19,119,802
- Makina dhe mjete te levizshme/ Mjete	421,073	2,376,346	673,722	488,866	15,671	3,975,678
Totali i Hua dhe paradhënie për klientët	23,031,912	75,722,188	10,148,943	2,007,777	3,699,932	114,610,752

Informacioni mbi kolateralin më 31 dhjetor 2014 është si më poshtë:

	Individë	Korporata	SME	Mikro - Biznese	Punonjës	Totali
Kredi te pasiguruara	12,363,837	747,931	279,323	108,525	552,146	14,051,763
Kredi te siguruara nga banka te tjera	-	729,149	-	-	-	729,149
Kredi te siguruara nga te trete	752,027	14,508,867	460,688	556,689	539,467	16,817,737
Kredi te kolateralizuara me:						
- pasuri te paluajtshme rezidente	6,585,679	6,791,636	2,160,863	548,831	2,079,256	18,166,266
- te tjera pasuri te paluajtshme	579,516	25,558,276	5,882,350	409,299	46,511	32,475,952
- investime te tregtueshme	264,300	822,530	15,049	8,984	205	1,111,067
- depozite cash	26,906	37,994,764	1,071,691	126,278	-	39,219,638
- Makina dhe mjete te levizshme/ Mjete	272,581	2,351,084	625,634	191,426	21,419	3,462,144
Totali i Hua dhe paradhënie për klientët	20,844,846	89,504,237	10,495,598	1,950,032	3,239,004	126,033,716

Mjete të tjera përfshijnë kryesisht pajisje dhe llogaritë e arkëtueshme. Paraqitja e mësipërme përfaqëson vlerën më të ulët midis vlerës kontabël neto të kredisë ose të kolateralit marrë, pjesa e mbetur është shpalosur në ekspozimet e të pasigurta. Vlera e mbartur e huave është ndarë në bazë të likuiditetit të aktiveve të marra si kolateral.

GRUPI RAIFFEISEN

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare të konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015

*(shumat në LEK '000, përveç rasteve kur specifikohet ndryshe)***10. HUA DHE PARADHENIE PER KLIENTET (VAZHDIM)**

Analiza e cilësisë së kredisë të huave dhe paradhënieve në 31 dhjetor 2015 është si me poshtë:

	<i>Korporata</i>	<i>SME</i>	<i>Mikro biznes</i>	<i>Individë</i>	<i>Punonjës</i>	<i>Totali</i>
<i>Kredi as në vonesë e as të zhvlerësuar:</i>						
Shkalla 2B	870,662	-	-	-	-	870,662
Shkalla 4A	3,092	-	-	-	-	3,092
Shkalla 4B	46,449	965,995	-	-	-	1,012,444
Shkalla 5A	1,891,576	-	-	-	-	1,891,576
Shkalla 5B	5,145	2,278,666	-	-	-	2,283,811
Shkalla 5C	265,751	-	-	-	-	265,751
Shkalla 6A	57,031	596,459	-	-	-	653,490
Shkalla 6B	438,844	714,175	-	-	-	1,153,019
Shkalla 6C	2,659,454	515,517	-	-	-	3,174,971
Shkalla 6.2	2,300,642	-	-	-	-	2,300,642
Shkalla 6.3	816,033	-	-	-	-	816,033
Shkalla 7A	2,287,961	713,174	-	-	-	3,001,135
Shkalla 7B	4,097,358	420,882	-	-	-	4,518,240
Shkalla 7C	25,134,986	256,160	-	-	-	25,391,146
Shkalla 8A	2,801,161	140,099	-	-	-	2,941,260
Shkalla 8B	2,612,668	360,091	-	-	-	2,972,759
Shkalla 8C	2,009,200	153,310	-	-	-	2,162,510
Shkalla 9A	770,753	-	-	-	-	770,753
Shkalla 9B	723,909	424,456	-	-	-	1,148,365
Shkalla 9C	1,841,970	-	-	-	-	1,841,970
Shkalla (pa klasifikuar)	120,362	40,015	1,245,602	18,803,640	3,615,107	23,824,726
Totali i kredive as në vonesë e as të zhvlerësuar:	51,755,007	7,578,999	1,245,602	18,803,640	3,615,107	82,998,355

GRUPI RAIFFEISEN

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare të konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015

(shumat në LEK '000, përveç rasteve kur specifikohet ndryshe)

10. HUA DHE PARADHËNIE PËR KLIENTET (VAZHDIM)*Kredi ne vonesë, por jo të zhvlerësuar:*

	<i>Korporata</i>	<i>SME</i>	<i>Mikro biznes</i>	<i>Individë</i>	<i>Punonjës</i>	<i>Totali</i>
- më pak se 30 dite vonesë	4,404,874	682,153	130,093	1,247,789	84,398	6,549,307
- 30 deri ne 60 dite vonesë	452,063	187,487	71,241	283,026	-	993,817
- 60 deri ne 90 dite vonesë	1,567,374	27,445	162,208	808,654	-	2,565,681
- 90 deri ne 180 dite vonesë	1,613,148	195,628	31,227	15,497	-	1,855,500
- 180 deri ne 360 dite vonesë	-	84	8,283	34,203	-	42,570
- mbi 360 dite vonesë	90,647	6,350	20,541	27,335	-	144,873
Totali i kredive ne vonesë, por jo të zhvlerësuar	8,128,106	1,099,147	423,593	2,416,504	84,398	12,151,748

Kredi të zhvlerësuar individualisht (bruto)

- më pak se 30 dite vonesë	16	668	9,455	211,305	426	221,870
- 30 deri ne 60 dite vonesë	35,991	9,700	485	52,463	-	98,639
- 60 deri ne 90 dite vonesë	350	448	13,049	55,102	-	68,949
- 90 deri ne 180 dite vonesë	5,374,945	60,467	9,454	62,254	-	5,507,120
- 180 deri ne 360 dite vonesë	2,205,638	162,703	56,047	302,489	-	2,726,877
- mbi 360 dite vonesë	8,222,133	1,236,812	250,093	1,128,155	-	10,837,193
Totali i kredi të zhvlerësuar individualisht (bruto)	15,839,073	1,470,798	338,583	1,811,768	426	19,460,649
Minus provigjonet	(10,570,309)	(1,085,879)	(269,940)	(1,784,555)	(3,372)	(13,714,055)
